

MANUAL OPERATIV

për punonjës të pushtetit vendor që vënë në lëvizje mekanizmat kundër trafikimit dhe dhunës ndaj grave

Në kujdesin e

VALBONA LENJA

Ekspert për çështjet gjinore

dhe

ANTONELLO MASSENTI

Udhëheqësi i projektit CIES në Shqipëri



Tiranë - Janar 2018

Ky publikim u realizua nga Centro Informazione ed Educazione allo Sviluppo” (CIES) me kontributin e Agenzia Italiana per la Cooperazione Internazionale (AICS), në kuadër të projektit “GEMAL - Gender Mainstreaming në Shqipëri: me gratë kundër dhunës dhe shfrytëzimit - AID 010580”. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi, i cili nuk reflekton në asnjë mënyrë opinionin e Agenzia Italiana per la Cooperazione Internazionale, i takon vetëm organizatave partnere të projektit.

Në partneritet me



Me kontributin e



Bashkëpunuan në realizimin e këtij publikimi:

Anila Trimi, Ministero degli Interni, Direttrice della Direzione Generale Anti tratta e Asilo

Alessia Celani, CIES Roma, Desk Officer Area Balcani

Albana Gaci, CIES Albania, Coordinatrice Nazionale progetto GEMAL

Ardiana Kasa, Tjeter Vizion, Coordinatrice Regionale progetto GEMAL

Adena Vangjeli, Centro Psicosociale Vatra, Coordinatrice Regionale progetto GEMAL

Trendelina Borici, Gruaja tek Gruaja, Coordinatrice Regionale progetto GEMAL

Luljeta Qose, Tjeter Vizion, Operatrice Sociale progetto GEMAL

Permbledje

Hyrie

Pg. 1 *DETYRIMET*
lidhur me mbrojtjen nga dhuna dhe trafikimi

POZICIONI dhe ROLI **Pg. 5**
i strukturave vendore kundrejt trafikimit dhe dhunës në familje

Pg.13 *IDENTIFIKIMI*
i grave dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mbështetje

VLERËSIMI **Pg.27**
multidisiplinar i nevojave dhe planifikimi i mbështetjes

Pg.33 *PLANIFIKIMI dhe DHËNIA e NDIHMËS*
për gratë viktime të dhunës dhe trafikimit

BASHKËPUNIMI **Pg.43**
ndërinstitucional dhe zbatimi i ligjit

Pg.49 *NDËRGJEGJËSIMI*
dhe modelet e veprimeve për parandalimin e dhunës dhe trafikimit

MONITORIMI **Pg.51**
i kompetencave dhe veprimet në luftën kundër dhunës dhe trafikimit

Lista e shkurtimeve

AP	Autoriteti Përgjegjës për Identifikimin, Referimin, Mbrojtjen dhe Riintegrimin e Viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
CIES	Centro Informazione e Educazione allo Sviluppo
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DSPSHSHB	Drejtori i Strukturës Përgjegjëse për Shërbimet Shoqërore
ETN	Ekipi Teknik Ndërinstitucional
KIE	Këshilli i Evropës
KDF	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
KKAT	Koordinatori Kombëtar Antitrafikim
KRAT	Komitetet Rajonale Anti-Trafikim
KSHNJ	Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike
KVDHF	Koordinatori vendor i dhunës në marrëdhëniet familjare
MB	Ministria e Brendshme
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVRN	Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve
PSV	Procedurat Standarte për Identifikimin dhe referimin e Viktimave të Trafikimit të miratuara me VKM 582
SLKTP	Spektori i Luftës kundër Trafikeve të Paligjshme i Policisë
VKM 334	Vendim i Këshillit të Ministrave Për Mekanizmin për Dhunën në Marrëdhëniet Familjare
ZRSHSSH	Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

Hyrje

VALBONA LENJA, CIES eksperte e jashtme për çështjet gjinore

Ky "Manual operativ" është një nga produktet e punës së CIES dhe partnerëve Vatra, Gruaja tek Gruaja dhe Tjetër Vizion në kuadër të projektit GEMAL- "Gender Mainstreaming në Shqipëri: me gratë kundër dhunës dhe shfrytëzimit", bashkëfinancuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane.

Prej disa vitesh punonjësit e bashkive dhe njësive administrative punojnë konkretisht dhe konsolidojnë eksperiencën e tyre në identifikimin dhe ndihmën për gratë dhe fëmijët viktime të trafikimit e të dhunës. Ndryshime të mëdha kanë ndodhur e po ndodhin në fushën e legjislacionit të mbrojtjes shoqërore dhe mbrojtjes së fëmijëve që synojnë ndër të tjera çuarjen e shërbimeve në zona dhe individë të neglizhuar, aplikimin e praktikave të suksesshme dhe gjetjen e zgjidhjeve të reja dhe efektive në zbatim të parimeve e të drejtave humane etj.

Këto ndryshime janë ende të panjohura për punonjësit aktualë të strukturave vendore të shërbimeve sociale dhe partnerët e tyre nga shoqëria civile, dhe sigurisht të panjohura për punonjësit e rinj që priten të rekrutohen në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Ndërsa aktet nënligjore janë ende në zhvillim e sipër, ky manual synon ti vijë në ndihmë punonjësve të strukturave vendore të shërbimeve sociale dhe partnerëve të tyre të kryejnë rolin e tyre mbrojtës ndaj viktimave të dhunës e të trafikimit nëpërmjet njohjes me praktikën e tre organizatave partnere të projektit si edhe kontekstit në të cilin kanë vepruar ato.

Për këtë arsye, ky manual ka pjesë teorike ku flet për detyrimet e shtetit shqiptar, parimet në të cilat mbështeten parashikimet ligjore dhe ndryshimet në to, mekanizmat e ngritur etj.; dhe për të kuptuar funksionimin praktik të mekanizmave të mbrojtjes së grave dhe fëmijëve, ai jep shembuj nga praktika e deritanishme e këtyre organizatave dhe e punonjësve të shtetit me të cilët ata kanë bashkëpunuar.

Për të lehtësuar dhe theksuar të kuptuarin e rolit të punonjësve të bashkive me qendër individin apo individët në nevojë, manuali është organizuar në segmente që reflektojnë strukturimin e mbrojtjes: të kuptuarin e mekanizmave të mbrojtjes nga trafikimi dhe dhuna në tërësi dhe të elementëve apo proceseve bazë të tyre si identifikimit, ndihmës, parandalimit, ushtrimit të së drejtës për dënimin e dhunuesve dhe ushtrimin e së drejtës për cilësi të shërbimeve/ndihmës.


Nuk mund të pretendohet se mbrojtja e grave dhe fëmijëve nga trafikimi dhe dhuna mund të mësohet nëpërmjet një manuali dhe për këtë arsye, në këtë dokument trajtohen çështjet kryesore dhe jepen udhëzime për të eksploruar më shumë në legjislacion e në studime kryesisht vendase por edhe ndërkombëtare.

Përdorimi në këtë manual i termave viktime e trafikimit ose e dhunës dhe jo të mbijetuar të dhunës apo trafikimit siç sugjerohet shpesh, bëhet për të theksuar faktin që këta persona kanë qenë objekt i krimeve, dhe për faktin se jo të gjithë ata që kanë pësuar dhunë apo trafikim i mbijetojnë këtyre krimeve: ata apo ato janë ende në proces. Profesionistët që do ta përdorin këtë manual inkurajohen që të japin këtë shpjegim tek personat me të cilët komunikojnë dhe t'i lënë ata të vendosin se si preferojnë tu drejtohen.

1 DETYRIMET

lidhur me mbrojtjen nga dhuna dhe trafikimi

Shqipëria është nga të parat vende që ka ratifikuar konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna dhe trafikimi. Më poshtë jepet një kalendar i shkurtër i aderimeve të shtetit shqiptar:



Konventa CEDAW

Konventa CEDAW konsiderohet si karta e të drejtave të grave. Duke pranuar Konventën, Shqipëria është angazhuar të ndërmarrë një sërë masash për t'i dhënë fund diskriminimit të grave në të gjitha format e tij duke përfshirë inkorporimin e parimit të barazisë së grave dhe burrave në sistemin ligjor, shfuqizimin e të gjitha ligjeve diskriminuese dhe adoptimin e ligjeve të reja që ndalojnë diskriminimin ndaj grave, krijimin e gjykatave dhe institucioneve të tjera publike që sigurojnë mbrojtje efektive të grave nga diskriminimi dhe sigurimin e eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit të grave nga individët, organizatat apo kompanitë.

Në vecanti, mbështetur në kontekstin shqiptar, vlen të kujtojmë çfare përcaktohet në nenin 5 dmth i mpenjimin për të *“modifikuar skemat dhe modelet e sjelljes sociale e kulturore të burrave dhe grave, me qëllim arritjen e eliminimit të paragjyqimeve dhe praktikave të tjera zakonore, të mbështetura në bindjen e inferioritetit o të superioritetit të njërit seks mbi tjetrin, o mbi idenë e steriotipeve mbi burrat dhe gratë”*, ashtu sikurse dhe impenjimi *“ku në edukimin familjar të integrohet i kuptuari i rrolit social të mëmësisë sikundër edhe njohja e përgjegjësisë të përbashkëta të burrave dhe grave në rritjen dhe edukimin e fëmijëve”*. Keto angazhime duhen parë nën dritën e dispozitave pjesë e **Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave** (DVAW), e cila në mënyrë eksplicite tregon në nenin 4 veprimet që shteti duhet të ndërmarrë për eliminimin e dhunës në jetën private.

Këtu ndër të tjera citohet: ndërmarrja e sanksioneve penale e civile mbi të drejtat në punë dhe të drejtat administrative për të ndëshkuar dhe ndrequr gabimet që ju janë shkaktuar grave viktimat të dhunës; zhvillimin e planeve në nivel kombëtar për të promovuar mbrojtjen për gratë nga cdo formë dhune, mbështetja në burimet të disponueshme; sigurimi i shërbimeve sociale për gratë që i kanë mbijetuar dhunës; miratimin e veprimeve të cilat sigurojnë formimin e punonjësve publik të cilëve ju është besuar implementimi i ligjeve, duke i bërë ata më të ndjeshëm kundrejt nevojave dhe kërkesave të grave; sigurimi se në buxhetin e qeverisë do të alokohen burime të nevojshme për të luftuar dhunën në familje.

Konventa Kundër Krimin të Organizuar dhe Protokollet Shtesë

Duke nënshkruar Konventën kundër krimin të organizuar dhe Protokollin e Palermos Shqipëria ka pranuar, ndër të tjerash, detyrimin për ta konsideruar trafikimin e personave si krim dhe që masa e dënimit për kriminelët të rëndohet në rastet kur viktimat e trafikimit janë gra ose fëmijë.

Në zbatim të detyrimeve të Konventës u bënë ndryshime në Kodin Penal, dhe në 2005 u nënshkrua **Marrëveshja e Bashkëpunimit** për *Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (MKR)*.

Konventa e Stambollit

Në vlerën e një Traktati, Konventa përbën ndoshta instrumentin ndërkombëtar më të plotë e më të avancuar të kohëve të fundit, me natyrë detyruese në fushën e mbrojtjes së grave nga dhuna.

Së pari, Konventa merret me parandalimin e dhunës, me qëllim arritjen e një barazie të plotë gjinore, duke eliminuar diskriminimin ndaj grave, steriotipet egzistuese si dhe praktikat tradicionale që shkaktojnë dëme në shëndetin e tyre.

Së dyti, merret me mbrojtjen e viktimave përmes një ndërhyrje efektive shumëplanshe nga ana e forcave të rendit, aksesit në informacione që lidhen me të drejtat e tyre, si dhe krijimin e strukturave mbështetëse të specializuara.

Në lidhje me aspektin e ndëshkimit të ushtruesve të dhunës, ajo siguron se të gjitha format e dhunës të listuara në brendi të saj, nëse nuk kanë qënë të përfshira, duhet që nga ana e Shteteve Palë të bëhen pjesë e dokumentave të brendshëm vendor si krime të dënueshme. Gjithashtu, duhet të sigurojnë se kultura, traditat apo i ashtuquajturit “nder” nuk duhet të konsiderohen si justifikime për të tilla krime.

Së fundmi, Konventa njihet dhe pohon rëndësinë e veprimeve të ndërmarra në bashkëpunim mes qeverive, OJF-ve, organizatave ndërkombëtare si dhe të gjithë autoriteteve në nivel kombëtar, rajonal e lokal për koordinimin e politikave globale të hartuara për të luftuar dhunën gjinore në të gjitha fushat dhe sektorët e jetës publike dhe private.

Arritja e barazisë gjinore de jure e de facto është një element kyç në parandalimin e dhunës kundër grave. Dhuna kundër grave është një manifestim i marrëdhënies së forcës historikisht duke qënë të pabarabarta mes gjinive, dhuna coi në dominimin e grave dhe diskriminimin e tyre nga burrat duke penguar emancipimin e plotë të tyre.

Gratë dhe vajzat ndryshe nga burrat janë më shumë të ekspozuara ndaj rrisqeve për të pësuar dhunë

Konventa e Stambollit - Hyrje

Dy janë risitë kryesore dhe elementet kualifikues që Konventa paraqet: Aspekti i parë ka të bëjë me parandalimin. Dhuna ndaj grave duhet të luftohet përmes përdorimit që në fillim i të gjitha mjeteve qofshin institucionale dhe/ose kulturore në gjëndje të përballen paraprakisht me të. Ky element i ri ndiqet nga një tjetër i cili fokusohet në dhunën në familje. Akti i dhunës nuk i referohet vetëm keqtrajtit të grave, por, duke zgjeruar shtrirjen dhe dimensionin, përfshin në të edhe dinamikat familjare apo të çiftit.

Nga njëra anë kemi subjektin keqtrajtuës, burrë- bashkëshort, shok, baba dhe nga ana tjetër, subjekti i të miturve të cilët janë në mënyrë indirekte të përfshirë, duke vuajtur e përjetuar një klimë frike dhe abuzimi.

Në këtë kuadër kaq të avancuar gjejmë disa dispozita të cilat nga njëra anë përbëjnë motivin mbi bazën e të cilit mbështetet ky studim; e nga ana tjetër këto dispozita bëjnë që vetë studimi të japë kontributin e tij të rëndësishëm në realizimin praktik të disa aspekteve të Konventës.

Kemi parasysh përshtetjen nën 11 i cili i dedikohet mbledhjes së të dhënave dhe realizimit të kërkimeve duke i konsideruar si të rëndësishëm dhe element esencial në procesin efikas të vendimmarrjes në fushën e parandalimit dhe luftës ndaj të gjitha formave të dhunës. Ky nen i referohet në mënyrë të vecantë mbledhjes së të dhënave të disagreguara si dhe ndërmarrjes së kërkimeve periodike mbi popullsinë.

Apo përshtetjen nën 16 i cili i referohet specifikisht nevojës së madhe për të mbështetur programe drejtuar autorëve të dhunës me bazë gjinore, për ti inkurajuar në adoptimin e sjelljeve jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale apo në parandalimin e rikthimit në këto situata. Së fundmi mund të përmendim gjithashtu nën 15 i cili i referohet rëndësisë së ndërhyrjeve formuese në favor të profesionistëve të ndryshëm që punojnë me viktimat apo dhe me autorët e dhunës.

Qëllimet të Ligjit 9669

1. Parandalimi dhe ulja e dhunës në të gjitha format e saj
2. Garantimi i mbrojtjes, përmes masave ligjore të familjarëve të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i dhënë vëmendje të vecantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me paaftësi

Objektivat të Ligjit 9669

1. Krijimi i një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin
2. Orjentimi i punës mbështetëse dhe asaj parandaluese për viktimat të realizuar nga ana e autoriteteve përgjegjëse, në nivele qendrore dhe vendor
3. Forcimi i sistemit gjyqësor në marrjen e masave mbrojtëse kundër dhunës në familje
4. Sigurimi/garantimi për viktimat e dhunës në familje, i një shërbimi të shpejtë, të thjeshtë e të përshtatshëm.

Ligji 9669, Neni 1 e 2

9669 mbron në vecanti gruan si anëtarja më e abuzuar brenda familjes, në realitet ai nuk parashikon dallime (neni. 4), por ofron mbrojtje për të gjithë anëtarët e bërthamës familjare duke realizuar në këte mënyrë një nga principet themelore të barazisë gjinore.

Detyrimet e institucioneve vendore specifikohen në **VKM nr.334**, datë 07.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Ligji për barazinë gjinore Nr. 9970, datë 24.7.2008 (“Për barazinë gjinore në shoqëri”) vendos detyrime për mbrojtje efektive nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë. Në fakt Ligji 9970 i vitit 2008 parashikon se gender mainstreaming duhet të jetë qasja që duhet ndjekur me qëllim garantimin e barazisë gjinore në shoqëri, e cila con drejt një prespektive gjinore në të gjithë proceset legjislative të zhvillimit lokal dhe kombëtar.

Format e dhunës për tu sanksionuar:

Dhuna psikologjike
 Akte persekutuese (stalking)
 Dhuna fizike
 Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin
 Martesa e detyruar
 Gjymtime gjenitale femërore
 Abort dhe sterilizim i detyruar
 Ngacmime seksuale

Konventa e Stambollit - Neni 33-39

Legjislacioni i brendshëm

Qysh prej 2006, Shqipëria ka një ligj specifik në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare. Ligji 9669 “Masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” vendos detyrime për pushtetin qendror dhe lokal për të koordinuar veprimet në mbrojtje të viktimës.

Sicsugjerohet ngavetëtitulliaivendosdisapiketa bazënë fushën e luftës ndaj dhunës gjinore, duke ju referuar në vecanti dhunës së ushtruar brenda mureve të shtëpisë. Ai gjatë këtyre viteve u kthye në një instrument të rëndësishëm në luftën ndaj dhunës gjinore.

Në mënyrë eksplicite ligji pohon (neni. 3) se me dhunë në familje nënkuptojmë “çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik” duke specifikuar se i referohet dhunës “së ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare”.

Edhe pse zakonisht jemi të prirur të mendojmë se ligji

Në këtë optikë Ligji 9970 merret edhe me diskriminimin dhe nga cmimet parashikon mundësinë ku institucionet të përfshijnë masa të përkohshme speciale për ti garantuar gjinisë më pak të përfaqësuar në pozicione të ndryshme politike e të pushtetit një përfaqsim të paktën 30%.

Në të njëjtën kohë merret edhe me mbrojtjen nga diskriminimi në sektorin e arsimit, në media o në vendin e punës, ku në këtë të fundit pohojmë nevojën për të bërë vlerësime mbi punën e papaguar. Së fundmi ligji detyron institucionet publike të ndërmarrin statistika të disagreguara sipas gjinisë, si dhe futjen e organeve dhe instrumentave të rinj institucional për promovimin e barazisë gjinore.

Nga sa më sipër, duket qartë se dispozitat pjesë e këtij ligji, të hartuara për të garantuar barazinë gjinore, synojnë të aplikohen si për burrat ashtu edhe për gratë në të gjitha fushat ku ato nuk respektohen. Duke thenë këtë, edhe ligji 9970 i rezervon një trajtim të vecantë grave, si në rastin e nenit 9 i cili lejon institucionet publike dhe private të adoptojnë masa të vecanta të cilat garantojnë një mbrojtje të vecantë për gratë gjatë shtatzanisë dhe lindjes; nënave të reja dhe prindërve të rinj, pas lindjes o adoptimit të një fëmije, duke krijuar kushtet për të mbrojtur apo lehtësuar punën e tyre; duke garantuar siguri e mbrojtje sociale; duke ofruar asistencën e duhur për shëndetin e nënës dhe fëmijës; duke siguruar e promovuar sistemin e shërbimeve sociale përmes favorizimit të zhvillimit të rrjetit të cerdheve dhe kopshteve; duke limituar realizimin e punëve të rënda o shfrytëzuese për gratë gjatë shtatzanisë o gjatë ushqimit të fëmijëve me gji.

Akte nënligjore

Akte nënligjore të rëndësishme përfshijnë

1. **Marrëveshjen e Bashkëpunimit për zbatimin e Ligjit Nr.9669** datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare”, nënshkruar në 14.11.2008 ndërmjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit.
2. **Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr.379**, datë 03.03.2008 “Për Masat që do të ndërmerren nga Policia e Shtetit për Parandalimin dhe Reduktimin e Dhunës në Familje”.
3. **Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 981** datë 31.10.2008 “Për Masat që do të ndërmerren nga Policia e Shtetit për Parandalimin dhe Reduktimin e Dhunës në Familje dhe për trajtimin e viktimave të dhunës në familje”.

Referencat per konventat ndërkombëtare

- ¹ **Ligji nr. 7531 datë 11. 12.1991**, shih: www.punetejashtme.gov.al/al/dokumenta/konventa-dhe-raporte-per-te-drejtat-e-njeriut
- ² **Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002**, shih: Fletore Zyrtare nr. 41, Korrik 2002, i njohur ndryshe si **Protokolli i Palermos**
- ³ **Ligji nr. 9052 datë 17.04.2003**, shih: Fletore Zyrtare nr. 38, Maj 2003 - www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2003/PDF-2003/38-2003.pdf
- ⁴ **Ligji nr. 9265, datë 29.07.2004**, shih: Fletore Zyrtare nr. 56, Gusht 2004 - www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2004/PDF-2004/56-2004.pdf
- ⁵ **Ligj Nr. 9642, datë 20.11.2006**, shih: Fletore Zyrtare nr. 132, Dhjetor 2006 - www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2006/PDF-2006/132-2006.pdf
- ⁶ **Ligj nr. 10071, datë 9.02.2009**, shih: Fletore Zyrtare nr. 21, Mars 2009 - www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2009/PDF-2009/21-2009.pdf
- ⁷ **Ligj Nr. 104, datë 19.11.2012**, shih: Fletore Zyrtare 150, date 23.11.2012, i njohur ndryshe si **Konventa e Stambollit**
- ⁸ **Ligj nr. 150 datë 21.12.2015** shih: Fletore Zyrtare Nr. 246, Janar 2015 - http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/246.pdf

2 POZICIONI dhe ROLI i strukturave vendore kundrejt trafikimit dhe dhunës në familje

Punonjësit e Bashkisë

Pozicioni i punonjësve të bashkisë në raport me gratë viktime të dhunës e të trafikimit dhe me punonjës të institucioneve të tjera është i përshkruar kryesisht në:

- **Ligj Nr. 9669**, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”
- **Ligj nr. 121/2016** “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligj Nr.18/2017**, datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Urdhër Nr. 139** datë 19.06.2006 “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut në Njerëz”
- **VKM nr.334**, datë 07.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”
- **VKM Nr. 582**, datë 27.7.2011 “Për Miratimin e Procedurave Standarte të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”
- **Udhëzim** i ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme **nr. 10**, datë 25.2.2015, “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”
- **Vendime** të këshillit të ministrave dhe udhëzimeve të tjera në zbatim të ligjit për shërbimet shoqërore dhe ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

Sipas ligjit të ri për shërbimet e kujdesit shoqëror,² bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke identifikuar dhe vlerësuar nevojat, duke hartuar plane sociale vendore dhe duke programuar buxhetet vendore, duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore, duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit sipas egjislacionit në fuqi për prokurimin publik si dhe duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.³

Sipas ligjit, gratë e vajzat e abuzuara, të dhunuara apo të trafikuar, duhet të marrin shërbime të specializuara të kujdesit shoqëror.⁴

Punonjësit e bashkisë janë pjesë e grupimeve të përhershme ose “ad hoc” në nivel qarku ose bashkie të ngritura posaçërisht për parandalimin e fenomeneve dhe trajtimin e rasteve të dhunës dhe trafikimit.

Në mënyrë të përmbledhur, roli i këtyre grupimeve dhe përbërja me punonjës apo titullarë të bashkisë jepen në tabelën më poshtë:

<i>EMRI DHE ROLI</i>	<i>TERRITORI</i>	<i>PËRBËRJA</i>	<i>DREJTIMI</i>	<i>PUNONJËS TË BASHKISË</i>
Komiteti Rajonal i Luftës Kundër Trafikimit (KRAT) identifikimi i problemeve parësore, në nivel rajonal, në përputhje me strategjitë kombëtare antitrafik; vlerësimi i gjendjes dhe përcaktimi i nevojave specifike të qarkut ⁵	Prefektura	Prefekti i Qarkut, Kryetari i Bashkisë Qendër në Qark, Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtori Rajonal i Punësimit, Drejtori i Drejtorisë së Policisë në Qark, Drejtori Rajonal i Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtori Rajonal i Drejtorisë Arsimore, Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik.	Prefekti i Qarkut	Kryetari i Bashkisë Qendër në Qark

¹ Në seksionet më tej, përdoruesit e këtij manuali informohen me çështjet që pritet të trajtojnë këto akte nënligjore

² Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Fletore Zyrtare Nr. 236 viti 2016

³ Neni 36, “Roli i bashkisë”

⁴ Neni 3, pika 6

⁵ Më shumë në Urdhrin Nr. 139, datë 19.06.2006 “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut në Njerëz”

<i>EMRI DHE ROLI</i>	<i>TERRITORI</i>	<i>PËRBËRJA</i>	<i>DREJTIMI</i>	<i>PUNONJËS TË BASHKISË</i>
Tryeza Teknike Antitrafik Tryeza Teknike Antitrafik zbatimi i strategjive kombëtare antitrafik në përputhje me masat e parashikuara për secilin institucion, mbledhja dhe shkëmbimi i të dhënave, identifikimi, referimi dhe zgjidhja e rasteve konkrete, paraqitja e problemeve dhe zgjidhja e tyre, përcaktimi i veprimeve të nevojshme për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e familjeve, grupeve, personave dhe fëmijëve në rrezik aktual ose potencial trafikimi, si edhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrave vendore antitrafik.	Prefektura/Një për KRAT	Përfaqësues nga drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror, drejtoria rajonale e punës, zyra e përkujdesjes shoqërore në bashki, shefi i sektorit antitrafik i policisë së qarkut, përfaqësues nga drejtoria rajonale e SHISH-it, përfaqësues nga drejtoria rajonale arsimore, inspektori i shëndetit riprodhues (nëna dhe fëmija), përfaqësues i prokurorisë së qarkut, përfaqësues të OJF-ve. ⁶	Sekretari i Prefekturës	Zyra e përkujdesjes shoqërore në bashki

<i>EMRI DHE ROLI</i>	<i>TERRITORI</i>	<i>PËRBËRJA</i>	<i>DREJTIMI</i>	<i>PUNONJËS TË BASHKISË</i>
Ekipi teknik ndërdisiplinor	Bashkia	Përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuar në komitet si: përfaqësues të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve, nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të qeverisjes vendore, profesionistë të lirë: avokatë, psikologë etj	Koordinatori vendor i dhunës në marrëdhëniet familjare Koordinatori i Mbrojtjes së fëmijëve	Koordinatori vendor i dhunës në marrëdhëniet familjare Punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës Drejtori i drejtorisë

⁶Më shumë në Urdhrin Nr. 139, datë 19.06.2006 "Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut në Njerëz"

<i>EMRI DHE ROLI</i>	<i>TERRITORI</i>	<i>PËRBËRJA</i>	<i>DREJTIMI</i>	<i>PUNONJËS TË BASHKISË</i>
<i>Komiteti drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje</i>	<i>Bashkia</i>	Kryetari i Bashkisë, përfaqësuesi i strukturës së policisë, përfaqësuesi i Gjykatës së rrethit gjyqësor, përfaqësuesi i Prokurorisë së rrethit, përfaqësuesi i Drejtorisë arsimore, përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik, drejtuesin e strukturës për Shërbimet sociale pranë bashkisë Njesisë administrative, përfaqësuesi i Zyrës së përmbartimit, përfaqësuesi i Prefekturës, kryetarët e Njesive Administrative që janë në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki, përfaqësuesin e zyrës ërkatëse të punësimit, drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të dhunës në familje, drejtuesit e qendrave dhe strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore ose në qarkun në juridiksionin e të cilit janë këto njësi, përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së Rrethit ⁷	<i>kryetari i bashkisë</i>	<i>Drejtuesi i strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë</i>

Punonjësit e Bashkisë në vijë të parë të mbrojtjes

Koordinatori vendor i dhunës në marrëdhëniet familjare/punonjësi i dhunës në familje (KVDHF), koordinatori i mbrojtjes së fëmijëve/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve (PMF), dhe drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore (DSPSHSHB) janë punonjësit e vijës së parë të mbrojtjes nga trafikimi në bashki.

Rolet dhe detyrat e tyre jepen në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë. Tabela është mbështetur në detyrimet e përmendura në PSV-të - VKM 582, si edhe Ligjin nr 18/2017, por edhe në proceset e detritanishme të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të dy ligjeve të reja, të shërbimeve shoqërore dhe të mbrojtjes së fëmijëve. Në seksionet më poshtë të manualit jepen më shumë detaje mbi fushën e veprimeve të punonjësve të bashkisë dhe dokumentimin e tyre.

⁷ Më shumë në VKM Nr.334, datë 17.2.2011 "Për mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij"

PËR MBROJTJEN NGA TRAFIKIMI					
<i>Fushat kryesore të veprimit</i>	<i>Detyrat e koordinatorit vendor kundër dhunës në familje (KVDHF)</i>	<i>Dokumentimi kryerjes nga KVDHF⁸</i>	<i>Detyrat e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF)</i>	<i>Dokumentimi kryerjes nga PMF</i>	<i>Detyrat e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqëror (DSPSHSB)</i>
Identifikimi i viktimave të mundshme të trafikimit	Të krahasojë situatën e personit me treguesit e trafikimit Të zhvillojë me personin një intervistë të identifikimit fillestar. Të njoftojë për identifikimin eprorin e vet dhe AP-në	Njoftim elektronik i Autoritetit Përgjegjës Vërtetim lëshuar personit të identifikuar	Të krahasojë situatën e fëmijës me treguesit e trafikimit Të zhvillojë me fëmijën një intervistë të identifikimit fillestar. Të njoftojë për identifikimin eprorin e vet dhe AP-në	Njoftim elektronik i Autoritetit Përgjegjës Vërtetim lëshuar kujdestarit të fëmijës	Të monitorojë ecurinë e çdo rasti si tek NJMF ashtu edhe tek NJDHF dhe të asistojë në menaxhimin e tyre
Vlerësimi i potencialit para kthimit në familje				Raport i vlerësimit të familjes së fëmijës	
Shqyrtimi dhe gjetja e një zgjidhjeje në interesin më të lartë të fëmijës ose të rriturit viktimë	Të marrë pjesë në tryezat teknike antitrafik		Të marrë pjesë në tryezat teknike antitrafik ose të organizojë mbledhjen e GTN-së ⁹	Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes ¹⁰	Të marrë pjesë në tryezat teknike dhe Komitetin Antitrafik
Veprimet për rehabilitimin dhe reintegrimin				Veprimet për ndjekjen deri në përfundimin e rastit	

Tabela më poshtë jep rolet specifike të punonjësve të bashkisë në fushat kryesore të mbrojtjes nga dhuna në marrëdhëniet familjare sipas ligjit 9669 dhe sipas VKM-së 334. Ndryshe nga PSV-të, këto dokumenta nuk specifikojnë mënyrën e dokumentimit të veprimeve, dhe prandaj në tabelë jepen mënyrat e praktikuara të dokumentimit veprimeve të punonjësve vendorë.

⁸ Në anekset më poshtë në dokument jepen disa prej draft dokumenteve që do të kërkohet të përdoren nëse do të miratohen si pjesë e Procedurave të reja Standarte të Veprimit. Draft dokumentet janë vënë në dispozicion nga hartuesit e këtij manuali që kanë marrë pjesë në draftimin e PSV-ve

⁹ Sipas ligjit për fëmijët, funksionimi i grupit teknik ndërsektorial rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose

PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE					
<i>Fushat kryesore të veprimit</i>	<i>Detyrat e koordinatorit vendor kundër dhunës në familje (KVDHF)</i>	<i>Dokumentimi kryerjes nga KVDHF</i>	<i>Detyrat e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF)</i>	<i>Dokumentimi kryerjes nga PMF</i>	<i>Detyrat e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqëror (DSPSHSHB)</i>
Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i ndihmës	Vlerësimi i emergjencës së rasteve të informuara nga struktura apo OJF-te	Provat e mbledhura dhe administrimi i tyre nga gjykatat Vetë vendimi i gjykatës për urdhrin e menjëher-shëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes	Vlerësimi i emergjencës së rasteve të informuara nga struktura apo OJF-të	Provat e mbledhura dhe administrimi i tyre nga gjykatat Vetë vendimi i gjykatës për urdhrin e menjëher-shëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes për fëmijën.	Monitorimi i ecurisë së rasteve emergjente dhe asistimi në vazhdimi së bashku me NJMF dhe NJDHF
Shërbime direkte	Informimi për të drejtat Shoqërimi pranë shërbimeve Ruajtja e dokumentacionit Thirrja e punonjësit të policicë ose shkuarja në polici/komisariat sipas rastit Shoqërimi tek ofruesit e shërbimit Përgatitja e kërkesë-padisë për urdhër të menjëher-shëm mbrojtje ¹¹	Broshurat, fletëpalosjet, shënime të seancave të këshillimit psikosocial Komunikime shkresore me shërbimet	Informimi për të drejtat Shoqërimi pranë shërbimeve Ruajtja e dokumentacionit Thirrja e punonjësit të policicë ose shkuarja në polici/komisariat sipas rastit Shoqërimi tek ofruesit e shërbimit Përgatitja e kërkesë-padisë për urdhër të menjëher-shëm mbrojtje ¹² për fëmijën.	Broshurat, fletëpalosjet, shënime të seancave të këshillimit psikosocial. Komunikime shkresore me shërbimet.	

që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial

¹⁰ Spas ligjit për fëmijët, neni 54, "plani individual i mbrojtjes", procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimi e përmbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE

<i>Fushat kryesore të veprimit</i>	<i>Detyrat e koordinatorit vendor kundër dhunës në familje (KVDHF)</i>	<i>Dokumentimi kryerjes nga KVDHF</i>	<i>Detyrat e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF)</i>	<i>Dokumentimi kryerjes nga PMF</i>	<i>Detyrat e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqëror (DSPSHSHB)</i>
Koordinimi i veprimeve	Hartimi dhe rifreskimi i listës së shërbimeve	Koordinimi i veprimeve	Hartimi dhe rifreskimi i listës së shërbimeve	Hartimi dhe rifreskimi i listës së shërbimeve për femijet e dhunuar	
Parandalimi i përsëritjes së dhunës, shfrytëzimi, trafikimit të qenieve njerëzore	Monitorimi i rasteve të dhunës. Organizimi i aktiviteteve për informim Organizimi i aktiviteteve të trajnimit	Parandalimi i përsëritjes së dhunës, shfrytëzimit, trafikimit, lypjes dhe abuzimit ndaj fëmijëve.	Hartimi dhe rifreskimi i listës së shërbimeve	Hartimi dhe rifreskimi i listës së shërbimeve për femijet e dhunuar	Monitorimi i ecurisë së rasteve emergjente dhe asistimi në vazhdimi së bashku me NJMF dhe NJDHF

Punonjësit specialistë/të dedikuar degëve të institucioneve qendrore

Punonjësit e bashkisë duhet të bashkëveprojnë me individë/profesionistë nga degë të institucioneve qendrore të caktuar për tu marrë posaçërisht me dhunën në familje dhe trafikimin që janë:

Punonjës të Sektorit të Luftës kundër Trafiqeve të Paligjshme të Policisë - janë punonjës të policisë në drejtoritë vendore të policisë.

Punonjës të sektorit të mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje - janë punonjës të policisë - në drejtorinë e përgjithshme të policisë ata janë punonjës të drejtorisë për hetimin dhe parandalimin e krimeve, sektori për të miturit dhe dhunën në familje, ndërsa drejtoritë vendore të policisë janë specialistë për të miturit dhe dhunën në familje.

¹¹ Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin: a) vetë viktimat; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) policia/prokuroria; ç) personi me të cilin viktimat ka marrëdhënie familjare; d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

¹² Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin: a) vetë viktimat; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) policia/prokuroria; ç) personi me të cilin viktimat ka marrëdhënie familjare; d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Personat përgjegjës në Drejtorinë e Shëndetit Publik - këta janë punonjës në secilën Drejtori të Shëndetit Publik, përgjegjës raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 9669, datë 18.12. 2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”¹³ nga të gjitha institucionet shëndetësore të rrethit duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet e tjera përgjegjëse që punojnë me problemet e dhunës në rrethin përkatës.¹⁴

Modele të Mekanizmave Vendorë

Në zbatim të parashikimeve dhe modelit të VKM 334, në bashki janë vendosur marrëdhënie zyrtare dhe janë firmosur marrëveshje ndër-institucionale që detajojnë me tej parimet e bashkëpunimit si dhe rolin e procedurat e institucioneve.

Në anekset janë një ekstrakt nga Marrëveshja për ngritjen e mekanizmit në Vlorë¹⁵ dhe një marrëveshja për shërbimin e emergjencës ka midis bashkisë dhe ojf Gruaja te Gruaja në Shkodër.¹⁶

¹³Vendosur me Urdhër të ministrit Nr. 410, datë 12.07.2010 “Për riorganizimin e shërbimit shëndetësor dhe psikosocial, për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare të paraqitur në institucionet shëndetësore”

¹⁴ http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Shendeti_Publik/pdf_moduli_dhunes.pdf

¹⁵Vënë në dispozicion nga Vatra, për më shumë shih në: <http://qendravatra.org.al/>

¹⁶Ndërtesa është vënë në dispozicion në 2015 nga Bashkia dhe rinovuar nga Organizata. Për më shumë shih në: <http://www.grujatekgruaja.com/index.php/al/component/tags/tag/24-shkoder>

3 IDENTIFIKIMI i grave dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mbështetje

Identifikimi i viktimave të trafikimit, dhunës dhe abuzimit ka disa qëllime. Ndër më të rëndësishmet janë: ndalimi i menjëhershëm i shkeljes së të drejtave të njeriut, grave dhe fëmijëve në veçanti, dhënia e aksesit tek shërbimet e shëndetit, shërimi i pasojave dhe funksionimi normal sa më i shpejtë, trajtimi i nevojave të veçanta, prandalimi i pasojave afatgjata dhe riviktimizimit, mënjanimi i infiltrimit të dhunuesve etj.

3.1 - DETYRIMI I IDENTIFIKIMIT TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Punonjësit e sektorit social të Bashkisë, qoftë punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, qoftë koordinatorët vendorë të dhunës kanë detyrim identifikimin e fëmijëve apo të rriturve viktimë të trafikimit. Identifikimi është një term i përdorur kryesisht në fushën antitrafik, që nënkupton një individ apo një agjenci e cila konstaton apo arrin në përfundimin që një person është i/e trafikuar. Dokumenti kryesor ku janë përcaktuar detyrat për identifikimin e viktimave të trafikimit përfshirë viktimat fëmijë është dokumenti i PSV-ve.¹ Identifikimi është i dy tipeve apo fazave, ai ndahet në: identifikim fillestar dhe identifikim zyrtar/formal.

Identifikimi fillestar mund të bëhet nga punonjës të agjencive të ndryshme shtetërore dhe joshtetërore duke e krahasuar informacionin mbi situatën e personit të rritur apo fëmijë me një listë treguesish të trafikimit dhe nëpërmjet një interviste të shpejtë. Në përfundim të procesit, punonjësi e konsideron personin si viktimë të mundshme të trafikimit dhe e trajton atë si të tillë. Personat të cilët konstatohen si viktimë të mundshme të trafikimit informohen për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion të viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit dhe mënyrat e qasjes tek ndihma, si edhe vendosen tek ndihma që është e përshatshme për ta/to.

Identifikimi formal është në një fazë të dytë, pasi personi është identifikuar si viktimë e mundshme trafikimi. Ai zhvillohet nga një punonjës social dhe një punonjës i policisë së specializuar antitrafik të quajtur Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF) të cilët kryejnë me personin një intervistë të thelluar. Në fund të procesit të identifikimit formal, personat referohen tek ndihma e përshtatshme dhe e zgjedhur prej tyre. Sipas procedurave aktuale intervista duhet të kryhet nga një punonjës social i shërbimit social shtetëror rajonal. Diskutimi për rishikimin e procedurave ka vendosur që në intervistimin formal dhe përcaktimin nëse një person është viktimë e trafikimit do të marrin pjesë punonjësit socialë të bashkive.

3.1.1 - Mjetet e identifikimit

Mjetet e identifikimit të viktimave të trafikimit janë treguesit dhe intervistat. Treguesit dhe formatet e intervistave janë të dhënë në dokumentin e PSV-ve.²

3.1.2 - Praktikrat dhe sfidat e identifikimit

Rastet e mëposhtme janë shembuj nga praktika e identifikimit dhe trajtimit të viktimave të trafikimit. Qëllimi i paraqitjes së tyre është për të kuptuar më mirë disa nga sfidat praktike të identifikimit.

T.F. ishte 15 vjeç. E kishin çuar në polici sepse ishte shumë agresive, abuzonte me alkoolin. Kishte probleme me një grua fqinjë, gruaja gjithmonë njoftonte policinë. Vajza kishte shkuar në polici mbi njëzet a tridhjetë herë si dhunuese, si problematike ajo vetë. Vajza nuk pranonte të trajtohej e megjithatë policia e nëna e saj e çuan të merrte shërbime tek organizata. Vajza filloi të trajtohej nga organizata duke qëndruar në familje. Psikologjia e organizatës që e trajtonte e sheh një herë shumë vonë natën, në mes të rrugës.

Ndalon, e fton ta çojë në shtëpi por ajo i shmanget. Psikologjia konsideron se rasti është potencial trafikimi dhe njofton koordinatorin e dhunës dhe grupin teknik. Diskutohet vendosja e vajzës në një qendër për viktimat e trafikimit por kjo nuk është e mundur për shkak se qendra ekzistuese nuk akomodon vajza të kësaj moshe, dhe për shkak se e ëma e vajzës duhet të bëjë kallzim penal gjë që ajo nuk e bën. Bashkia e referon në një qendër për gra, vajza dhe të rinj në një qytet pranë. Vajza qëndron aty për rreth një muaj.

¹ VKM Nr . 582, datë 27.7.2011, “Për Miratimin e Procedurave Standarte të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit“

² Shih më poshtë në anekse për formatet ekzistuese dhe draft të PSV-ve

Gjatë qëndrimit i hapet një punonjëseje dhe i tregon se kur ka qenë në klasën e shtatë - kohë kur e ka ndërprerë shkollën, e kanë abuzuar seksualisht. Grupi teknik i qendrës: doktoresha infermierja, psikologja, bien dakord që për shkak të sjelljeve agresive, vetëdëmtuese, vajza duhet të shtrohej në spital.

Në spital trajtohet për çrregullime të personalitetit. Pasi doli nga spitali, qendra në qytetin tjetër e mori edhe një herë e pastaj thanë që “ne nuk mund të bëjmë asnjë gjë, heqim dorë prej saj sepse është duke dëmtuar qendren. Kanë thënë shprehimisht “bëni çfarë të doni me të”. U mbledh përsëri grupi multidisiplinar dhe vajza u rivendos përsëri për një kohë shumë të shkurtër tek organizata. Nuk dihet nëse abuzimi i saj është raportuar ndonjëherë në polici apo në prokurori. Raporti i saj i paqëndrueshëm me ndihmën “një herë vjen e kërkon të flasë me psikologun e qendrës dhe pastaj zhduket për një muaj” e bën të pamundur të zbulosh se çfarë ka ndodhur në të vërtetë.

Na ndodh që na vjen shërbimi social në qendër dhe na gjen raste të cilat janë viktime të mundshme të trafikimit, dhe na thotë: “mos i mbani kështu, çojini për intervistë formale!”

Na ndodh që na vjen shërbimi social në qendër dhe na gjen raste të cilat janë viktime të mundshme të trafikimit, dhe na thotë: “mos i mbani kështu, çojini për intervistë formale!”

3.1.3 - Çfarë duhet të dimë për të identifikuar viktimat e trafikimit

a) Të njohim mjetet e identifikimit - Treguesit e identifikimit fillestar dhe strukturën e intervistave

Identifikimi fillestar i fëmijëve apo të rriturve viktime të trafikimit duhet të bëhet në bazë të treguesve dhe mënyrës së dhënë në PSV.

Këta tregues janë të ndryshëm për situata të ndryshme të kontaktit me fëmijët ose të rriturit- për sektorë të ndryshëm. Punonjësit e bashkisë duhet të përdorin treguesit për kontaktin e sektorit të tyre me femrat viktime të mundshme të trafikimit. Identifikimi formal bëhet nëpërmjet intervistimit formal në ambjentet e policisë dhe në rastin e viktimave fëmijë, pjesëmarrës në intervistim është PMF-ja.³

Më poshtë jep në mënyrë të përmbledhur disa nga treguesit që mund të përdoren nga punonjësit e bashkisë për identifikimin e viktimave të mundshme- për të krijuar dyshimin se një person fëmijë është i/e trafikuar.

Për të identifikuar fëmijët disa nga treguesit mund të jenë:

- Fëmija është i/e sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para
- Fëmija ka lëvizur i/e paregjistruar asnjëherë në gjendje civile
- Fëmija largohet shpesh nga shtëpia
- Fëmija vetë, prindërit e tij/saj dhe motra vëllezër kanë qenë shpesh në kontakt me policinë dhe NJMF-në si pasojë e ekspozimit, pësimit të dhunës
- Fëmija ka një numër të kufizuar kontaktesh
- Fëmija kalon pjesën më të madhe të kohës në rrugë duke shitur, duke lypur, duke punuar
- Fëmijës i merren të ardhurat nga lypja, puna, veprimtaria nga më të rriturit
- Fëmija është i punësuar në mënyrë të paligjshme, punon në punë të rrezikshme
- Fëmija ka shenja dëmtimi që tregojnë se ai/ajo punon
- Fëmija ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme
- Fëmija shfaq frikë, është i/e tërhequr
- Fëmija ka mosbesim tek autoritetet
- Fëmija tregon histori të ngjashme dukshëm të mësuara
- Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund të ketë moshën ose paraqitjen për t’u përgjigjur vetë
- Fëmija është i/e veshur keq, i/e paushqyer, i/e pakujdesur, pa gjumë të mjaftueshëm
- Fëmija deklaron se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/e kënaqur që ka rënë në kontakt me persona/autoritete që japin ndihmë dhe jep shenja se kërkon ndihmë
- Fëmija ka shenja në trup, (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj

³ Zyrtarizimi i treguesve pritet të bëhet me VKM

- Fëmija nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm
- Fëmija fle në rrugë/është kapur duke vjedhur
- Fëmija frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura, etj)
- Fëmija që lyp duket i/e lënë pas dore, është i/e kequshqyer/veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike.

Për të identifikuar të rriturit, viktimë të mundshme të trafikimit disa nga treguesit mund të jenë:

- Personi është sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para
- Personi ka një numër të kufizuar kontaktesh
- Personi është i/e punësuar në mënyrë të paligjshme/punon në punë të rrezikshme
- Personi ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme
- Personi është nga një vend i njohur si vend origjine
- Personi nuk është në gjendje të tregojë dokumentat e identitetit
- Personi lejon të tjerët të flasin për të
- Është i/e të paafte të komunikojnë lirshëm me të tjerët
- Shfaq ankth dhe frikë gjatë komunikimit
- Nuk ka akses të shërbimi mjekësor
- Është në punë të paligjshme
- Personi nuk kujdeset për higjienën e vet
- Personi ka shenja në trup, (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj
- Personit ia ka rregulluar punën, shkollën një person i cili/ e cila ka marrëdhënie biznesi me punëdhënësin/punëdhënësen
- Personit nuk i është lejuar të zgjedhë strehimin.

Aktualisht identifikimi fillestar i viktimës së mundshme bëhet duke u bazuar tek treguesit. Parashikohet që përveç treguesve, punonjësit e bashkisë dhe punonjësit e agjencive të tjera të kenë në dispozicion dhe të përdorin një format të intervistimit fillestar që do të mbledhë informacion të mjaftueshëm për të zbuluar nëse lidhja mes treguesve është ajo e trafikimit, dhe do të ndihmojë për të vlerësuar më mirë formën e ndërhyrjes.

b) Ka dallim midis personit në “rrezik trafikimi” dhe personit “viktimë e mundshme e trafikimit”

Termi “rrezik trafikimi” përdoret për persona të cilët kanë vështirësi sociale, ekonomike, familjare të cilat sipas statistikave apo të dhënave empirike rezultojnë si karakteristika të viktimave të mundshme të trafikimit ose viktimave të trafikimit por ata nuk janë trafikuar. Thënë me fjalë të thjeshta, një vajzë në rrezik trafikimi është një vajzë në një familje pa të ardhura, me prindër që nuk i mbikëqyrin fëmijët etj. Kjo vajzë do të quhej viktimë e mundshme e trafikimit nëse punonjësi i bashkisë apo punonjës të tjetër të detyruar të zhvillojnë identifikimin fillestar do të kishin informacion se dikush e ka rekrutuar me qëllim për ta shfrytëzuar ose po e shfrytëzon.

c) Ka dallim mes trafikimit dhe kontrabandimit/ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit

Shpesh, kur lëvizja bëhet nga një shtet në tjetrin, trafikimi dhe kontrabandimi ngatërrohen me njëra tjetrën, dhe kjo ngatërresë ka pasoja të rënda për personin që është viktimë e trafikimit - njëra prej tyre është dënimi për kalimin e paligjshëm të kufirit -, burgosja, gjoba, ndalimi i hyrje daljeve të mëvonshme në shtetet e tjera. Kemi të bëjmë me kontrabandim kur kalimi i kufirit bëhet me dëshirën e personit që do të kalojë kufirin, marrëdhëniet mes personit që ndihmohet dhe atij që ndihmon ndërpriten menjëherë sapo arrihet në destinacion.

Viktima nuk është personi që kalon kufirin por është shteti të cilit i shkelen kufijtë në mënyrë të paligjshme. Kemi të bëjmë me trafikim kur personi që kalon kufirin bën këtë me ose kundër vullnetit të tij/saj, marrëdhëniet nuk ndërpriten pas arritjes në destinacion por vazhdojnë kundër dëshirës së personit dhe duke mos iu përbajtur asaj për të cilën është rënë dakord. Trafikimi dhe ndihma për kalim të paligjshëm⁴ konsiderohen të dyja si vepra penale të dënueshme nga Kodi Penal por masa e dënimit është e ndryshme për shkelësin e ligjit/ trafikantin apo kontrabandistin, dhe trajtimi i personit që kalon kufirin është shumë i ndryshëm: personi i kontrabanduar do të dënohet për shkelje të paligjshme të kufirit.

⁴ Neni 298 i Kodit Penal “Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit ose mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet”

ç) Ka dallim mes trafikimit të të rriturve dhe trafikimit të fëmijëve

Trafikimi i të rriturve sipas Kodit Penal “është rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”⁵

Trafikimi i personave të rritur ka tre elementë : 1.veprimet për çuarjen në shfrytëzim, 2. metodat e çuarjes dhe mbajtjes nën shfrytëzim dhe 3. shfrytëzimin e synuar ose të ndodhur.

<p>Veprime me qëllim çuarjen në shfrytëzim Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave</p>	<p>Metodat: rrëmbimi, mashtrimi, shpërdorimi i detyrës ose përfitimi nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënia apo marrja e pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër</p>
<p>Shfrytëzimi seksual, i punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënia në përdorim ose transplantimi i organeve, si dhe forma të tjera të shfrytëzimit</p>	

Trafikimi i fëmijëve/të miturve sipas Kodit Penal është “Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”. Siç mund të vihet re, në përkufizimin e trafikimit të të miturve, pjesa e metodave me të cilat është rekrutuar, transportuar etj. fëmija nuk ka rëndësi: kemi të bëjmë me trafikim nëse fëmija është marrë me qëllim shfrytëzimin.

<p>Veprime me qëllim çuarjen në shfrytëzim Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave</p>
<p>Shfrytëzimi Shfrytëzimi i prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, i punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimi ose forma të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe forma të tjera të shfrytëzimit</p>

d) Nuk ka dallim mes trafikantëve dhe shfrytëzuesve me lidhje gjaku me viktimën dhe atyre pa lidhje gjaku me viktimën

Për fat të keq, prindërit, motrat, vëllezërit, të afërmit janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve ose personave të rritur të cilët nuk mund të kujdesen për veten ose nuk mund të marrin vetë vendime.

Në disa raste, edhe pse jo të shpeshta, trafikimi nis me shitjen e fëmijëve nga vetë prindërit, ose janë vetë prindërit të cilët bien dakord me palë të treta për t’i zhvendosur fëmijët në një qytet apo në një vend tjetër me qëllim që fëmijët të nxjerrin të ardhura për ta. Në raste të tjera, prindër, të afërm apo të rritur të cilët i kanë shfrytëzuar fëmijët në vendin e tyre të origjinës/rezidencën e tyre të përhershme/o ambjentin në të cilin ata kanë familjarë dhe njohje për mbështetje zhvendosen së bashku me fëmijën apo të rriturin në kushte dhe ambiente në të cilat ai/ajo mund të nxjerrë më shumë para/të ardhura, të punojë më shumë etj.

Të qenit prind apo familjar apo të lëvizurit bashkë me fëmijën apo personin nuk e përjashton prindin, të rriturin nga përgjegjësia penale, përkundrazi e rëndon përgjegjësinë e tij apo saj. Të paturin prind, të afërm si

⁵ Neni 110/a i Kodit Penal

dhunues apo trafikant nuk e lehtëson qenien viktimë, por përkundrazi e rëndon atë më shumë dhe rrit shanset për riviktimizim dhe forma të shfrytëzimit edhe më ekstreme nga prindi vetë e nga palë të tjera që marrin në konsideratë/imitojnë lirisht qëndrimin e prindit.

dh) Nuk ka dallim mes viktimës që do të bashkëpunojë dhe asaj që nuk do të bashkëpunojë me autoritetet e zbatimit të ligjit

Viktima e trafikimit ka të drejtë por jo detyrim t'i drejtohet organeve të zbatimit të ligjit për tu identifikuar si i/e tillë dhe për të marrë mbrojtje. Ai/ajo mund ti drejtohet edhe institucioneve të tjera pa pasur nevojë të ketë kontakt me policinë, prokurorinë apo gjykatat. Mospranimi për të kontaktuar me organet e zbatimit të ligjit nuk duhet në asnjë mënyrë të përdoret si argument për të mos e identifikuar dhe për të mos i dhënë ndihmë.

e) Burimet e ndihmës

Identifikimi është hapi i parë drejt ndihmës dhe bëhet me qëllimi dhënien e ndihmës dhe mbrojtjes. Punonjësit duhet të njohin burimet e ndihmës për të qenë në gjendje të ndihmojnë personat e identifikuar të zjedhin ndihmën e përshtashme për ta.

ë) Identifikuesit e tjerë dhe mjetet e format që përdorin ata

Përveç punonjësve të bashkisë, detyrimin për identifikim e kanë edhe punonjës të institucioneve të tjera të nivelit qendror ose vendor si p.sh. mësuesit, psikologët, punonjësit e policisë, punonjësit e inspektoriatit të punës etj. Treguesit që ata përdorin janë të ngjashëm me ata të punonjësve të bashkisë por jo identikë.

f) Identifikimi mund të ketë kuptim të ndryshëm për forcat e zbatimit të ligjit

Termi "Identifikimi i personave të trafikuar" është i lidhur ngushtë me termin "klasifikimi i krimeve".

Objekti kryesor i klasifikimit të krimeve është kapja e kriminelëve dhe ndalimi i veprimtarive kriminale dhe klasifikimi i krimeve mund të bëhet vetëm nga një personel i autorizuar i agjensive të zbatimit të ligjit ose nga gjykata e shkallës së parë në përputhshmëri të plotë me normat e procedurës kushtetuese dhe penale, në mënyrë që të respektohet parimi i prezumimit të pafajsisë së të akuzuarit. Identifikimi i personave të trafikuar para së gjithash synon ofrimin e ndihmës së nevojshme për to. Identifikimi mund të kryhet përveç policisë edhe nga specialist të tjerë të cilët mund të kenë kontakt me personat e trafikuar: inspektorët e punës, punonjësit socialë, specialist të OJF-ve që ju vijnë në ndihmë personave të trafikuar.⁶

Ka raste që ndërsa nga punonjësit socialë kur flitet për identifikim kuptohet viktima, nga policia kuptohet identifikimi i personit të cilit i atribuohet vepra penale. Kjo mënyrë të kuptuari përforcohet edhe nga mënyra e zakonshme tradicionale e matjes së performancës: për punonjësit socialë matja kryehet me numrin e viktimave të ndihmuar ndërsa për policinë me numrin e autorëve të kapur e të cuar në prokurori apo gjykatë. Në disa raste kjo do të thotë që fëmija i cili shfrytëzohet për vepra penale të konsiderohet si autor dhe të ketë mosmarrëveshje mes punonjësve sociale dhe punonjësve të policisë lidhur me trajtimin që i duhet bërë një fëmije, sidomos atij që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

g) Jo të gjithë fëmijët në situatë rruge janë viktima të mundshme apo viktima të trafikimit

Fëmijët në situatë rruge janë të rrezikuar/cënuar nga trafikimi dhe në një përqindje të lartë të rasteve ata janë viktima trafikimi.

3.1.4 - Çfarë duhet të bëjmë për të identifikuar viktimat e trafikimit?

a) Të njohim dhe të zbatojmë parimet etike të identifikimit dhe ndihmës për viktimat e trafikimit

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh) qysh në vitin 2003 ka dhënë rekomandimet etike dhe të sigurisë për të intervistuar gratë e trafikuar.⁷

Këto parime janë: 1.Mos Dëmto; 2.Njihe atë që do të intervistosh dhe vlerëso rreziqet; 3.Përgatitu për referim; 4.Përgatit si duhet përkthyesit dhe bashkëpunëtorët; 5.Siguro anonimitet dhe konfidencialitet; 6.Merr leje të informuar; 7.Dëgjo dhe respekto zgjedhjet e gruas lidhur me situatën e saj; 8.Mos e ritraumatizo gruan; 9.Përgatitu për ndërhyrje emergjente; 10.Përdore informacionin për qëllime të mira.

⁶ Rrjeti Ariadne, 2012, Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, http://ariadnet.net/pdfs/Ariadne_manual_albanian.pdf

⁷ Cathy Zimmerman and Charlotte Watts, WHO ethical and safety recommendations for interviewing trafficked women, World Health Organization, 2003

b) Të kryejmë identifikimin në kohën më të shpejtë të mundshme:

Identifikimi sa më i hershëm i grave dhe fëmijëve viktime të trafikimit ka një rëndësi të jashtëzakonshme së pari për të trajtuar sa më parë që është e mundur traumat fizike dhe psikologjike të viktimeve dhe për të ndaluar traumat e tjera. Në disa raste mungesa e identifikimit rrit rrezikun për jetën të grave dhe fëmijëve në nevojë për ndihmë. Identifikimi sa më i shpejtë është i nevojshëm edhe për të ndaluar zhvillimin e asaj që quhet “Sindroma Stockholm” - sindroma e lidhjes mes pengut dhe pengmarrësit dhe justifikimit të pengmarrjes dhe pengmarrësit nga viktime/ pengu, apo zhvillimi i asaj që quhet faza e depresionit, mungesës së shpresës.

c) Të marrim masa që të mos ndodhë dënimi i viktimeve

Veprimet e paligjshme të kryera gjatë trafikimit nuk dënohen Sipas Kodit Penal (Neni 52/a), personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme. Veprat penale të cilat viktimat janë detyruar të kryejnë rëndom janë ushtrimi i prostitucionit (neni 113), vjedhja (134) prodhimi dhe shitja e narkotikeve (neni 283) kultivimi (neni 284) etj. Mosidentifikimi i grave dhe fëmijëve që janë rekrutuar me qëllimin e shfrytëzimit për veprimtari të paligjshme si viktime të trafikimit mund të krijojë rrezik që ata të ndiqen penalisht dhe të dënohen.

ç) Të informojmë viktimat se nuk janë fajtores

Viktimat mund ta quajnë veten fajtores për atë që u ka ndodhur, mund ta ndiejnë vetën përgjegjëse dhe bëhen përgjegjëse para ligjit për vepra të kryera para dhe gjatë trafikimit, mund të mos e dinë se kanë të drejtën e përjashtimit nga dënimi, mund të mos e konsiderojnë të rëndësishme dhe të përshtatshme ndihmën që u ofrohet viktimeve.

e) Të mos përfshihemi në intervistim nëse kemi paragjykim

Profesionistët mund të ndajnë qëndrime të përgjithshme stigmatizuese ndaj viktimeve, mund të mos shohin vlerë në identifikimin, mund të konsiderojnë viktimën fajtor/e për prishjen e familjes apo shoqërisë. Duhet marrë masa që njerëz të tillë të mos përfshihen në identifikim.

f) Të kuptojmë se kur mund të ndërhyjmë vetë dhe kur duhet të kërkojmë ndihmën e policisë

Në disa raste, punonjësit e bashkisë mund të jenë në gjendje të bëjnë një vlerësim të saktë të situatës së gruas dhe fëmijës dhe të ndërmarrin veprime që të sigurojnë ndërprerjen e shfrytëzimit dhe të kontrollit nga trafikanti. Megjithatë në disa raste kjo është e pamundur : gruaja mund të mos dojë të komunikojë me punonjësen apo punonjësin e bashkisë për arsye se ka frikë që ndarja e informacionit me të do të rrezikonte atë vetë më shumë por edhe vetë punonjësen apo punonjësin ose persona të tjerë. Në rast të dyshimeve të tilla, punonjësi i bashkisë duhet të vihet menjëherë në kontakt me policinë dhe të kërkojë ndërhyrjen e saj.

g) Për identifikimin e fëmijëve duhet të sigurohem se njoftohet Autoriteti Përgjegjës

Punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve të cilët identifikojnë vetë ose iu referohen raste të fëmijëve viktime të mundshme të trafikimit, duhet të sigurohen që për identifikimin është njoftuar jo vetëm ASHDMF-ja por edhe Autoriteti Përgjegjës për viktimat e trafikimit.

gj) Të kuptojmë hezitimin dhe frikën që njerëzit kanë për të identifikuar viktimat e trafikimit dhe të informojmë mënyrat anonime e të sigurt

Për shkak të frikës nga trafikantët, për shkak të stigmës që ekziston, dhe për shkak të eksperiencave negative që kanë patur më parë nga mosruajtja e sekretit të raportimit, por edhe të rritjes së natyrshme nivelit të rrezikut të hakmarrjes në rastet e kontakteve të dukshme me forcat e ligjit, viktimat e trafikimit dhe personat që duhet t'i ndihmojnë ata/ato mund të hezitojnë të komunikojnë. Për këtë arsye ata duhen informuar vazhdimisht që mund të raportojnë në mënyre anonime.

Që nga 2014, mund të raportohet në mënyrë anonime tek linja kundër trafikimit 116006 dhe aplikacioni “Raporto!Shpëto” dhe informacioni do të shkojë menjëherë tek Autoriteti Përgjegjës. Në ndjekje të rasteve, punonjësit e bashkive, njësite administrative, mund të marrin kontaktin prej anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës për të ndjekur rastet që raportohen në linjën telefonike dhe në aplikacion.

h) Të kuptojmë rrezikun e infiltrimit dhe abuzimit me mekanizmin e mbrojtjes së viktimeve të trafikimit

Në praktikën e ofruesve të shërbimit kanë qenë të rralla por gjithsesi kanë ekzistuar raste të cilat janë identifikuar si viktime të trafikimit u është ofruar ndihmë dhe gjatë qëndrimit në programet e ndihmës kanë

rekrutuar përfitues të tjerë. Është e rëndësishme që gjatë intervistimit të kuptohen mirë arsyet e kontaktit.

i) Të kuptojmë që intervista formale nuk është e detyruar dhe që ndihma mund t'i jepet njësoj si personit të identifikuar si viktimë e mundshme nga punonjësit e bashkisë ashtu edhe atij të identifikuar nga punonjësit e policisë.

Një person mund të identifikohet si viktimë e mundshme nga institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar përfshi edhe punonjësit e bashkisë. Të gjithë punonjësit e Agjencive/Institucioneve Përgjegjëse për Identifikim Fillestar, përfshirë punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje konsiderohen se kanë autoritetin dhe njohuritë e duhura për të identifikuar viktimat e mundshme të trafikimit. Personi i identifikuar si viktimë e mundshme mund të akomodohet në një qendër për viktimat e trafikimit dhe të marrë shërbimet e nevojshme edhe nëse ai apo ajo nuk dëshiron të ketë kontakt me policinë dhe me shërbimin social shtetëror - të zhvillojë një intervistë formale nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF).

j) Të jemi proaktivë në identifikim - të mos presim të vijë viktimat tek ne por të shkojmë ne tek viktimat

Vatra, Tjetër Vizion, dhe organiza Të ndryshën & Të barabartë në Tiranë kanë ngritur në 2014 njësi të lëvizhme për identifikimin e viktimave të trafikimit. Ky model i krijuar konsiston në skuadra të vogla prej dy personash që mban kontakte me policinë dhe zhvillon aktivitete me punonjësit e vijës së parë të bashkisë të tilla si dalje në rrugë, organizimi i seminareve dhe takimeve të cilat i ndihmojnë njerëzit të vendosin kontakte dhe të identifikohen.

k) Të kuptojmë efektet e traumës tek viktimat e trafikimit

Studimet kanë treguar se kur gratë dalin nga trafikimi reagues post traumatike mund të pengojnë memorjen e tyre dhe funksionimin konjitiv njohjen. Gjatë dhe pas ngjarjeve që rrezikojnë jetën, individët mund të jenë më pak të aftë të tregojnë detaje të asaj që kanë hequr. Sipas Zimmerman parimet/ABC-ja e e kujdesit që një traumën (trauma informed care) janë: a) Mbjaj në mend që ka patur dhunë, b) Vendos kontrollin, c) Krijoni një ambient të sigurt.^{9,10}

3.1.5 - Si duhet ta dokumentojmë identifikimin e viktimave të trafikimit

PSV-të vënë në dispozicion disa formate të dokumentimit të identifikimit fillestar dhe formal. Ato janë: Njoftimi elektronik për zbatimin e detyrimit të identifikimit fillestar dhe reagimit të menjëhershë ose Kërkesë me shkrim për identifikim nga policia. **Disa prej formateve vihen në dispozicion në Aneksë.¹¹**

3.2 IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE TË DHUNËS

Sipas ligjit specifik për dhunën në familje dhe VKM-së 334 në zbatim të tij, është vetë personi viktimë e dhunës që mund të drejtohet për ndihmë në institucione apo organizata dhe procesi i identifikimit përbëhet nga elementët e hartimit të kërkesë padisë, mbledhjes së provave për në gjykatë, dhe shqyrtimit nga gjykata.

Identifikimi në mënyrë proaktive i rasteve të fëmijëve në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje përfshirë edhe fëmijët viktimat të dhunës në familje është një nga detyrat kryesore të punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve të parashikuara në ligjin e ri për fëmijët.

Ligji parashikon që identifikimi proaktiv duhet të bëhet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjet e fëmijëve në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët. Për të lehtësuar këtë, ligji u ka dhënë të drejtën të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik si dhe në rezidencën e personit juridik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës dhe kur është e nevojshme ato të kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit.¹²

⁸ Për më shumë shih në rubrikën projekte ne faqen e Tjetër Vizion- <http://tjetervizion.org/index.php?faq=list&nid=2>

⁹ A. Acknowledge violence, B. Bestow control, C. Create a safe space

¹⁰ Cathy Zimmerman, Mazedra Hossain, Kate Yun, Brenda Roche, Linda Morison, and Charlotte Watts, Stolen smiles The physical and psychological health consequences of women and adolescents trafficked in Europe, <http://www.pagasa.com>

¹¹ Si me lart - disa janë ende në draft . Përdoruesit duhet të kërkojnë formatet përfundimtare be/uploads/documenten/Stolen%20Smiles%20-%20Trafficking%20and%20Health%20(2006).pdf

¹² Neni 62 i ligjit për fëmijët, Mbrojtja e fëmijës së abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar

3.2.1 Sfidat e identifikimit

Rastet e mëposhtme janë shembuj nga praktika e identifikimit dhe trajtimit të viktimave të dhunës. Qëllimi i paraqitjes së tyre është për të kuptuar më mirë disa nga sfidat praktike të identifikimit.

Një grua me një fëmijë 6 muajsh që s'ishte nga qyteti ynë shkoi në polici për të kërkuar ndihmë. Para një muaji, bashkëjetuesi, dhe babai i fëmijës e kishte nxjerrë jashtë shtëpisë dhe ajo ishte strehuar tek motra e saj. Motra e saj, në pamundësi ta mbante i kishte thënë që t'i drejtohej policisë. Kur gruaja u paraqit në polici, punonjësi i policisë thirri NJMF-në për arsye se punonjësja e bashkisë që merej me rastet e dhunës në familje nuk ishte (mbase ishte me leje, mbase ishte jashtë shtetit) Duke qenë se është konsideruar si rast i rrezikut të lartë, është thirrur në ndihmë organizata X e cila merret me rastet e dhunës në familje.

Organizata është shprehur se nuk ka patur mundësi ta ndihmonte për arsye se kishte vetëm një qendër ditore, jo shërbime emergjence, shërbime natën për të cilin gruaja dhe fëmija kishin nevojë. Për këtë arsye NJMF i kërkoi ndihmë organizatës Y. Organizata Y. e strehoi gruan gjatë fundjavës. Ditën e hënë është thirrur grupi multidisiplinar nga NJMF dhe është diskutuar rasti. Nuk është kërkuar urdhër mbrojtje për gruan sepse policia thoshte që dhuna nuk ka ndodhur tani, ka ndodhur para një muaji. Përveç kësaj, ishte e paqartë nga kush duhej të mbrohej gruaja. Ky ishte një problem strehimi dhe rreziku ndaj fëmijës më shumë se një rast dhune në familje.

Organizata Y. nuk ka kufizim në pranimin e rasteve: ajo mund të pranojë edhe raste pa urdhër të menjëhershëm mbrojtje. Që gruaja të kthehej në familjen e origjinës, duhej të punohej me familjen e saj. NJMF ne vendin ku ishte familja e gruas bisedoi me familjen e cila deklaroi se nuk donte ta merrte gruan e re me fëmijën, por vetëm gruan, vajzën e tyre. Meqenëse gruaja nuk ishte mirë, ajo shfaqte shenja depresioni, u vendos që ishte në të mirën e fëmijës vendosja tek qendra rezidenciale e një organizate fetare të cilat e pranuan. Gruaja shkoi në shtëpinë e prindërve pas një jave. Nuk dimë se çfarë ka ndodhur me të, nëse e ka marrë fëmijën apo jo.

Zonja me inicialet E.M. afër të pesëdhjetave 50, ishte shqiptare që kishte jetuar në Itali prej shumë vitesh. Zonja ishte rritur në shtëpinë e fëmijës. Nga Italia ajo kishte komunikuar me një shoqe që e kishte patur kujdestare në konvikt dhe i kishte treguar që dhunohej nga njëri prej fëmijëve të bashkëshortit të saj. I shoqi kishte vdekur para një muaji. Para vdekjes, ai kishte qenë me Alzheimer dhe gruaja kishte të drejtat e kujdestarit rrjedhimisht edhe të drejtën për të vendosur mbi pronën e tij. Djali i tij përveçse kishte nisur procese gjyqësore për ti hequr asaj të drejtën e kujdestarisë dhe të drejtën e pasurisë para vdekjes së të shoqit, por pas vdekjes së bashku me nusen, e ka dhunuar fizikisht e psikologjikisht për ta bërë që të largohet. Me këshillën e kujdestares, gruaja nisët në Shqipëri. Nuk e gjeti shoqen e saj, kujdestaren e konviktit dhe u drejtua në Bashki.

3.2.2 - Mjetet e identifikimit

Informacioni që jep viktimat/raportimi, intervistimi nga koordinatori i dhunës, vizita mjeko-ligjore, plotësimi i akt padisë, pyetja në gjykatë për urdhrin e mbrojtjes mund të konsiderohen të gjitha si mjete apo hallka të identifikimit të viktimave të dhunës. Evidentimi i tregimi i incidenteve të dhunës dhe efektet apo pasojat e tyre mbi individin apo të tjerë, nga personi që e ka pësuar dhunën, dëshmimi i dhunës nga persona të tjerë, dokumentimi i shenjave dhe shqyrtimi i raporteve mjekësorë.

Udhëzimi i ministrave nr.10, datë 25.02.2015, i quajtur ndryshe **Protokolli i Mbrojtjes së Fëmijëve** jep në mënyrë të detajuar shenjat e abuzimit të fëmijëve duke i ndarë ato në tregues fizikë, të sjelljes së fëmijës dhe të sjelljes apo qëndrimit të prindit apo kujdestarit si edhe faktorë që ndikojnë në abuzimin e fëmijëve.

Edhe punonjësit e shëndetësisë kanë mjete të identifikimit të dhunës. Për të depistuar nëse një grua ka provuar dhunë fizike, seksuale ose abuzim psiko emocional punonjësit e qendrave shëndetësore duhet të plotësojnë një formular për dhunën në familje. Ky formular duhet të plotësohet për çdo grua, gjatë vizitës shëndetësore

¹³ Do të shërbejë si bazë për hartimin e procedurave që ligji i parashikon me vendime të këshillit të ministrave

rutine periodike në shtëpi, ose në qendër shëndetësore dhe duhet të vendoset në kartelën personale të gruas apo fëmijës që mban qendra.

Në këtë formular, në fund punonjësi mund të kategorizojë “dhunë në familje e vërtetuar”, “dhunë në familje e dyshuar” ose “mungesë e dhunës në familje”. Një kartelë klinike¹⁴ plotësohet për çdo individ që pranon, ose paraqitet në qendër dhe deklaron se ka pësuar dhunë nga një partner intim, ose anëtar tjetër në familje.

Sipas Urdhërit të Ministrisë të Shëndetësisë Nr.13 datë 23 Janar 2008, “Për pajisjen e Personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare me raportin mjekësor përkatës”, çdo person i dhunuar në marrëdhëniet familjare, që merr trajtimin diagnostikues dhe mjekues në institucionin shëndetësor publik duhet të pajiset me raportin përkatës mjekësor dhe çdo veprim diagnostikues e mjekues që personeli shëndetësor kryen ndaj personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare duhet të regjistrohet në regjistrin për evidentimin e viktimave të dhunës në familje dhe kartelën individuale për viktimat e dhunës në familje.¹⁵

3.2.3 - Çfarë duhet të dimë për identifikimin e dhunës në familje

a) Dhuna nuk përfshin vetëm dhunën fizike dhe viktimave u garantohet mbrojtje për të gjitha llojet e dhunës

Ligji 9669 konsideron si dhunë çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik dhe “Dhunë në familje” është çdo akt dhune i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.

b) Injorimi i shenjave mund të ketë pasojë fatale për viktimën

Sipas Udhërrëfyesit për punonjësit e shëndetësisë mosdallimi i dhunës me bazë gjinore (DHBGJ)¹⁶ në paciente që kanë ankësuar të përsëritura, apo injorimi i shenjave të frikës, ose stresit emocional janë shembuj të mos ofrimit të kujdesit nga personeli shëndetësor. Injorimi i shenjave mund të çojë në dëmtime më të mëdha, vrasjen, apo vetvrasjen e gruas.

c) Kontakti me policinë nuk do të thotë automatikisht që dhunuesi do të ndiqet penalisht, do të burgoset

Kodi Penal konsideron dhunën në familje si vepër penale¹⁷ dhe përfshin si veprime të dënueshme me këtë nen rrahjen, dhe çdo vepër tjetër dhune¹⁸ kanosjen serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, plagosjen e kryer me dashje që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë. Në rastet e plagosjes së lehtë, marrëdhënies seksuale me dhunë apo veprime të tjera në kuadër të dhunës në familje procedimi penal i dhunuesit nis vetëm me ankim.

ç) Identifikimi dhe referimi i dhunës në familje është detyrim i cdo individi dhe aktorëve të tjerë qendrorë dhe vendorë.

Legjislacioni aktual përcakton detyrimin për kallzimin e krimit, njoftimin apo kërkesën nga çdo individ.

- Sipas Kodit Penal,¹⁹ moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Nga ky detyrim përjashtohen nga të paralindurit dhe të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti, adoptuesi dhe të adoptuarit, si edhe personat që janë të detyruar të ruajnë një sekret të njohur për shkak të detyrës apo profesionit.
- Sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës,²⁰ çdo person fizik apo juridik që ka informacion, ose vetë fëmija duhet të njoftojë institucionet qendrore, strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës ose policinë e shtetit për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës, ndërsa çdo punonjës i institucioneve publike dhe private që për shkak të profesionit vihet në kontakt me një fëmijë të tillë dhe dyshon, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijës.
- Sipas ligjit 9669, çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t’u drejtohet me

¹⁴ Kartelë klinike individuale për viktimat që pranojnë dhunën/ abuzimin

¹⁵ Modeli i raportit përkatës mjekësor për viktimat e dhunës në familje hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë

¹⁶ http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Shendeti_Publik/pdf_moduli_dhunes.pdf

¹⁷ Neni 130/a

¹⁸ Pa dhënë ndonjë përkrahje se çfarë përbën lloj tjetër dhune

¹⁹ Neni 300, “Moskallëzimi i krimit”

²⁰ Neni 67 Detyrimi për raportim

anë të një kërkesë autoriteteve²¹ për të ndërmarrë masat e nevojshme.²²

- Dhuna në familje hyn në kategoritë e atyre rasteve që mjeku i familjes duhet t'i referojë e t'i rekomandojë.²³
- *Ligji për policinë e shtetit* në hyrje të tij përcakton²⁴ se policia identifikon, mbron dhe referon për asistencë, pranë autoriteteve përkatëse, viktimat e trafikimit, o persona viktimat te dhunës në familje, veçanërisht të miturit dhe gratë.

d) Abuzuesi i një fëmije është në pjesën më të madhe të rasteve një person i njohur për fëmijën si prindi, xhaxhai, daja, fqinj²⁵

Në këto raste fëmija apo të afërmit e tij/saj e kanë shumë të vështirë të flasin. Të afërmit mund të bëhen pengesë në dhënien e ndihmes së menjëhershme fëmijës dhe përpjekjet e profesionistit identifikues për ta shkëputur fëmijën nga ambjenti abuzues mund të krijojnë armiqësimin e tij/saj me fëmijën etj.

f) Edhe në vetë strukturën ndihmuese mund të ketë persona dhunues ose viktimat të dhunës në familje

Përpara se të ofrojë ndihmë tek viktimat e dhunës në familje, çdo organizatë apo institucion duhet të sigurohet që punonjësit e stafit jo vetëm nuk kanë qenë apo janë dhunues të çfarëdo forme, por edhe që i zgjidhin çështjet e dhunës në familje në përputhje me ligjin.

g) Një pjesë e mirë e viktimave do të drejtohen tek institucionet e shëndetit

Sipas OBSH-së, një pjesë e madhe e dhunës ndërpersonale nuk raportohet tek agjencitë e drejtësisë penale sepse individët kanë frikë nga stigma, nga hakmarrja e abuzuesve etj., megjithatë dhuna shkakton shpesh dëmtime fizike dhe një sërë problemesh psikologjike dhe sociale që i sjell viktimat në kontakt me shërbimet e shëndetit dhe me shërbime të tjera.²⁶

Të gjitha femrat mbi 14 vjeç dhe të gjithë fëmijët nën 14 vjeç duhet të depistohen për dhunë në familje²⁷ Punonjësit e shëndetit: të shërbimit të kujdesit parësor, të reparteve të urgjencës në poliklinika e spitale, në shërbimet e maternitetit dhe këshillimoret e gruas, në shërbimet e pediatriisë në spitale, poliklinika, këshillimore të fëmijës, dhe në shërbimet e shëndetit mendor duhet të bëjnë depistimin për abuzim si pjesë e vizitës së kontrollit rutinë në qendër, kur dyshohet, që në mënyrë të përgjithshme quhen depistim rutinë- kur aplikohet te çdo grua dhe selektiv kur paraqiten shenja të dhunës.²⁸

gj) Identifikimi kërkon njohuri mbi “ciklin” e dhunës

Qarku i dhunës është përsëritje e: incidentit abuziv, abuzuesit që mundohet të mbajë zap tendencën e dhunës dhe të abuzuarën që përpiqet të ruajë paqen deri sa të ndodhë një incident tjetër; abuzuesi kërkon falje thotë që s'do ta përsërisë ose ia hedh fajin viktimës që e “kërkoj” apo “e bën të madhe”, qetësia – të dyja palët ve-projnë sikur s'ka ndodhur asgjë, përpiqen ta injorojnë problemin.²⁹

h) Ka detyrim për raportimin e abuzimit të fëmijëve

Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në nenin 67 “detyrimi për raportim” kërkon çdo person fizik ose juridik që ka informacion, ose vetë fëmija, duhet të njoftojë për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës institucionet qendrore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës ose Policinë e Shtetit. Ligji kërkon gjithashtu që çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në

²¹ Stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit

²² Neni 9, Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

²³ Vendim i KM N.101, datë 4.2.2015” Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore , në kujdesin shënderësor parësor publik që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor

²⁴ Në Neni 17, pika 1/g ligji për policinë

²⁵ Variantet femërore të këtyre lidhjeve

²⁶ WHO, Reducing Violence through victim identification, care and support programs http://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/programmes.pdf

²⁷ <http://www.drshfier.gov.al/sites/default/files/depistimi.pdf>

²⁸ Shih udhërrëfyes për punonjësit e shëndetësisë , në http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Shendeti_Publik/pdf_moduli_dhunes.pdf

²⁹ <https://www.psychologytoday.com/blog/somatic-psychology/201105/domestic-violence-power-struggle-lasting-consequences>

kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.³⁰

i) Opinioni është pengesë për identifikim

Pengesat për identifikimin kanë të bëjnë jo vetëm me sjelljen dhe informacionin apo mungesën e informacionit që ka gruaja për ndihmën por edhe me opinionin e vetë punonjësve mbi efektet që do të sjellë identifikimi. Shpesh mendohet se identifikimi vetëm sa do ta përkeqësojë gjendjen e viktimës.

j) Dhuna me bazë gjinore merr forma të ndryshme gjatë ciklit të jetës

Sipas Bankës Botërore, dhuna me bazë gjinore merr forma të ndryshme gjatë ciklit të jetës. Para lindjes dhuna me bazë gjinore merr formën e abortit selektiv, rrahjes gjatë shtatzanisë, shtatëzanisë së padëshiruar. Gjatë peridhës së fëmijërisë së hershme merr formën e vrasjes së foshnjës femër, abuzimit fizik dhe emocional, aksesit të ndryshëm tek ushqimi dhe kujdesi mjekësor për foshnjat femra. Gjatë vajzërisë merr formën e martesës së hershme, prerjeve në organin gjenital, abuzim seksual prej pjestarëve të familjes dhe të huajve, akses i diferencuar tek ushqimi dhe kujdesi shëndetësor, prostitucion të fëmijëve. Gjatë adoleshencës merr formën e dhunës gjatë periudhës së ardhjes rrotull apo daljes së bashku, seksit të detyruar me pagesë, abuzim seksual në vendin e punës, përdhunim, prostitucion i detyruar, trafikim. Gjatë peridhës riprodhuese: abuzim i grave nga partnerët intimë, përdhunimi në martesë, abuzimet dhe vrasjet për pajë, abuzimit seksual në punë, përdhunimet, abuzimet e grave me paaftësi. Dhuna me bazë gjinore ndodh edhe ndaj grave në moshë ose vejushave.³¹

k) Shkaqet e dhunës janë të ndryshme

Sipas ofruesve të shërbimeve kontribuuese në këtë manual në shumë raste shkaqet e dhunës në familje janë të ardhurat e ulëta, mosmarrëvshjet në çift për shkak të migracionit/largimit për një jetë më të mirë, tradhëtia bashkëshortore.

3.2. 4 - Çfarë duhet të bëjmë për identifikimin e dhunës në familje

a) Të merremi me konceptin tonë për dhunën dhe të edukojmë rrjetet mbështetëse

Lidhur me dhunën në familje ka disa koncepte të gabuara të cilat pa i ditur mund t'i kemi edhe ne dhe personat që janë afër viktimave. Disa nga konceptet e gabuara për dhunën janë: Dhuna është e pazakontë/ jo e shpeshtë; Është e pamundur të duash dikë që të dhunon; Dhuna ndodh kur dikush del jashtë kontrolli; dhuna është gjithmonë fizike; në rastet e dhunës duhet marrë vendim që marrëdhënia të braktiset; Nuk ka arsye të mos thirrret policia; Të dyja palët kanë përgjegjësi për shkaktimin e dhunës; Gratë i abuzojnë burrat po aq sa burrat abuzojnë gratë; burrat nuk janë kurrë viktimë dhe gratë nuk janë kurrë abuzuese; Dhuna ndodh vetëm kur gratë janë të varfra të paarsimuar apo të varura; Droga dhe alkooli shkaktojnë dhunën; Njerëzit që dhunojnë partnerin intim janë të dhunshëm edhe në marrëdhënie të tjera; Një i afërm mik joprofesionist mund ta shpëtojë dikë nga dhuna në familje.³²

b) Të përcaktojmë zonat apo grupet “e nxehta” dhe të informojmë fuqimisht atje

Në bashki të ndryshme është aplikuar ndërhyrja e “skuadrave të terrenit” apo “skuadrave të lëvizshme” të cilat kanë vendosur vëmendjen e tyre në vende të ndryshme të qytetit ku hasen më shpesh fëmijë që lypin ose punojnë ose grupe popullate ku studimet dhe praktika tregojnë se ka më shumë prevalencë të shfrytëzimit të fëmijëve.³³

c) Të informojmë që një urdhër mbrojtjeje është një vendim civil, jo penal.

Shpesh viktimat e dhunës në familje hezitojnë të ndajnë informacion sepse kanë frikë se burri, partneri bashkëshorti do të shkojnë në burg. Viktimat duhet të informohen se dhunuesit mund të procedohen penalisht nëse viktimë ankohet.³⁴

³⁰ Kartelë klinike individuale për viktimat që pranojnë dhunën/ abuzimin

³¹ Modeli i raportit përkatës mjekësor për viktimat e dhunës në familje hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit

³² Disa prej koncepteve të gabuara trajtohen më poshtë, për më shumë shih në <http://www.cosmopolitan.com/politics/news/a31528/14-misconceptions-about-domestic-violence/>

³³ Për më shumë vizito: <http://femijet.gov.al/al/raporte-2>

³⁴ Shih më lart

ç) Të zbatohet detyrimet në lidhje me ndihmën për kërkesë padinë

Sipas një organizate ofruese të shërbimeve për viktimat është problem mospërbushja e detyrimit për të plotësuar kërkesë padinë.

“Asnjë agjensi përveç policisë nuk plotëson kërkesën për tu pajisur me UMM/UM, për një grua të dhunuar. Nuk ka asnjë denoncim për dhunën në familje. As mjeku, as mësuesi, as agjenci të tjera”

Kur keni dijeni mbi dhunën e shkaktuar, si përfaqësues të zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, mund të paraqesni një kërkesë padi për urdhër të menjëhershëm mbrojtje apo urdhër mbrojtje. Sidomos në rastet kur nuk ka organizata të licencuara ju mund të jeni e vetmja mundësi për viktimën e dhunës në familje për t’ju drejtuar gjykatës/për t’u identifikuar.

d) Të ndërmerim veprime në interesin më të lartë të fëmijës duke përfshirë kur është e nevojshme edhe ndarjen e fëmijës nga prindërit/familja

Punonjësit socialë duhet të kërkojnë bashkëpunimin e policisë për aplikimin e metodave që i parashikon ligji si p.sh ndarja fizike e abuzuesit nëpërmjet shoqërimit në polici të personit të dyshuar, shoqërimit të fëmijës si masë mbrojtëse,³⁵ marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes etj.³⁶

e) Të marrim masa për ruajtjen strikte të konfidencialitetit

Standartet për shërbimet rezidenciale për viktimat e dhunës në familje si dhe udhëzimet për to përmbajnë forma dhe deklarata të cilat mund të përdoren për të siguruar ruajtjen e konfidencialitetit. Standarte të reja janë në hartim e sipër lidhur me qendrat e emergjencave apo ndihmën në komunitet.³⁷

Çështjet e detyrimit për të mos mbajtur sekrete duhet të diskutohen me viktimën - atyre u duhet bërë e qartë se ndërsa mund të zgjedhin të mos raportojnë dhunën ndaj tyre ato dhe punonjësit janë të detyruara të raportojnë dhunën ndaj fëmijës.

f) Të kemi gati sistemin e ndihmës së përshtatshme - sidomos ku do ta akomodojmë viktimën, fëmijët

Në momentin kur viktimë ndihmohet që të bëjë kërkesë padinë për një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, punonjësi duhet ta ketë një vlerësim dhe sugjerim për gjykatën lidhur strehimin dhe sidomos llojin e strehimit që është në interesin më të lartë të fëmijës. Ligji për shërbimet shoqërore parashikon që brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi³⁸ të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.³⁹ Nga ana tjetër, duhet mbajtur parasysh se ligji e vendos afatin e strehimit në qendrat e përkujdesjes shoqërore të përkohshme deri në një vit.⁴⁰

g) Të shpërndajmë informacion për të kuptuar shenjat e dhunës, llojet e dhunës, linjat e ndihmës, këshillimit, si dhe mbi shërbimet që ofrohen për viktimat.

Në kontaktet me gratë dhe vajzat duhet informuar se mënyra për të kuptuar nëse je në një marrëdhënie abuzive është të vlerësosh:

- ndjenjat e tua- nëse ke frikë nga partneri pjesën më të madhe të kohës, mënjanon disa tema komunikimi nga frika se ai do të nevrkoset, ndjehesh se nuk bën dot gjë tamam sipas partnerit tënd, beson se meriton të trajtohesh keq e të lëndohesh, pyet veten nëse je ti ajo që je çmendur, ndjehesh e mpirë emocionalisht apo pa ndihmë
- sjelljen abuzive apo kërcënuese të partnerit tënd- nëse ka humor të keq ose të paparashikueshëm, të lëndon ose kërcënon se do të të lëndojë ose të të vrasë, kërcënon se do të ti marrë fëmijët ose ti lëndojë

³⁵ Ligji për policinë

³⁶ Ligji për fëmijët, neni 56

³⁷ Kërko për vendim të këshillit të ministrave në zbatim ligjit për shërbimet shoqërore : neni 15, pika 5- kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimit komunitar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose për standarte të reja në zbatim të ligjit për shërbimet shoqërore: neni 27 pika 3 Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, bëhet në përputhje me standartet e hartuara nga ministri përgjegjës për çështjet sociale

³⁸ Ligj ka hyrë në fuqi 15 ditë pas daljes në fletore zyrtare, në 22 dhjetor 2016

³⁹ Neni 52, Dispozita kalimtare dhe të fundit

⁴⁰ Shih ligjin, neni 18, “strehimi i perkohshem”

ata, kërcënon se do vrasë vetën nëse largohesh, të detyron të bësh seks, të shkatërron gjërat e tua.

- sjelljen kontrolluese të partnerit tënd- bëhet xheloz dhe posesiv, kontrollon ku shkon e çfarë bën, nuk të lejon të takosh miqtë dhe familjen, kufizon aksesin tënd tek paratë, telefoni, ose makina, të kontrollojnë vazhdimisht ku je.

gj) Të zbatohet standartet e etikës dhe të sigurisë në çdo hap të procesit

Parimet e rëndësishme në identifikimin dhe trajtimin e viktimave të dhunës në familje janë:

- *Parimi i respektit të Autonomisë*- kanë të drejtë të marrin vendime për të gjitha sferat e jetës
- *Parimi i mosdëmtimit*- as me veprime as me mosveprime
- *Parimi i vërtetësisë dhe i besnikërisë*- të treguarit të vërtetën pa premtime, të mbeturit besnik të thënieve
- *Parimi i drejtësisë*- të qenit i drejtë pa diskriminuar në bazë të racës, klasës, statusit martesor

3.2.5 - Si duhet ta dokumentojmë identifikimin e viktimave të dhunës

Dokumentimi i identifikimit përfshin dokumentimin e identifikimit të çdo rasti dhe dokumentimin e identifikimit në përgjithësi.

a) Dokumentimi nga institucionet e përkujdesjes shoqërore

Dokumentimi i identifikimit të çdo rasti nga punonjësit e bashkisë është pjesë e dosjes së çdo rasti dhe përbëhet nga :

- Kërkesë- padia/ Kërkesa për urdhër mbrojtje me përshkrimet e rrethanave⁴¹
- Urdhri i menjëhershëm të mbrojtjes
- Urdhri i mbrojtjes
- Kërkesa për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtje- nëse ka;

b) Dokumentimi i identifikimit në përgjithësi bëhet nga institucionet qendrore dhe vendore dhe përbëhet nga:

- databaza e menaxhimit të rasteve të dhunës në Bashki/Përgjegjësi e koordinatorit të dhunës
- të dhënat statistikore për nivelin e dhunës në familje në ministrinë përgjegjëse

c) Dokumentimi nga institucione të tjera

Policia është institucioni tjetër që bën dokumentimin e identifikimit . Llojet e dokumentimit që mban policia përfshijnë :

- Raport i ngjarjes⁴²
- Vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor
- Kërkesë- padia/ Kërkesa për urdhër mbrojtje
- Afishimi i numrave të telefonit të organizatave , qendrave shëndetësore sociale
- Referimi tek mbrojtja-aktet e dorëzimit

Gjykata ka formën e vetë të dokumentimit që përbëhet nga :

- Rregjistri i akt padive

⁴¹ Sipas ligji, nenit 14 “ Forma e kërkesë padisë” kërkesë padia duhet të përmbajë përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cënimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i/e padituri/a.

⁴² UNDP (2008) Dhuna në familje , përgjegjësistë që ka policia e shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj file:///C:/Users/user/AppData/Local/Microsoft/Windows/Temporary%20Internet%20Files/Content.IE5/HYU5OOVT/Albania_Manual%20for%20Policy%20Officers%20in%20Albania.pdf

4 VLERËSIMI multidisiplinar i nevojave dhe planifikimi i mbështetjes

4.1 - VLERËSIMI MULTIDISCIPLINAR PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

4.1.1 - Shembuj nga praktika e vlerësimit të nevojave

Jo shumë kohë më parë jemi thirrur nga Komiteti Rajonal Antitrafik. Në mbledhje u prezantua një rast trafikimi, një vajzë e moshës 15 vjeç, që largohej nga familja. Rasti ishte sjellë nga një NJMF-ja, ishte sjellë me shkrim por vetë NJMF-ja nuk erdhi. NJMF-ja e kishte konsideruar si fëmijë viktimë e mundshme e trafikimi. Kërkohej të flitej me drejtoreshën e arsimit për ta rregjistruar në shkollë. Në i kërkuam që të bëhej një intervistë nga persona ekspertë edhe për ta parë nëse ishte viktimë e mundshme e trafikimit edhe për të parë se cilat ishin nevojat, sepse s'ka mundësi që një viktimë e mundshme e trafikimit të ketë vetëm nevojë të rifutet në shkollë dhe

Ishin tre fëmijë që ne i kishim kategorizuar si viktimë të mundshme të trafikimit dhe po i asistonim. Kërkuam mbledhjen e grupit multidisiplinar të drejtuar nga NJMF-ja. Rasti sillet në grupet multidisiplinare mbasi i kanë intervistuar dhe i kanë kategorizuar, qoftë njësia për mbrojtjen e fëmijës, qoftë shërbimi social shtetëror. Ne i kishim kategorizuar si viktimë të mundshme të trafikimit: babai ishte dënuar për vjedhje me burg, nëna i kishte braktisur, fëmijët ishin vetëm, kishte shumë elementë

Rasti i tre fëmijëve në ... është një rast tipik i rëndësisë së monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm. Punonjësja e NJMF-së i njihte fëmijët përpara se të futej babai i tyre në burg, qysh në momentin që i braktisi nëna ata ishin sjellë në vëmendjen e punonjësës së NJMF-së

Figura më poshtë jep pak a shumë paradigmen e vlerësimit të përdorur në rastin e viktimave të dhunës dhe trafikimit të përshkruar kështu nga një prej shërbime ofruesve që kontribuoi në hartimin e manualit:

“Hapi i parë i vlerësimit është të vlerësojmë nëse kemi të bëjmë me një viktimë trafikimi apo dhunë, hap që e quajmë edhe identifikim. Ndërkohë që vlerësojmë këtë, vlerësojmë shkallën e emergjencës e në të njëjtën kohë vlerësojmë dëmtimet. Në të njëjtën kohë me dëmtimet vlerësojmë nevojat e personave të tjerë të rëndësishëm, dhe në të njëjtën kohë me këtë vlerësojmë pasojat afatgjata dhe të mesme tek të gjithë”



4.1.2 - Mjetet e vlerësimit

Mjetet e vlerësimit të situatës dhe nevojave të viktimës së trafikimit janë intervistat dhe informacionet e marra nga referuesit.

Sipas PSV-ve, procesi i vlerësimit fillon me identifikimin fillestar dhe thellohet me intervistën formale të

zhvilluar nga G/SPIF, ose me intervista të kryera nga punonjësit e ndihmës në strehëza. Identifikimi fillestar ka në përbërje të tij vlerësimin e rrezikut ndaj personit dhe ndaj stafit dhe kryhet zakonisht nga një punonjës. Intervista formale është një formë e vlerësimit multidisiplinar. Përveç seksioneve të dedikuara përvcaktimit nëse personi është viktimë trafikimi ose jo, ajo përmban seksione për mbledhjen e informacionit dhe mbi rreziqet që i kanosen personit nga trafikanti, nga bashkëpunimi me organet zbatimit të ligjit¹ nevojat që ai/ajo ka para kthimit në vendin e origjinës, për pritjen në kthim, për rehabilitim dhe riintegrim afatgjatë. Vlerësimi për të rriturit përmban pyetje të vecanta lidhur me nevojat për strehim të përkohshëm të sigurt, dokumente të udhëtimit, lejet e qëndrimit, kurse profesionale apo shkollim, këshillim ligjor, punësim etj.

Në rastin e fëmijës viktimë e mundshme e trafikimit, përdoret forma e vlerësimit që gjendet në Protokollin e Mbrojtjes së fëmijëve/ Udhëzimi Nr. 10.²

Ligji i ri për shërbimet shoqërore parashikon ngritjen e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit në strukturën e posaçme për shërbimet shoqërore të njësisë së qeverisjes vendore.

Forma e vlerësimit dhe përmbajtja e tij kur kryhet nga qendrat rezidenciale për viktimat e trafikimit përcaktohet nga standartet për qendrat rezidenciale .

4.1.3 - Çfarë duhet të dimë/si duhet të përgatitemi për vlerësimin

a) Siguria e jetës dhe shëndetit është elementi i parë bazë i vlerësimit

Vlerësimi i sigurisë duhet të bëhet menjëherë sapo identifikohet rasti, por gjithashtu duhet të bëhet në mënyrë sistematike gjatë procesit të ndihmës. Situata mund të ndryshojë shpejt dhe në mënyrë rrënjësore dhe ndryshimi kërkon rivlerësim dhe vlerësim të vazhduar.

b) Personi viktimë ose bashkëpunëtorët e vlerësimit mund të mos ndajnë të njëjtin mendim me ju lidhur me rrezikun që i kanoset viktimës dhe burimin e rrezikut.

Në disa raste, personi që e ka rekrutuar një vajzë duke e larguar nga familja e dhunshme vazhdon ta kontrollojë atë emocionalisht- ajo vazhdon të besojë se e keqja ose rreziku nuk vjen prej tij.

c) Mund të mos kemi të njëjtën të kuptuar me bashkëpunëtorët e vlerësimit lidhur me çfarë është një situatë emergjente dhe si zgjidhet ajo

Sipas ligjit për shërbimet shoqërore, “Situatë emergjente” është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese. Ligji për policinë nuk ka ndonjë përkrahje se çfarë është rreziku, por përcakton se “Reagimi i menjëhershëm” është një veprim i ligjshëm i ndërmarrë me iniciativë nga punonjësi/ja i/e policisë sapo kupton rrezikun.”³

d) Nevojat komplekse të viktimës kërkojnë një vlerësim shumë dimensional dhe të specializuar që mund të mos e kemi

4.1.4 - Si duhet ta bëjmë vlerësimin

a) Të sigurojmë që të jetë me pjesëmarrje, të përfshijmë viktimën dhe sa herë që është e mundur edhe familjarët apo persona mbështetës në vlerësim

b) Të marrim aq informacion sa është e nevojshme

c) Të sigurojmë pjesëmarrjen e specialistëve nëse është e nevojshme

ç) Të vlerësohen të gjitha aspektet e sigurisë dhe shëndetit

d) Të marrim parasysh/llogarisim mundësinë e dëmtimit. Punonjësit/profesionistët duhet të mos ndërmarrin veprime të cilat do ta përkeqësojnë situatën e viktimës. Në praktikë kjo lidhet me mosfillimin e intervistave ose ndërprerjen e tyre në rast se personi nuk ndjehet mirë, marrjen e masave që të ketë specialist të shën-

¹ Shih më poshtë përmbajtjen tek formatet

² Udhëzimi i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme nr. 10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”, Fletore Zyrtare Nr. 33 , datë 10 Mars 2015. Në Udhëzim, fëmijët viktimë të mundshme të trafikimit konsiderohen si raste emergjente. Akte nënligjore në zbatim të ligjit për kujdesin shoqëror dhe mbrojtjen e fëmijëve do të nxirren që do të trajtojnë vlerësimin.

³ Ligj Nr. 108/2014 Për policinë e shtetit , neni 6 “ Përkufizime

detit gjatë intervistimit (psikolog, mjek), marrjen e masave të mos ekspozimit të kontaktit me viktimën dhe profesionistit tek personat e dyshuar si trafikantë.

e) Të komunikojmë në mënyrë etike dhe profesionale: Gjatë intervistimit të bëhen pyetje në mënyrë të ndjeshme, të mos nxitohet në arritjen e përfundimeve, të mos drejtohen të intervistuarit në përgjigje që do intervistuesi, të dëgjohet në mënyrë aktive.

f) Të përshtasim komunikimin sipas moshës, kapacitetit dhe gjendjes së fëmijës: Në komunikimin me një të mitur, intervistuesit duhet të fillojnë bisedën me pyetje të thjeshta për të thyer akullin dhe për të fituar besimin e fëmijës, të sillen butë dhe qetë por të evitojnë prekjet, të pyesin të miturin/të miturën nëse e kupton përse po kryhet intervista, të pyesin të miturin/të miturën nëse ndihet rehat të flasë për gjëra delikate në prani të të tjerëve, të mos i premtojnë diçka të miturit/të miturës në këmbim apo në fund të intervistës, të mos e ndërpresin të miturin/të miturën kur flet vetëm në raste kur nuk është e qartë çfarë po thotë ai/ajo.

g) Të shqyrtojmë të gjitha aspektet e jetës, mbijetesës, zhvillimit dhe ri/integritit të viktimës.

Aspekte të vlerësimit të situatës së një viktime trafikimi

Siguria

Aspekte të rëndësishme për vlerësimin e sigurisë në rastet e viktimave të trafikimit janë: a) rreziqet e lidhura me familjen e rasti, b) lidhur me trafikantin, c) lidhur me kontaktin me autoritetet e zbatimit të ligjit. Për vlerësimin e rrezikut lidhur me familjen u duhet dhënë përgjigje pyetjeve: A ka të dhëna të përfshirjes së familjes? A është në dijeni familja për rrethanat në të cilat ndodhet viktimja? A ka histori dhune në familje? A ka të ngjarë që familja të reagojë në mënyrë agresive ndaj viktimës? A ka faktorë të tjerë që mund të prekin mundësinë e riintegritit në familje? Për të vlerësuar rreziqet lidhur me trafikantin u duhet dhënë përgjigje pyetjeve: A është trafikuar viktimja nga një grup i krimit të organizuar? Nëse po, anëtarët e grupit kanë bazën në vendin e nisjes apo pritjes apo në të dyja? A e njohin trafikuesit vendndodhjen e tanishme të viktimës? A ka të dhëna që trafikuesit janë në dijeni që viktimja po ndihmohet dhe nga dikush? A ka patur ndonjë formë kontakti ndërmjet viktimës dhe trafikuesit që nga koha e ikjes së tij/saj? A e dinë trafikuesit vendndodhjen e familjes apo personave të dashur të viktimës? A ka ndonjë anëtar të familjes, fqinj apo të njohur të tjerë të saj/tij të përfshirë në procesin e trafikimit? Për të vlerësuar rreziqet lidhur me kontaktin me agjencitë e zbatimit të ligjit u duhet dhënë përgjigje pyetjeve: Deri në çfarë shkalle ka bashkëpunuar viktimja me forcat e ligjit? A ka dhënë informacione apo fakte? Nëse po, a janë në dijeni trafikuesit për këtë fakt? A ka marrë apo planifikon të marrë policia ndonjë veprim ndaj trafikuesve në vendin e nisjes apo në atë të pritjes? A janë marrë këto veprime në bazë të informacionit apo fakteve të dhëna nga viktimja? A është nisur çështje penale apo i është dhënë informacion ndonjë të dyshuari mbi ekzistencën e denoncimit dhe hetimit? A është arrestuar ndonjë i dyshuar deri më sot? Nëse po, a janë ndaluar ata? Nëse jo, a njihet vendndodhja e tyre? A është ndonjë nga të dyshuarit akoma i lirë dhe vendndodhja e tyre nuk njihet? A është ndonjëri nga të dyshuarit pjesë e një grupi të krimit të organizuar? Cili është mendimi i agjencive të zbatimit të ligjit rreth kërcënimit që trafikuesit mund të përbëjnë për viktimën? Në çfarë mënyrash është e gatshme policia të ndihmojë në sigurinë për personin e trafikuar? Nëse personi planifikon të bashkëpunojë me forcat e ligjit, a i plotëson ai/ajo kushtet për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve? Nëse problemet e sigurisë janë të mëdha në Shqipëri (ose në vendin e origjinës nëse përfituesi nuk është nga Shqipëria) çfarë hapash mund të merren për të përmirësuar sigurinë e personit? A mund të lehtësohet transferimi në një vend të tretë?

Strehimi

Për të vlerësuar situatën e strehimit duhen bërë pyetje dhe duhen marrë përgjigje mbi: 1. Ku dëshiron të jetojë personi/rasti? A ka familje apo të afërm me të cilët mund të jetojë? Nëse po, a ka patur ndonjë kontakt me ta kohët e fundit? A ka histori dhune apo abuzimi? A ka fakte që personat me të cilët do të jetojë janë përfshirë në trafikimin, dhunë, shfrytëzimin e personit? A ka pengesa të tjera për jetesën atje?

Shëndeti fizik

Për të vlerësuar shëndetin fizik, duhen bërë pyetje specifike që kanë të bëjnë me pasojat e lidhura me një lloj shfrytëzimi: A mund të jetë shtatzënë rasti? A ka dëmtime fizike, shenja dhune, fraktura, nëse është vaksinuar?

Aspekte të vlerësimit të situatës së një viktime trafikimi - *vazhdim*

Shëndeti mendor dhe emocional

Vlerësimi i shëndetit mendor është mirë të kryhet nga një psikolog ose një mjek psikiatër. Nga përvoja me rastet e trafikuar disa aspekte të rëndësishme që duhet të vlerësohen janë: shqetësime të gjumit, vështirësi emocionale, probleme konjitive, vështirësi motivimi, shqetësime të sjelljes, performancës dhe funksionimit, marrëdhëniet sociale, koncepti për veten. A shfaq rasti ndonjë shenjë vetë-gjymtimi ose vetë-dëmtimi? A shfaq rasti ndonjë shenjë depresioni apo vetëvrasjeje? A shfaq shenja të sëmundjeve mendore? Si është me ushqyerjen? A ka sëmundje seksualisht të transmetueshme?

Shëndeti riprodhues

A kryer abort/e të padëshiruar, shenja të infeksioneve, dhimbje etj...

Nevojat ligjore

Vlerësimi i nevojave ligjore në rastin e viktimave të trafikimit përfshin përgjigjen e këtyre pyetjeve: A ka rasti të drejtë ligjore të qëndrojë në Shqipëri? Nëse po, çfarë lloj vize/të drejta qëndrimi ka? A është akoma e vlefshme? Nëse rasti nuk ka të drejtë të qëndrojë, çfarë hapash mund të merren për ta marrë këtë të drejtë? A ka probleme të kujdestarisë? A ka problem të regjistrimit në gjendjen civile? Nëse ka fëmijë, a ka probleme kujdestarie që përfshijnë fëmijët? A ka nisur ndonjë hetim apo është ngritur ndonjë akuzë për vepër penale? A dëshiron personi të ndërmarrë veprime ligjore kundër trafikuesit? A ka ndonjë mundësi të kërkojë dëmshpërblim? Sa mund të zgjasë një hetim apo procesi gjyqësor?

Nevojat për formim profesional dhe punësim

Këto nevoja mund të vlerësohen duke u dhënë përgjigje pyetjeve si: Cfarë do të donte të bënte personi në të ardhmen? Cilat janë hapat që duhen ndërmarrë për këtë qëllim, çfarë arsimit duhet për profesionin që ka dëshirë, a ka probleme që mund të kenë ndikim mbi llojin e punësimit?⁴

Situata familjare para ndarjes/largimit

Situata familjare në rastet e trafikimit mund të vlerësohet duke i dhënë përgjigje pyetjeve që kanë të bëjnë me jetën familjare para ndarjes/largimit: Çfarë bënte personi përpara se të largohej? A kishte ai/ajo ndonjë rol të veçantë në familje? A ishte larguar jashtë shteti më parë? Për çfarë arsye ka udhëtuar më parë? A kishte probleme familja me të dhe çfarë lloj problemesh? Cfarë ka bërë familja për të zgjidhur këto probleme? Situata familjare vlerësohet nëpërmjet pyetjeve lidhur me ndarjen si: Përse ishte ndarë fëmija nga familja? A ishte kjo ndarje e detyruar nga të jashtëm apo vullnetare? Me kë ka udhëtuar fëmija? A ka patur persona të tjerë jashtë shtetit? Cila ka qenë marrëdhënia mes familjes dhe atij/asaj që ka ndihmuar largimin?

Situata familjare aktuale: vlerësohet nëpërmjet pyetjeve

A ka familja ushqim të mjaftueshëm? Cila është gjendja e strehimit e familjes? Cilat janë burimet e të ardhurave për familjen? A sjellin këto aktivitete të ardhura të mjaftueshme? A ka familja borxhe? A është familja më e varfër krahasuar me të tjerët që jetojnë në të njëjtën zonë? A është familja e kënaqur me kushtet e tyre të jetesës? A ka ofruar shërbimesh shëndetësore pranë? A ka mundësi arsimimi për fëmijën? A ka mundësi punësimi? A ka një organizatë që zbaton projekte në zonë? A dëshiron familja kthimin e personit për të jetuar me familjen? A mendon familja që mund t'i ofrojë mjaftueshëm fëmijës?

Shkollimi

Vlerësimi i nevojave për arsimim përfshin vlerësimin e dëshirës për të vazhduar shkollën nëse e ka ndërprerë, numrin e viteve të humbura dhe programet në dispozicion për zëvendësimin e viteve të humbura, problemet e sigurisë që mund të ndikojnë në ndjekjen e shkollës, performanca në shkollë dhe vështirësitë/pengesat për të mësuar/për performancë të mirë.

⁴ Për më shumë shih Standartet e Përkujdesit për personat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi

4.1.5 - Si duhet ta dokumentojmë vlerësimin

Kryerja e vlerësimit nga G/SPIF dokumentohet nga përdorimi i formateve të intervistës formale dhe formate të tjera të lidhura me të siç janë:

- a) Leja për intervistë formale
- b) Format i konkludimit të intervistës (Në formatet poshtë)

4.2 - VLERËSIMI MULTIDISCIPLINAR I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI I NDIHMËS PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

4.2.1 - Shembuj të vlerësimit

“Tani gjërat kanë ndryshuar, ne kemi patur edhe raste që e ka parë policia, e ka konsideruar viktimë të dhunës, e ka sjellë tek ne dhe ka ardhur të nesërmen e ka marrë. Nuk ka shkuar askush në polici ta vlerësojë rastin. Ne detyrohemi të vemë një punonjës aty me të, të bëjmë një intervistë të shkurtër në mënyrë që të dimë çfarë kemi futur brenda, se kemi frikë mos na dëmton rastet e tjera që kemi brenda”

4.2.2 - Qëllimet e Vlerësimit dhe Mjetet e vlerësimit

Ka disa momente të vlerësimit të situatës dhe nevojave të viktimave të dhunës në familje për të cilat përdoren mjete të ndryshme.

Momenti i parë është **analiza paraprake** që duhet të bëjë koordinatori vendor me punonjës të policisë. Analiza bëhet nëpërmjet një interviste të viktimës, të abuzuesit, anëtarëve të tjerë të familjes, vlerësim të fakteve. Vlerësimi në këtë moment përfshin edhe vlerësimin se cilët nga përfaqësuesit e grupit ndërinstitucional dhe cilat burime do të përdoren për ndërhyrjen e parë të menjëhershme dhe ku do të vendoset viktimat.

Takimi i ekipit teknik ndërdisiplinor pas ndërhyrjes emergjente është një moment tjetër vlerësimi.

Kërkesë padia është edhe ky një mjet kryesor i vlerësimit i përdorur nga koordinatoret vendorë të dhunës në familje për të rriturit. Ajo përmban kërkesa për të eksploruar mbi incidentet e dhunës, dëmtimet e shkaktuara sigurisë, shëndetit ose mirëqenies si pasojë e dhunës. Kërkesat specifike për masat që duhet të vendosë gjykata kërkojnë detaje/vlerësim për personat e prekur, situatën e banimit, marrëdhëniet e abuzuesit me fëmijët, rrezikun për dëmtime nga armët etj.⁵

VKM Nr. 505 datë 13.07.2011 *“Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje në qendrat rezidenciale publike e jopublike”* dhe **Udhëzim Nr. 13**, datë 17.12.2012 *“Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”* përmbajnë instrumenta të vlerësimit të nevojave të vecanta: vlerësimin e nevojave psikosociale, të nevojave ligjore, të nevojave për arsim, të nevojave për formim profesional dhe punësim, të sigurisë, të akomodimit afatgjatë, të gjendjes familjare.

Standartet përmbajnë **formate të veçanta** të vlerësimit si anekse të tyre, përkatësisht:

- aneks 4 shëndeti
- aneks 5 nevojat psikosociale
- aneks 6 nevojat ligjore
- aneks 7 arsimit (16+)
- aneks 8, profesional/punësimi
- aneks 9 siguria
- aneks 10 akomodimi afatgjatë
- aneks 11- familja.

⁵ Shih në anekse formatin e kërkesë padisë

4.2.3 - Çfarë duhet të dimë/si duhet të përgatitemi për vlerësimin

- Viktima mund ta quajë veten fajtoare
- Viktimat në gjendje shoku mund të mos jenë në gjendje të japin përgjigje lidhur me dëmtimet që kanë
- Lloji i pyetjeve që bëhen përcakton nivelin e besimit që do të krijohet
- Për të qetësuar situatën, toni i zërit që përdorni është më i rëndësishëm se ajo që thoni

4.2.4 - Si duhet ta bëjmë vlerësimin

- Duke u sjellë me seriozitetin që meriton një çështje krimi
 - Duke vlerësuar nevojën e çdo personi, dhe sidomos fëmijëve që kanë dëshmuar dhunën
 - Duke e intervistuar viktimën “larg veshëve dhe syrit” të personit të dyshuar si dhunues”
 - Duke mos e fajësuar viktimën/duke mos bërë pyetje të tipit “Çfarë bëre përpara se të godiste?”
 - Duke mos bërë pyetje retorike të cilat marrin përgjigje automatike të tipit: “A je mirë?”
 - Duke vlerësuar të gjitha opsionet që jep ligji (Nr. 9669) për urdhrat e mbrojtjes
- Gjykata nuk do të përfshijë në vendim një masë e cila nuk është kërkuar në referencë të nenit 10, “*Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje*”. Për këtë arsye, kur hartojnë kërkesë padinë, punonjësit duhet të vlerësojnë situatën nën dritën e masave të mbrojtjes që mund të merren.
- Të informojmë viktimën për të gjitha të drejtat që ka për ti dhënë mundësi të marrë pjesë aktive në vlerësim
 - Të mbledhim aq informacion sa është e nevojshme për ndihmën që do të japim

5 PLANIFIKIMI dhe DHËNIA e NDIHMËS për gratë viktime të dhunës dhe trafikimit

5.1 - NDIHMA PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

5.1.1 - Shembuj

Fëmija ... jetim, u identifikua si viktimë e abuzimit seksual dhe viktimë e mundshme e trafikimit. Për shkak se kishte mbushur moshën e qëndrimit në institucion, ai u vendos në konviktin e një shkolle të mesme. Në të njëjtin konvikt jetonte edhe personi që dyshohej se kishte abuzuar me të. Fëmija informonte se x. abuzuesi i dyshuar ishte i vetmi person që e ndihmonte në konvikt. Në mungesë të ngrohjes në dhomën e tij, fëmija shkonte shpesh në dhomën e abuzuesit e cila kishte mbulesa, kalorifer etj.

E. ishte këshilltar i punësimit në organizatën... Ai punonte me të rinj Rom të fshatit .. . Një ditë ai kërkoi fonde që një nga të rinjtë të mësonte të punonte në larjen e kufomave. Për të gjithë që e dëgjuan, kjo ishte një ide e çmendur, megjithatë kursi u financua dhe i riu filloi punë. Aktualisht ai punon në një shërbim funeral në qytet.

5.1.2 - Cfarë duhet të dimë/si duhet të përgatitemi për ndihmën

a) Të dimë çfarë duhet të përfshijë minimalisht ndihma

Sipas Konventës së Këshillit të Evropës për masa kundër trafikimit⁶ asistencë minimale për rikuperimin fizik, psikologjik dhe shoqëror të viktimave përfshin: a) standardet për të siguruar jetesën - akomodimi i përshtatshëm dhe i sigurtë, ndihmë psikologjike dhe materiale; b) akses në trajtimin e emergjencës mjekësore; c) shërbime përkthimi dhe interpretimi sipas nevojës; d) konsulencë dhe informacion, veçanërisht për sa u përket të drejtave të tyre të ligjshme dhe shërbimeve në dispozicion të tyre, në një gjuhë që ata mund ta kuptojnë; e) asistencë për të mundësuar paraqitjen e të drejtave dhe interesave të tyre, si dhe shqyrtimin e tyre në fazat e përshtatshme të procedimit penal kundër shkelësve; f) akses në arsimin e fëmijëve.

b) Të njohim të drejtat për ndihmë dhe ndihmën që iu njej ligji viktimave të trafikimit

Lista më poshtë jep në mënyrë të përmblodhur aktet ligjore dhe nënligjore që parashikojnë ndihmën për viktimat e trafikimit.

SHERBIM	AKT LIGJORE
Shërbime shoqërore	Ligji nr. 9642 , datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore". Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë, neni 6. Ligji Nr.18/2017 , datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", neni 3, 23 dhe 26.
Strehim në qendra të mbrojtura	Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë: neni 17- Strehëzat Standartet për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në qendrat rezidenciale, VKM nr. 195 , datë 11.04.2007 Ligji Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", neni 123
Ndihmë psikologjike në qendër rezidenciale	Standartet për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në qendrat rezidenciale, VKM nr. 195 , datë 11.04.2007

⁶ Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore" Neni 12/1/2.

SHERBIM	AKT LIGJORE
Strehim social	Projektligji për strehimin social. Kreu X trajton për herë të parë programin e banesave të specializuara, të cilat janë ato banesa që adresojnë një nevojë specifike strehimi, ku përfshihen banesat për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuar, për viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje, fëmijët, të cilët janë pa kujdes prindëror ose janë marrë në mbrojtje nga shteti dhe që përgatiten për të kaluar në jetën e pavarur, të miturit nga 14-18 ose të rinjtë 18-21 vjeç pas lirimit ose kryerjes së programeve, që lidhen me drejtësinë penale dhe vajzat nëna. Ky program është një risi tjetër e projektligjit. Këto lloj banesash duhet të pajisen apo dhe shoqërohen me infrastrukturën e nevojshme të përshtatur dhe të aksesueshme, për lehtësimin dhe sigurimin e marrjes së ndihmës së shpejtë mjekësore si dhe të njoftimit në raste emergjencash ose me shërbimin e punonjësve të specializuar socialë dhe të policisë, për të siguruar mbrojtjen e integritetit fizik, për të parandaluar rrezikimin e jetës dhe shëndetit të tyre.
Ndihmë materiale, financiare në qendër rezidenciale	Ligj Nr.10399 , datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr, 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore të ndryshuar” Vendim i Këshillit të Ministrave “Për disa Ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 114, datë 31.01.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, 12.2014
Kujdes Shëndetësor	Ligji nr. 10383 , datë 24.02.2001 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ndihmë ligjore për proceset civile	Ligji Nr. 10039 , datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar Udhëzim i përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 5668 , datë 20.11.2013
Arsim	Ligj 69/2012 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”
Ndihmë për kthim në vendin e origjinës	VKM Nr.582 , datë 27.7.2011 “Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”
Përkthim	Ligji nr. 10383 , datë 24.02.2001 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Leja e qëndrimit për viktimat e huaja	Ligj Nr. 108/2013 Për të huajt , neni 54
Mosdëbim/ekzekutim vullnetar i urdhrin te	Ligj Nr. 108/2013 Për të huajt , neni 108
Punësim	Ligj Nr. 7995 , date 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” VKM Nr. 27 , datë 11.1.2012 “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta” Ligj nr. 108/2013 , datë 28.3.2013 “Për të huajt” ⁷

c) Të njohim burimet e shërbimeve për viktimat e trafikimit

Sipas ligjit të ri për shërbimet e kujdesit shoqëror shërbimet mund të jenë shërbime parashoqërore, (informimi dhe këshillimi, shërbimi në familje, mbështetje psiko-sociale, ndërhyrja e hershme), shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit(qëndrim i plotë ditë ose gjysmëditë, terapi të ndryshme), shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat(shërbim i specializuar, strehim, siguri fizike, ushqim, kujdes shëndetësor, rehabilitim psiko-social, terapi fizike, aktivitete profesionale, kalimi i kohës në komunitet, edukim), shërbimet shoqërore në situatë emergjence, shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbimet e specializuara, shërbime të këshillimit me telefon ose on-line.

Strehëzat që ofrojnë strehim dhe shërbime të dedikuara për viktimat e trafikimit dhe dhunës, përfshirë edhe

⁷ Fletore Zyrtare nr.48, datë 5 prill 2013, Neni 101 “ Leje pune për raste të vecanta të tipit “C”

fëmijët pavarësisht nga vendbanimi i tyre janë: Qendra Kombëtare Pritëse për viktimat e trafikimit në Tiranë, Qendra Psikosociale Vatra në Vlorë, Organizata Të Ndryshëm & Të Barabartë Tiranë, Shoqata Tjetër Vizion Elbasan, Organizata ARSIS/Qendra e Emergjencës Tiranë, Qendra Kombëtare Pritëse për viktimat e dhunës në familje, Strehëza për gratë dhe vajzat e dhunuara.

Pavarësisht vendodhjes së tyre këto qendra mbulojnë nevojat për akomodim të viktimave të trafikimit dhe dhunës nga zona të ndryshme të Shqipërisë sipas nevojës së tyre. Qendrat rezidenciale ofrojnë minimalisht këto shërbime: akomodim, strehim, veshmbathje, ushqim, asistencë mjekësore, shërbime psikologjike, asistencë ligjore, aktivitete profesionale, trajnime profesionale, referime në shërbime të tjera, ruajtje ose siguri fizike 24 orë, ndërmjetësim me familjen, komunikim periodik telefonik, takime me familjen, përkthim për përfitueset/sit e huaj, transport për shërbimet e tjera.

d) Të njohim rrezikun e diskriminimit mbi baza të bashkëpunimit⁸

Edhe pse nuk duhet të ndodhë, nuk janë të pakta rastet kur referohen për ndihmë vetëm viktimat të cilat kanë bashkëpunuar me autoritetet e zbatimit të ligjit

5.1.3 - Si duhet ta japim ndihmën

a) Të sigurojmë barazi dhe mosdiskriminim në trajtim.

Modiskriminimi në rastin e viktimave të trafikimit ka të bëjë edhe me minimizimin e dallimeve mes viktimave të trafikimit që kanë bashkëpunuar me autoritetet e zbatimit të ligjit për hetimin dhe kapjen e trafikantëve dhe atyre që nuk kanë bashkëpunuar. Sipas nenit 18, pikës 4 të Konventës së Stambollit sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza, ose për të dëshmuar kundër një autori veprë penale.

b) Të sigurojmë rritje të vetëbesimit kontrollit, vetëvendosjes, fuqizimit- eleminimit të varësisë

Viktimat e trafikimit në pjesën më të madhe nuk kanë patur kontroll mbi jetën, të ardhurat, familjet e tyre etj. Për të arritur këtë është e nevojshme ndër të tjera që: marrdhëniet mes viktimës dhe profesionistit të jenë në formën e një arrëveshjeje me detyra të ndara për secilin dhe me përgjegjësi në rritje për viktimën që po ndihmohet; objektivat të jenë të qarta dhe realiste; të sigurohet që viktimat marrin përgëzime për progresin e bërë sado i vogël të jetë ky; të përdoret gjuhë e përshtatshme, përfshirë edhe eleminimin e fjalës viktimë nëse ka konotacione negative për personin.

c) Të shmangim ndarjen e fëmijës nga familja

Ndarja e fëmijës nga familja duhet të jetë zgjidhja e fundit. Në të gjitha ato raste kur duket se ndarja është në interesin më të lartë të fëmijës duhen filluar njëkohësisht veprimet për të siguruar kontaktin e shëndetshëm dhe të sigurt me familjen dhe bashkimin sa më të shpejtë me familjen.

Për referimin tek shërbimet apo ofrimin e komponentëve të ndryshëm të ndihmës duhet patur parasysh dhe të vepohet si më poshtë

Për strehimin e sigurt në strehëza

Për strehimin në qendrat e mbyllura duhet patur parasysh që mbyllja jo vetëm shkel të drejtat e viktimave por ka rrezikun e ngjashmërisë me ambientin e shfrytëzimit dhe si pasojë mund të shërbejë si stimul për stres dhe trauma. Për këtë arsye qëndrimi duhet të zgjasë në kohën më të shkurtër të mundshme.

Në të gjitha rastet është bërë kujdes që viktimat qëndrojnë në streheza me vullnetin e tyre të lirë, lejen e kujdestarit ligjor apo të shërbimit social shtetëror. Pavarësisht se nga ana e ofruesve të shërbimeve synohet të limitohet qëndrimi për një kohë të gjatë në strehëz, në disa raste kur vlerësohet (në bashkëpunim me viktimën dhe institucione të tjera ofruese shërbimi) se viktimat për arsye sigurie⁹, mungese alternativash të strehimit¹⁰ mund të tejkalohet periudha afatshkurtër e synuar. Gjithësesi, gjatë qëndrimit në strehëza viktimat kanë akses në edukim arsimor, profesional, shërbim mjekësor, përfshirje në aktivitete sociale e kulturore jashtë strehëzës etj. Gjatë qëndrimit në strehëza ato përshihen të menaxhojnë aktivitetet ditore, (kuzhinë, mirëmbajtje e ambjentëve të përbashkëta dhe personale etj), kujdesi për fëmijët etj.

Citim i njëjës nga strehëzat e organizatave pjesëmarrëse në projekt

⁸ Sipas standarteve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, por edhe standartet e përkujdesit për personat e trafikuar

⁹ Rastet e viktimave të cilat kanë rrezik për jetën pasi kanë bashkëpunuar me organet e drejtësisë, proceset penale ndaj trafikantëve zgjasin deri dhe në vite.

¹⁰ Raste të viktimave minorene, si rezultat i mungesës së shërbimeve foster care në Shqipëri

Për strehimin në apartamente, jetën gjysmë të pavarur

Për strehimin në apartamente, jetën gjysmë të pavarur, duhet pasur parasysh që viktima të ketë akses tek punonjësi që e monitoron, dhe të dijë ku të drejtohet në rast rreziku, të ketë një monitorim të planifikuar sipas nevojës së saj për tu orientuar.

Gjatë qëndrimit në apartamente gjysmë të pavarura viktimat por dhe fëmijët e tyre vijnë të marrin shërbime sipas nevojave të tyre: psikologjike, mjeksore, ligjore, financiare, mbështetje për pagesë të kopshtit/cerdhes së fëmijës/ve, paketa ushqimore etj. Qëndrimi në apartamentet gjysmë të pavarura ka sfidat e veta në mënyrë të veçantë kur viktimat janë me fëmijë. Mungesa e vendeve të qëndrueshme të punës, pagesat e ulta në vendet e punës, mungesa e vëmendjes nga pushteti vendor për t'u siguruar strehim social bën që shpesh viktimat të ballafaqohen me vështirësi financiare. Për këtë lind e nevojshme vijueshmëria e mbështetjes në apartamente edhe përtej periudhës 6-mujore në disa raste, të paguara këto nga programet e qendrave jo - publike.

Citim i njërit nga strehëzat e organizatave pjesëmarrëse në projekt

Ndihmë psikologjike në qendër rezidenciale

Asistenca për viktimat e trafikimit duhet të fokusohet në rikuperimin pas ngjarjeve traumatike, në arritjen e rehabilitimit dhe ristabilizimit të jetës së personit. Viktimave të trafikimit duhet t'u ofrohen këshillime psikologjike individuale dhe në grup. Këshillimi duhet të ofrohet vetëm nga staf i trajnuar dhe sipas një plani të detajuar dhe të koordinuar me shërbimet e tjera.

Kujdes Shëndetësor

Sipas ligjit, sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, viktimat e trafikimit në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të cilëve financohet nga Buxheti i Shteti. Në cdo strehës ka një mjek sipas standarteve rezidenciale i cili bën vlerësimin e nevojave shëndetësore si dhe ndihmon në adresimin e këtyre nevojave. Përfituesit në strehëza ndihmohen të kryejnë analiza të përgjithshme, si ekzaminime mjekësore dhe gjinekologjike, duke përfshirë testin e SST-ve dhe HIV/AIDS (në mënyrë vullnetare), ekzaminime dentare dhe mjekime, etj. Gjithashtu ndihmohen raste gjatë periudhës së shtatzanisë, lindjes dhe pas saj duke ofruar kujdes mjekësor të veçantë për bebet. Një kujdes i veçantë mbi çështje të shëndetit i jepet fëmijëve të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje. Për përfituesit zhvillohen gjithashtu aktivitete edukuese për shëndetin, sëmundjet, shkaqet dhe kurat e mundshme.

Përkthim

PSV-të kërkojnë që gjatë intervistimit të viktimave të trafikimit të ketë përkthyes të licensuar të cilët do të duhet të deklarojnë ruajtjen e konfidencialitetit. Numri i vogël i viktimave të trafikimit të huaja në strehëza apo në ndihmë nuk përbën justifikim për mosparashikimin e zërit përkthim në shpenzimet e ndihmës.

Leja e qëndrimit për viktimat e huaja

Sipas ligjit për të huajt, viktimat e mundshme të trafikimit ose viktimat e trafikimit të huaja, pra edhe ato që e kanë bërë intervistën formale edhe ato që nuk e kanë bërë një intervistë formale pajisen me leje të përkohshme qëndrimi të tipit "A", për një afat 3-mujor, pavarësisht nga vullneti i tij/saj për të bashkëpunuar me drejtësinë. Kjo leje qëndrimi i jepet viktimës ose viktimës së mundshme të trafikimit me qëllim që të rimarrë veten, si dhe të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirëinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë.

Kjo leje e qëndrimit mund të revokohet nëse provohet se viktima ose viktima e mundshme e trafikimit e ka fituar apo pretenduar këtë status në mënyrë të padrejtë, ka rivendosur aktivisht, vullnetarisht dhe/apo me iniciativën e saj/të tij marrëdhënie me personat e dyshuar për trafikimin e qenieve njerëzore ose konsiderohet se qëndrimi i saj/tij në territor përbën rrezik për sigurinë kombëtare.

Një leje tjetër qëndrimi që i jepet viktimave të trafikimit është leja e përkohshme e tipit "B" kur autoriteti për kufirin dhe migracionin vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për shkak të situatës sociale dhe personale ose qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për qëllim të bashkëpunimit me organet e drejtësisë gjatë

¹¹ Ligji nr. 10383, datë 24. 02. 2001 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në 2014, specifikisht të nenit 5, "personat e siguruar", pikës 2

hetimit ose procedimit penal. Lejet jepen edhe kur viktimat nuk kanë mjete financiare edhe kur nuk kanë dokumente identifikuese.

Mosdëbim/ekzekutim vullnetar i urdhrit të largimit

Sipas ligjit për të huajt, nëse është marrë një vendim për largimin e viktimës së trafikimit nga territori, autoritetet nuk e zbatojnë urdhrin e largimit nëse viktimat nuk do të largohet vetë vullnetarisht nga territori. Në raste se viktimat largohet vetë kjo merret parasysht dhe viktimës nuk i ndalohej rihyrja në Shqipëri.

Ndihmë për kthim në vendin e origjinës

PSV-të aktuale dhe ato në zhvillim e sipër parashikojnë masa të posaçme për lehtësimin e kthimit të viktimës së trafikimit të huaj në vendin e vet të origjinës. Këto masa synojnë të bëjnë të mundur që kthimi të bëhet në mënyrë vullnetare dhe i asistuar dhe i sigurt- viktimat të mos përballet me rreziqe.

PSV-të gjithashtu parashikojnë masa për pritjen e viktimave shqiptare të identifikuar jashtë. Këto masa përfshijnë vlerësimin e përshtatshmërisë së kthimit /situatë sociale ekonomike që duhet bërë nga punonjësit social të njësive vendore.

Arsim

Sipas Ligjit 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” fëmijët viktimat të trafikimit i përfitojnë tekstet falas, si dhe iu lehtësohen procedurat për regjistrimin në shkollë. Shkollimi është në paketën e shërbimeve që duhet të ofrojë një qendër rezidenciale. Në çdo qendër rezidenciale për viktimat e dhunës apo të trafikimit ka një mësues në përbërjen e ekipit multidisiplinar i cili bën vlerësimin e nevojave për edukim të viktimave të dhunës, apo trafikimit si dhe fëmijëve të tyre. Strehëzat kanë ngritur marëdhëniet të ngushta bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale të Arsimit për të regjistruar përfituesit në shkollë.

Ndihmë ligjore për proceset civile

Sipas nenit 13, “Kriteret për përfitimin e ndihmës juridike” të ligjit për ndihmën juridike, viktimat e dhunës në familje, ose viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, kanë të drejtë për të përfituar ndihmën juridike për çështjet gjyqësore që lidhen me to.¹² Përfituesit e qendrave rezidenciale mbështeten me ndihmë ligjore sipas nevojave të tyre.

Ata informohen në lidhje me të drejtat/ detyrimet në rast të bashkëpunimit me institucionet e zbatimit të ligjit dhe çdo qendër sipas standarteve ka një jurist/avokat i cili përfaqëson përfituesit në seancat gjyqësore sipas nevojave, për marrjen e urdhrit të mbrojtjes, çështje divorci, kujdestarie, pronësie etj. Për viktimat e trafikimit ndihma ligjore konsiston gjithashtu në informimin për programin e mbrojtjes së dëshmitarit dhe ndihmës nëpërmjet bashkëpunimit me prokurorin e çështjes për të përfshirë viktimën në këtë program, në informimin mbi të drejtën për kompensim si dhe mbështetjen për gëzimin e kësaj të drejte.

Punësim

Punësimi është faktor kyç për fuqizimin e përfituesve dhe Zyrat Rajonale të punësimit për gjetjen e vendeve të sigurta të punës për përfituesit.

Zyrat Rajonale të Punësimit ndihmojnë nëpërmjet orientimit dhe këshillimit të karrierës, nëpërmjet ndërmjetësimit për punësim, nëpërmjet përfshirjes së viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje në programet e nxitjes së punësimit.¹³ Për arsye të ndryshme, viktimat e dhunës dhe të trafikimit mund të hasin sfida të ndryshme në punësim. Kështu p.sh. për shkak të vështirësive të tregut të punës, formimit arsimor të pamjaftueshëm, vetëvlerësimit të ulët etj. ato mund të pranojnë punë ose ambiente pune të cilat mbartin rrezikun e riviktimizimit: punë me orare të zgjatura.

Në çdo strehëz përfituesit dhe fëmijët e tyre ndihmohen për të zhvilluar aftësi për jetën duke përfshirë këtu të lexuarit, gatimin, aftësi sociale bazë, dhe aktivitete edukative. Trajnimi profesional është një element i rëndësishëm i planit të ndihmës pasi rrit mundësitë për punësim të përfituesve. Vajzat dhe gratë e trafikuar që janë punëkërkes të papunë të rregjistruar si të tillë në zyrat e punësimit hyjnë në kategoritë që mund të përfitojnë kurse profesionale falas.¹⁴

Ofruesit e shërbimeve ndihmojnë në identifikimin e mundësive dhe dëshirës së individit për të ndjekur trajnime profesionale; në këshillimin e rasteve duke i orientuar për mundësitë e trajnimeve dhe mundësitë e punësimit.

¹² Ligjit nr. 10039, datë 22. 12. 2008 “Për ndihmën juridike” të ndryshuar, Neni 13

¹³ VKM Nr. 27, datë 11. 1. 2012 “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”

¹⁴ Urdhër nr.782 datë 04.04.06 i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale “Për tarifën e Sistemit të Formimit Profesional”.

Organizata ka aplikuar dhe do të vazhdojë të aplikojë një proces që quhet cikli i këshillimit për punësim. Cikli i këshillimit konsiston në një trajner/këshillues që punon me një grup të viktimave të trafikimit, dhunës dhe abuzimit për të rritur kapacitetet e tyre për punësim. Cikli përfshin eksplorimin e vetes, eksplorimin e botës së punës, përgatitjen e aftësive të nevojshme për profesionin dhe punën e dëshiruar dhe të kërkuar në treg, përgatitjen e portofolit të punësimit etj. Kjo mbështetje përfshin edhe mbështetje me grante për ngritje dhe menaxhim të aktiviteteve ekonomike apo bizneseve

Citim i njëres nga strehëzat e organizatave pjesëmarrëse në projekt

5.1.4 - Si duhet ta dokumentojmë dhënien e ndihmës

Standartet për qendrat rezidenciale për viktimat e trafikimit dhe PSV-të përmbajnë formularë të dokumentimit të ndihmës

5.2 - NDIHMA PËR VIKTIMAT E DHUNËS

5.2.1 - Shembuj të praktikës dhe sfidave lidhur me ndihmën

Zonja me inicialet E.M. afër të pesëdhjetave 50, ndenji dy ditë në konviktin e vajzave, pastaj punonjësit e Bashkisë njoftuan organizatën që menaxhonte qendrën e emergjencës. Punonjësit e qendrës së emergjencës bënë vlerësimin dhe e strehuan.

Pas skadimit të afatit të emergjencës, meqenëse nuk kishte ku të shkonte sepse s'kishte të afërm në Shqipëri, dhe meqenëse në takimin e parë që kishin patur gruaja ishte paraqitur në gjendje konfuzioni dhe ankthi, punonjësit e Bashkisë kishin krijuar përshtypjen se asaj i duhej shtrimi në spital dhe orientuan organizatën që gruaja të shtrohej në spitalin psikiatrik.

Punonjësit e qendrës së emergjencës nuk ranë dakord me këtë dhe kërkuar një vlerësim të thelluar. Psikiatria e qendrës komunitare të shëndetit mendor bëri vlerësimin dhe vendosi për trajtimin në shtëpi/në qendër të gruas. Gruaja qëndroi në qendrën e emergjencës për rreth një muaj.

Organizata u lidh me simotrat e saj në Itali edhe me ndërhyrjen e CIES identifikoi një organizatë italiane që mund ta ndihmonte, dhe pagoi shpenzimet e udhëtimit. Gruaja u kthye në Itali ku aktualisht po ndihmohet. Vazhdon të mbajë kontakt me organizatën dhe shprehet se ndjehet mirë.

Citim i njëres nga strehëzat e organizatave pjesëmarrëse në projekt

M. u ndihmua nga organizata... për tu punësuar në një fabrikë peshku. Pas dy ditësh, punonjësi i organizatës e sheh që M. ishte përsëri në rrugë së bashku me fëmijët e saj. Punonjësi e pyet dhe M. i përgjigjet që nuk mund të punonte për arsye se ajo ishte shtatzanë, puna ishte e rëndë dhe rroga që do të merrte ishte më e vogël se çfarë mund të nxirrte me lypje.

Citim i njëres nga strehëzat e organizatave pjesëmarrëse në projekt

Nga programi i strehimit në bashki nuk ka përfituar asnjë prej grave të dhunuara. Janë dërguar së fundmi mbi 20 aplikime të grave për bonuse sociale dhe vetëm 2 prej tyre janë përfituese. Arsye e mospërfitimit është mospërbushja e kriterëve të strehimit. Ndryshimi legjislativ mendohet të sjellë ndryshime pozitive në aplikime dhe përfitime për bonuse strehimi.

Citim i njëres nga strehëzat e organizatave pjesëmarrëse në projekt

Çfarë duhet bërë në bashki për të ndihmuar adresuar sfidat e deritanishme për të ndihmuar viktimat e dhunës?

- Të trejtohen dhe të rriten kapacitetet për punonjësit e zyrave me një ndalesë për tu dhënë informacion rasteve në nevojë
- Të ngrihet sisteme "on line" për drejtorinë e shërbimit social për të hedhur dhe filtruar të dhënat në kohë reale dhe mbi bazën e tyre të analizohen dhe programohen plane ndërhyrjesh në fusha të ndryshme si

- punësimi, strehimi, aksesimi në arsim e shëndetësi
- Të rritet masa e ndihmës ekonomike për gratë e dhunuara e të trafikuar
- Të shtohen punonjësit që t'u përgjigjen kërkesave ligjore
- Të shtohet baza materiale, mjetet logjistike për monitorimin dhe vlerësimin e rasteve
- Të ngrihen shërbimet e emergjencës në nivel lokal nga bashkia për asistimin e viktimave të dhunës
- T'i jepet prioritet viktimave në programet e strehimit

5.2.2 - Çfarë duhet të dimë/si duhet të përgatitemi për ndihmën

a) Të kemi një listë të saktë shërbimesh dhe të dihen kriteret e pranimit në kujdes

Sipas VKM 334 (pika 10dh), koordinatori vendor i dhunës/punonjësi i bashkisë duhet ta ketë gjithnjë të gatshme dhe të rifreskuar një listë të shërbimeve. Sipas ligjit për shërbimet sociale vlerësimi i nevojave dhe rrjedhimisht edhe vlerësimi nëse dikush mund të përftojë shërbime do të bëhet nga njësitë e vlerësimit të nevojave dhe të referimit. Përfituesit e shërbimit të kujdesit të përkohshëm- individët që ndodhen në rrethana të vështira dhe emergjente, nuk do të kalojnë në procesin e zakonshëm të vlerësimit të rastit, por vetëm referohen nëpërmjet punonjësit social. Kjo do të thotë që punonjësi social që referon/punonjësi i bashkisë duhet të njohë mirë kriteret e pranimit që përdorin ofruesit e shërbimit të kujdesit të përkohshëm në mënyrë që të shmangët rreziku i qëndrimit të panevojshëm, të lodhshëm e të rrezikshëm të grave dhe fëmijëve në zyra, ambiente të policisë, tek të afërm apo të lidhur me abuzuesit etj.

b) Të kemi një paketë sa më të plotë

Sipas ofruesve të shërbimit çdo individ ka nevojat e veta specifike por gama e nevojave për të cilat duhet të jemi të përgatitur të adresojmë është e gjerë.

“Shërbimet duhen dhënë në bazë të vlerësimit të nevojave, por një paketë ndihme për viktimat e dhunës në familje duhet të jetë në gjendje të adresojë nevojat për strehim emergjent, transport në një vend të sigurt, akomodim dhe ushqim, mbështetje psikosociale dhe emocionale, konsulencë dhe mbështetje ligjore, mbështetje ekonomike në rast të marrjes së UM, gjetjen dhe pagesën e një banese me qera, kujdes shëndetsor dhe pagesën e ilaçeve të fëmijëve, referim për ndjekjen e një kursi profesional, ndihmë dhe mbështetje për punësim në bashkëpunim me zyrën rajonale të punësimit, rregjistrim i fëmijëve në çerdhe apo kopshte, pagesë e çerdhes apo kopshtit, pajisja me libra e mjete shkollore të fëmijëve të viktimës”.

c) Të njohim të drejtat për ndihmë të përcaktuara me ligj

SHERBIM	AKT LIGJORE
Shërbime shoqërore	Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë, neni 6
Strehim në qendra të mbrojtura	Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” neni 123 Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë: Neni 17- Strehizat VKM Nr. 505 datë 13.07.2011 “Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje në qendrat rezidenciale publike e jopublike” Udhëzim Nr. 13 , datë 17.12.2012 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”
Ndihmë psikologjike në qendër rezidenciale	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505 , datë 13.7.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”
Strehim social	Ligj Nr.9232 , datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”. Neni 5, Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve” VKM Nr. 575 , datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”
Ndihmë materiale, financiare në qendër rezidenciale	Ligj Nr.10399 , datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore të ndryshuar” Vendim i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 114 , datë 31.01.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”.

SHERBIM	AKT LIGJORE
Kujdes Shëndetësor	Ligji nr. 10383 , datë 24.02.2001 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Arsim	Ligj 69/2012 , “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”
Ndihmë ligjore për proceset civile	Ligji Nr. 10039 , datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” i ndryshuar
Punësim	Ligj Nr. 7995 , date 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” VKM Nr. 27 , datë 11.1.2012 “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”

ç) Të njohim shërbimet për ndryshimin e sjelljeve të dhunuesve.

Aktualisht ka në Shqipëri dy qendra për këshillimin e burrave të dhunshëm të cilat janë ngritur në 2014 me iniciativën e organizatave Gruaja te Gruaja në Shkodër (qendra ZBD) dhe Linja e Këshillimit për gra dhe Vajza në Tiranë (Qendra CLMB) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe me mbështetjen e vazhdueshme të IAMANEH në Zvicër¹⁵ dhe CIES/GEMAL¹⁶. Është aktualisht në proces një trajnim për këshillues me pjesëmarrës nga Shkodra, Tirana, Pogradeci, Vlora dhe Elbasani.

d) Nuk është e domosdoshme që palët të bien dakord që duhet të kërkohet një urdhër mbrojtje

Sipas ligjit 9669, urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes mund ta kërkojnë jo vetëm policia por edhe viktimat, përfaqësuesi ligjor, një person i afërm i viktimës, qendrat e licensuara, përfaqësuesit e shërbimit social ku ka banimin e përkohshëm apo të përhershëm viktimat. Është e favorshme paraqitja e kërkesë padisë nga policia sepse edhe në rast se vikimata tërhiqet, gjykata e gjykon dhe merr vendim.

e) Ndërhyjes për të ndihmuar viktimën i duhet t'i jepet prioritet dhe kohë e përshtatshme

Në kohën e hartimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit, nëpunësit e barazisë gjinore që ishin vendosur¹⁷ luanin njëkohësisht edhe rolin e koordinatorit vendor kundër dhunës në familje, si dhe mbulonin një sërë detyrimesh të lidhura me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, komunitetin rom dhe egjiptjan, komunitetin LGBTI, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, etj.

Ndërsa çdo rast është i veçantë dhe kërkon kohë dhe investim të ndryshëm nga një rast tjetër, në llogaritjen e ngarkesës me raste të dhunës në familje të një punonjësi të bashkisë duhen marrë në konsideratë elementë të tillë si eksperiencia si menaxher rasti, profesioni i tij/saj,¹⁸ teknologjia në dispozicion (nëse do të shkruajë me dorë apo me kompjuter), aktivitetet e tjera që kryen që nuk kanë lidhje me rastin (takimet, edukimi i vazhduar, udhëtimi, trajnimet etj.).¹⁹

f) Të dihet se largimi i gruas dhe fëmijës nga shtëpia ku abuzohet perceptohet si dëmim dhe krijon probleme afatgjata të strehimit

Sipas një ofruesi të shërbimit gratë e dhunuara e konsiderojnë largimin nga shtëpia si një dhunim të dytë. Një prej përfituesve është shprehur kështu:

“Ne jo vetem që dhunohemi, por na nxjerrin nga shtëpia dhe jetojmë me qera. Kam 4 fëmijë dhe falë ndihmës së një organizate që më ka punësuar bëj të mundur jetesën me qera. Problemi im është përfaqësuar nga këto organizata por për shkak të kriterit financiar nuk jam kualifikuar”.

g) Të njihen paraprakisht kushtet e punësimit kur ndërhyet për punësim

Sipas një prej ofruesve të shërbimeve, mund të jetë problem punësimi tek fasoneritë:

“Tek punësimi ka një problem që fasoneritë i paguajnë gratë me një pagesë minimaliste dhe ato nuk kanë

¹⁵ <https://www.iamaneh.ch/en/projects/albanien/gewaltberatung-fuer-maenner-im-norden.html>

¹⁶ <https://www.cies.it/copy-of-rafforzamento-dei-cacs>

¹⁷ 44 Bashki (nga 61) kanë deklaruar se kanë të emëruar nëpunës të barazisë gjinore

¹⁸ Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror kërkon punonjës socialë

¹⁹ Pwr mw shumw vizito- <https://casemanagementstudyguide.com/ccm-knowledge-domains/case-management-concepts/case-load-calculation/>

mundësi të paguajnë as shpenzimet minimale. Fasoneritë janë kthyer në biznese skllavërie për to”

gj) Të jemi të përgatitur të mos neglizhojmë por të adresojmë problemet e fëmijëve si pasojë e dhunës në familje

Fëmijët mund të dëshmojnë, të dëgjojnë, të observojnë dhe të jenë koshientë për dhunën. Me fjalë të thjeshta ata shohin me sytë e tyre incidentet e dhunës fizike dhe ose seksuale, dëgjojnë kërcënimet apo zhurmën e luftës në dhomën tjetër, vrojtojnë gjurmët që ka lënë dhuna, gjakun, të nxirat, rrobat e grisura, gjërat e thyera, dhe mund të ndjejnë tensionin tek nëna e tyre kur abuzuesi afrohet. Kjo i ben ata viktimat e dhunës në familje. Meqënëse nëna mundohet të mbijetojë dhe babai i konsumuar me kontrollin, ata nuk janë prezentë për fëmijët - fëmijët braktisen fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht. Fëmijët nga familje me dhunë kanë rrezik më të lartë për abuzim me alkoolin dhe drogat, stresin posttraumatic, delinquencën në moshën e hershme dhe kriminalitetin në moshë të rritur. Dhuna në familje është faktori nr. 1 që fëmijët ikin nga shtëpia.²⁰ Sipas ofruesve të shërbimit, në fëmijët e grave të dhunuara kemi braktisje shkollore për shkak të mos plotësimin të nevojave të fëmijëve.

Sipas UNICEF, për të adresuar problemet e fëmijëve është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për efektet e dhunës në familje tek fëmijët, krijimi i politikave publike që mbrojnë fëmijët, zgjerimi i shërbimeve sociale që adresojnë efektet e dhunës në familje.²¹

Kontribuesit e këtij manuali theksojnë nevojën që të bëhen përpjekje që shërbimet që u jepen nënave të përfshijnë shërbimet për fëmijët, fëmijët të kenë trajtim të veçantë, si kategori me të drejtat e tyre si viktimat e dhunës dhe jo si kategori sekondare- duhet të ketë dhe të gjenden shërbime të dedikuara për fëmijët dhe jo të shihen ata si përgjegjësi totale e nënave të tyre. E njëjta gjë duhet të ndodhë për fëmijët viktimat- shërbimet për ta duhet të përfshijnë shërbimet për nënat e tyre dhe familjarët e tyre mëbështetës.

5.2.3 - Si duhet ta japim ndihmën

a) Duhet të shmangim që lidhjet mes viktimave dhe shërbimeve të bëhen pa dijeninë dhe pa rolin e koordinatorëve vendorë dhe që koordinatorët vendorë vetëm të informohen

Në disa raste, policia duke u përpjekur të zgjidhë sa më shpejt nevojat e rastit, vendoset në lidhje direkte me organizatat me të cilat ka praktikë të mirë bashkëpunimi dhe realizon vendosjen e rastit, dhe bile edhe kthimin në shtëpi: koordinatori vendor e merr vesh rastin vetëm për efekt informacioni. Në raste të tjera vetë organizatat i marrin përsipër të gjitha veprimet, duke filluar qysh me vlerësimin duke mos e njoftuar koordinatorin vendor të dhunës. Kjo mënyrë të vepruarit të paktën i mophon gruas dhe fëmijëve të drejtën për të patur një vlerësim të plotë multidisiplinar të nevojave dhe adresim të tillë të tyre.

b) Duhet të shmangim zgjidhjet “oportuniste”, “të atypëratyshme” apo për shkak të mangësive të sistemit

Ndarja e nënës nga fëmija, apo vendosja në spital psikiatrik mund të mos jenë zgjidhje në të mirë të rastit por zgjidhje në të mirë të sistemit të cilat mund të shkaktojnë dëme të pariparueshme tek vetë viktimat. Zgjidhje të tilla duhen shmangur gjithmonë.

c) Duhet shfrytëzuar shërbimi i shëndetit mendor komunitar

Një vlerësim i mirë, objektiv dhe neutral i personit nga specialistët e shëndetit mendor ndihmon në përcaktimin më të mirë të roleve që aktorët e mekanizmit - rrjedhimisht edhe koordinatorët vendorë apo PMF-të do të kenë në trajtimin e rastit.

ç) Bashkëpunimi mes bashkive për rastet duhet institucionalizuar

Pavarësisht kontakteve dhe marrëdhënieve të mira ndërpersonale, mes profesionistëve apo mes qendrave, trajtimi i rasteve duhet rregulluar me marrëveshje që të shmangë “hedhje pritjet e rasteve”.²²

d) Duhet kuptuar se denoncimi, kallzimi, pjesëmarrja në procese gjyqësore nuk është kusht për të ndihmuar një viktimë:

Moskushtëzimi i ndihmës me bashkëpunimin është parim thelbësor në mbrojtjen e viktimave gra dhe fëmijë.

²⁰ <http://www.domesticviolenceroundtable.org/effect-on-children.html>

²¹ <https://www.unicef.org/media/files/BehindClosedDoors.pdf>

²² Institucionet në Bashkinë Vlorë kanë firmosur marrëveshje të mekanizmit me detyra specifike

e) Duhet mbështetur kontrolli mbi jetën dhe vetëvendosja

Viktimit duhen trajtuar me respekt duhen lejuar të bëjnë zgjedhjet e tyre dhe nuk duhen gjykuar për ato zgjedhje. Viktimat mund të zgjedhin edhe të jetojnë me dhunuesin- në këtë rast detyra e profesionistit është që të sigurojë që dhuna të mos përsëritet.

f) Duhet fleksibilitet në strehimin emergjent

Në shumë raste rezulton se është e pamundur që të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme brenda periudhës së rënë dakord për emergjencën. Për këtë arsye aktorët duhet të komunikojnë, të vendosin bashkërisht dhe të dokumentojnë vendimin e përbashkët për një qëndrim më të gjatë të personit të dhunuar në një qendër të emergjencës.

h) Duhet marrë parasysh dhe duhen filluar veprimet për adresimin e nevojave që gruaja e dhunuar do të ketë pas daljes nga emergjenca apo strehëza

Për shkak të burimeve të kufizuara, punës mbi bazë projektesh afatshkurtra, etj., ofruesit e shërbimeve nga organizatat mund të hezitojnë të përfshihen në diskutime apo të marrin përsipër adresimin e nevojave afatgjata të një viktime dhe fëmijëve/familjes së saj. Ndërsa nuk mund të bëjnë premtime që nuk mund të mbahen, punonjësit e bashkisë duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që shërbimet bazë: ushqimi i përditshëm, strehimi, dhe adresimi i problemeve të shëndetit pas daljes nga strehëzat të zgjidhen me fonde të buxhetit të bashkisë.

i) ndihma duhet informuar tek viktimat që ato ta marrin

Sipas ofruesve të shërbimit është e nevojshme “të ketë një platformë “on line” jo vetëm për të rritur raportimin e dhunës por edhe për të informuar dhe orientuar mbi shërbimet dhe funksionimin e tyre”.

5.2.4 - Si duhet ta dokumentojmë dhënien e ndihmës

Dokumentimi i ndihmës bëhet nëpërmjet bazës së të dhënave në NJQV, dosjet për secilin rast, si edhe regjistrin të përfituesve.²³

Në dokumentimin e ndihmës duhet të kemi parasysh se në kuptimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale,²⁴ ofruesit e shërbimeve janë “kontrollues” - person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale.²⁵ Sipas këtij ligji, ata kanë detyrimin të njoftojnë komisionerin që po përpunojnë të dhëna personale, kur përpunojnë të dhëna për herë të parë ose kur ndryshon qëllimi i përpunimit i njoftuar më parë.

²² Detyrimi ligjor për parashikim në buxhetin në nivel lokal të një përqindjeje për dhunën në familje është në Strategjinë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2015-2017

²³ Sipas ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, nenit 37, “Roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore”, pikës (d), punonjësit kanë për detyrë të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror

²⁴ Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

²⁵ Të dhëna personale në kuptim të këtij ligji është çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm.

Elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj.

6.1 - SI DUHET TA KUPTOJMË BASHKËPUNIMIN E VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT

Bashkëpunimi i viktimave të trafikimit me drejtësinë duhet parë si marrëdhënie e vendosur me dëshirën e vetë viktimës, duke marrë në konsideratë vullnetin, mundësinë e viktimës, si dhe garancitë e ofruara nga organi procedurës për mbrojtjen dhe sigurinë fizike të viktimës për të bashkëpunuar. Bashkëpunimi me viktimat e trafikimit duhet të ndërtohet sipas standardeve ligjore mbështetur në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë si dhe legjislacionin e brendshëm, në veçanti ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale.

6.2 - ÇFARË DUHET TË DIMË NË LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN E VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT

a) Ndihma ndaj viktimave të trafikimit nuk mund të kushtëzohet nga detyrimi për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë.

Në nenin pikën 6 dhe 7 të nenit 12 të **ligjit Nr. 9644**, datë 20.12.2006, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore" thuhet se: "Çdo Palë do të miratojë ato masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar që ndihma ndaj viktimës nuk bëhet e kushtëzuar me gatishmërinë e tij ose të saj për t'u thirrur si dëshmitar. Për zbatimin e dispozitave të parashtruara në këtë nen, çdo Palë do të sigurojë që shërbimet të ofrohen mbi bazën e konsensusit dhe informimit, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta të personave në një pozitë të pafuqishme dhe të drejtat e fëmijëve në lidhje me akomodimin, edukimin dhe kujdesin e përshtatshëm shëndetësor".

b) Viktima ka të drejta në procesin penal.

Sipas të **Kodit të Procedurës Penal** (KPP) të RSH,¹ **nenit 9**, pika 2, "Organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod". Ndërsa në **nenin 58** të KPP listohen të drejtat e viktimave të veprës penale. Tabela më poshtë jep të drejtat e viktimës së veprës penale sipas këtij neni.

LLOJIN E SË DREJTËS	NENI 58
E drejta për të kërkuar ndjekjen penale të fajtorit	PIKA 1 a
E drejta për të përfituar kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale	PIKA 1 b
E drejta për të komunikuar në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar	PIKA 1 c
E drejta për të zgjedhur mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi	PIKA 1 ç
E drejta për të kërkuar në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa çënuar parimin e sekretit hetimor	PIKA 1 d
E drejta për të kërkuar marrjen e provave, si dhe për të parashtruar kërkesa të tjera përpara organit procedues	PIKA 1 dh
E drejta të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjyqimit	PIKA 1 e
E drejta të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen	PIKA 1 f

¹ Neni 9 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, përditësuar me ligjin 37/2017

LLOJIN E SË DREJTËS	NENI 58
E drejta të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal	PIKA 1 g
E drejta të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifës gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale	PIKA 1 gj
E drejta të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore	PIKA 1 h
E drejta të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar	PIKA 1 i
E drejta të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga KPP .	PIKA 1 j

c) Është detyrë e prokurorisë ta njoftojë viktimën për këto të drejta

Sipas pikës 2 të të njëjtit nen, të KPPsë, Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

ç) Viktima ka të drejtën e përfaqësimit

Sipas pikës 3 të të njëjtit nen, të KPPsë, viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse rastit kur nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

d) Trashëgimtarët e viktimës kanë edhe ata të drejta²

Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtë për të kërkuar ndjekjen penale të fajtorit, të informohen për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në KPP, të njoftohen për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit, të bëjnë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen, të kërkojnë shpërblimin e dëmit dhe të pranohen si paditës civilë në procesin penal.³

dh) Fëmijët viktima kanë edhe të drejta të tjera

Sipas nenit 58/a të KPP, përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të këtij Kodi, si dhe legjislacionin e posaçëm për të miturit, viktima e mitur ka të drejtë:

- të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

Sipas këtij neni, organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysht moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm.

e) Viktima prezumohet se është e mitur

Sipas pikës 3 të nenit 58/a të KPP, nëse ekziston mundësia që viktima është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

f) Rregjistrimi i pyetjes së fëmijës nga persona të specializuar mund të përdoret në gjykatë

Sipas pikës 4 të nenit 58/a të KPP, viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të Kodit. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kriterëve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të Kodit. Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedise të përshtatura për të.

² Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor

³ Parashikuara në shkronjat "a", "e", "ë", "f", "g" dhe "j", të paragrafit 1, të këtij neni

g) Prokurori mund të rrëzojë kërkesën e viktimës për informim

Në Nenin 279/a⁴ të KPP parashikohet e drejta e viktimës për informim. Sipas pikës 1 këtij të këtij neni për shkaqe të ligjshme, viktimat, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihen dhe të marrin kopje të akteve dhe provave që ndodhen në fashikullin e prokurorit. Në pikën 2 të këtij neni sqarohet se Prokurori mund të refuzojë kërkesën për informacion kur:

- a) interesi i ruajtjes së fshehtësisë së hetimit tejkalon interesin e viktimës;
- b) interesi i të pandehurit tejkalon interesin e viktimës;
- c) viktimat nuk është pyetur ende si dëshmitar.

Gjithashtu, në pikën 3 thuhet se viktimat, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion në lidhje me vendosjen, vazhdimin, zëvendësimin apo heqjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit, përveçse kur njoftimi për këto fakte mund të rrezikojë jetën ose shëndetin e të pandehurit.

gj) Ka garanci dhe të drejta shtesë për viktimat e trafikimit

Sipas nenit 52/a⁵ të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë viktimat e trafikimit përjashtohet nga përgjegjësia penale për veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë periudhës së trafikimit. Në paragrafin e dytë të këtij neni thuhet shprehimisht: *“Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t’i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme”*.

Në nenin 58/b të KPP parashikohen disa garanci shtesë për viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Veç të drejtave të parashikuara në nenet 58 dhe 58/a të KPP viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë gjithashtu të drejtë:

- a) të pyeten pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini;
- b) të refuzojnë t’u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;
- c) të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

h) Ka kompesim për viktimat e trafikimit⁶

Sipas K.Pr.P (neni 68), viktimat e trafikimit mund të marrë pjesë si palë në proces, nëpërmjet padisë civile në procesin penal, për të kërkuar dëmshpërbimin e dëmit. Në praktikë ka patur shumë vështirësi për zbatimin e kësaj dispozite dhe vështirësia kryesore qëndron në faktin e ndarjes së procesit penal nga ai civil, praktikë kjo e aplikuar nga gjykatat tona pothuajse në të gjitha rastet e ngjashme. Në vetvete procesi civil zgjat shumë në kohë, nuk është efektiv dhe për më tepër ka edhe kosto, të cilat nuk mund të përballohen nga një viktimë trafikimi. Gjithsesi, mundësia për të kërkuar kompsimin e dëmit nga viktimat është një mjet nxitës për ta shtyrë atë drejt bashkëpunimit sepse që të kemi një proces të sukseshëm duhet të kemi një vendim gjyqësor të fomës së prerë që rezulton me dënimin e trafikantit. Në këtë rast viktimat do të dëshmojnë dhe do të ndihmojnë në sigurimin e provave.

i) Viktimat mund të përfitojnë nga programi i mbrojtjes së dëshmitarit

Programi për mbrojtjen e dëshmitarit është një masë e posaçme që mund të aplikohet edhe për viktimat e trafikimit që dëshmojnë në proces, për shkak të bashkëpunimit të saj me Prokurorinë. Në zbatim të nenit 28 të ligjit nr.10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar, është hartuar Projektudhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm “Për kushtet, rregullat, procedurat dhe mënyrat e zbatimit të programit të mbrojtjes, ndaj bashkëpunëtorëve të drejtësisë, kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për programin e mbrojtjes”. Masat e posaçme të mbrojtjes që zbatohen janë: *ndryshim vendbanimi, mbrojtje fizike dhe teknike në vendin ku qëndron personi dhe gjatë lëvizjes, dhënia e dokumenteve, dhënia e ndihmës financiare, rehabilitim social, rikualifikim profesional*.

j) Ndjekja penale e trafikantëve dhe dhunuesve është një e drejtë e personave viktimë dhe një detyrim i forcave të ligjit .

Ankimi në kuptimin e së drejtës dhe procedurës penale, është një deklaratë, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, i dëmtuari shfaq vullnetin ku një person ose disa persona të procedohen në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale. Kjo deklaratë bëhet para prokurorit

⁴ Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017

⁵ Shtuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013

⁶ Neni 68 I Kodit të Procedurës Penale

ose oficerit të policisë gjyqësore. Ankimi mund të bëhet me shkrim ose me gojë. Në rastet kur bëhet me gojë, procesverbali i mbajtur nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij. Keqtrajtimi i fëmijëve, dhuna në familje apo trafikimi janë të gjitha vepra penale të cilat nuk kërkojnë ankimin e të dëmtuarit për të filluar ndjekjen penale të dhunuesit apo trafikantit. Kjo do të thotë që personat viktimë nuk e kanë të detyrueshme të bëjnë kërkesa përpara prokurorëve apo punonjësve të policisë që dhunuesit të dënohen. Ata mund ta bëjnë këtë nëse duan por është detyrë e forcave të ligjit që kur marrin informacion të fillojnë hetimet për zbulimin e veprës penale.

k) Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) mbështet fillimin e hetimit qoftë me ankim, qoftë me iniciativë MKR është ngritur në mënyrë të tillë që personat që mund të jenë të trafikuar të japin informacion të vlefshëm për nisjen e hetimeve gjatë identifikimit fillestar dhe identifikimit zyrtar. Viktimat e mundshme të trafikimit të rritur kanë kontakt⁷ të pashmangshëm apo të pavullnetshëm “me policinë në rastet kur kalojnë kufirin, apo kur policia bën kontrolle, verifikime në rrugë, ambjente pune, argëtimi etj. Jo në të gjitha këto kontakte ka mundësi që të mblidhet informacion i mjaftueshëm që të konsiderohet se policia “mori dijeni” dhe rrjedhimisht të nisë hetimet me iniciativën e vet ose “kryesisht”. Është intervista formale apo zyrtare ajo që mund të japë më shumë informacion për të filluar hetimet. Për këtë arsye, edhe pse intervista formale apo zyrtare nuk është e detyrueshme, është e rëndësishme që personat që identifikohen si viktimat të mundshme të trafikimit nga agjenci të tjera dhe nuk kanë patur kontakt me policinë, të nxiten të vendosin kontakt me policinë dhe të zhvillojnë intervistën formale, të marrin informacion dhe të kuptojnë parashikimet ligjore për hetimin dhe dënimin e trafikantëve, dhe të vendosin vetë mbi përfshirjen e tyre në këtë proces.

I) Të kuptojmë se çfarë janë provat

Sipas Kodit të procedurës penale, prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij (KPP neni 43). Provat ndahen në prova të marra gjatë hetimeve - prova që i merr prokuroria/organi që procedon, dhe prova gjatë gjykimit që merren me kërkesën e palëve. Çmuarjen e provave ndryshe përcaktimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre e bën Gjykata (KPP neni 152). Llojet e provave përfshijnë dëshmitë, pyetjen e të pandehurve, pyetja e palëve private, ballafaqimet, njohjet e personave dhe të sendeve, eksperimenti, ekspertimi, prova materiale- sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes, dokumentet.

II) Të njohim dënimet për vepra të ndryshme

Dhunuesit, trafikantët, mund të dënohen për vepra komplekse si trafikimi ose dhuna në familje ose për elementë që janë vepra të vecanta sic mund të jenë plagosja e lehtë me dashje (N.89/p1) marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura (N. 102/p.1), marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona në gjini apo kujdestari (N.106), shtrëngimi apo pengimi për martesë ose bashkëjetesë (N.130).

6.3 - ÇFARË DUHET TË BËJMË NË LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN E VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT

Janë organizuar shërbime policore për të verifikuar problemin dhe identifikuar subjektet e veprimtarisë kriminale si dhe të dëmtuarit nga kjo vepër penale. Nga raportet e shërbimit të mbajtura ka rezultuar se i pandehuri () nxjerr fëmijët për të lypur në rrugë ndërsa vetë qëndron i ulur dhe përfiton të ardhurat e nxjerra nga fëmijët.


Është sekuestruar në cilësinë e provës materiale CD e pamjeve filmike të drejtorisë së Policisë së qarkut Tirane, ku pasqyrohet fakti se i pandehuri nxjerr një fëmijë 5 vjeçar për të lypur në rrugë.

I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime i pandehuri () ka pranuar faktin që del për të lypur në rrugë së bashku me fëmijët e tij pasi janë në gjendje shumë të vështirë ekonomike. Nisur nga sa sipër është kryer arrestimi në flagrancë i të pandehurit (), për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit”, të parashikuar nga neni 124/b/2 i K.Penal

⁷ Shih Kodi i Procedurës Penale , neni 284, Ankimi

1. Të kujdesemi që në asnjë rast dhe nga asnjëra palë intervista formale nuk konsiderohet si “deklarim” në kuptimin e kodit penal dhe punonjësi social me cilësinë e intervistuesit nuk konsiderohet si “i pranishëm” apo “konfirmues” i thënieve
2. Të kujdesemi që punonjësit e zbatimit të ligjit, policia dhe prokuroria nuk trajtojnë në mënyrë të diferencuar vikimat që bëjnë deklarime nga vikimat që nuk bëjnë deklarime
3. Të kujdesemi që rasti/fëmijë apo i/e rritur dhe personat e afërt që e mbështesin atë apo kujdestarët të kuptojë implikimet e informacionit të dhënë në polici apo në prokurori, mënyrën se si do të përdoret ky informacion, kuptimin dhe vlerën e çdo shkrese që shkruhet, lexohet apo firmoset në ambjentet e forcave të ligjit
4. Të mbështesim vikimat që në kohë të ndryshme, të mëvonshme nga intervista formale, të bëjnë kërkesa për ndjekje penale/deklarime në polici e prokurori
5. Të ofrojmë mbështetje për përgatitjen
6. Të peshojmë me kujdes përfshirjen e viktimave në mbledhjen e provave për të shmangur cdo lloj efekti negativ mbi viktimën dhe mbi procesin vetë. Jo rrallë ka situata në të cilat policia apo prokuroria kërkon nga viktimat që të lehtësojnë apo ndihmojnë kapjen “në flagrancë” të dhunuesit apo trafikantit. Në raste më të rralla por përsëri ekzistente, fëmija është lënë pa ndërhyrje për efekt “mbledhjen e provave”. Në një pjesë të madhe të rasteve ka mosmarrëveshje mes atyre që autoritetet e zbatimit të ligjit i konsiderojnë si “prova”
7. Të informojmë vikimat mbi hapat e bashkëpunimit

Më poshtë jepet një skemë e thjeshtë për të shpjeguar bashkëpunimin



7 NDËRGJEGJËSIMI

dhe modelet e veprimeve për parandalimin e dhunës dhe trafikimit

Konventa e Stambollit dikton realizimin rregullisht dhe në të gjitha nivelet, të fushatave ose programeve të rritjes së ndërgjegjësimit, duke përfshirë ato në bashkëpunim me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet e barazisë, shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, sipas rastit, për të rritur ndërgjegjësimin dhe perceptimin nga publiku i gjerë, në lidhje me manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës pasojat e tyre për fëmijët dhe nevojën për të parandaluar një dhunë të tillë.

7.1 - AKTIVITETET E SENSIBILIZIMIT KUNDËR TRAFIKIMIT DHE DHUNËS

Disa nga aktivitetet e sensibilizimit për trafikimin janë: Java ose Muaji Antitrafik, Grupet vigjilente në komunitet, Kutia UN Gift Box, Teatri interaktiv, Ekspozitat ndërgjegjësuere nga fëmijët, si dhe nga vetë viktimat.

Disa nga aktivitetet e sensibilizimit për trafikimin janë: 16 Ditët e aktivizmit kundër Dhunës ndaj Gruas: 25 nëntor-10 dhjetor - Dita ndërkombëtare e dhunës ndaj gruas: 25 nëntor - Dita Ndërkombëtare e Gruas, Fushata e UN "Ai për atë".

Fushata "Unë Mbroj fëmijët" është një fushatë mbarëkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi dhe trafikimi.

7.2 - METODAT E SENSIBILIZIMIT

Metodat efektive të përdorura për sensibilizimin janë: takimet me gra dhe vajza në qendrat shëndetsore, në ambientet e shkollave, aktivizmi i rrugës, performanca artistike, marshime paqësore, pantonimë, teatër social në rrugë, grafite në mure, prodhimi dhe shpërndarja e materialeve informative broshura, fletëpalosje, programet në radio, konkurset janë disa nga

7.3 - ÇFARË DUHET TË DIMË dhe SI DUHET TË PËRGATITEMI PËR SENSIBILIZIMIN

Në rekomandimet lidhur me **Planet Kombëtare të veprimit kundër dhunës ndaj grave**, UN Women përfshin rekomandime për mbështetje të fushatave sitematike ndërgjegjësuere që adresojnë shkaktarët e dhunës në familje e që shtrihet në të gjitha zonat e vendit duke përfshirë fushata specifike të dizenuara për të rritur njohuritë mbi ligjin dhe mbështetjen që ai jep, shërbimet për viktimat/ të mbijetuarit si edhe fushata të "ndryshimit të qëndrimeve" - që promovojnë tipare pozitive, sjelljen me respekt dhe pa dhunë të meshkujve, që sfidojnë stereotipet gjinore që ndërgjegjësojnë për papranueshmërinë e dhunës ndaj grave dhe sensibilizojnë për dhunën si manifestim i pabarazisë dhe shkelje e të drejtave të njeriut.

Për të identifikuar praktikat e mira të fushatave të ndërgjegjësimit mbi dhunë në familje, një studim i bërë në shtetet evropiane dhe Kroaci, përdori kriteret e:

a) Fushata është e mbështetur në evidenca- shifra e fakte; b) fushata ka një strategji të vetën; c) fushata ka një strategji të fortë komunikimi; d) jepen numra kontakti për të mbijetuarit; e) promovohet lidhshipi nga gratë; f) mobilizohet komuniteti; g) ka qasje ndërsektorale; h) ka qasje ndërnivelo

a) Të sigurojmë kushte për qasje të personave në nevojë urgjente për ndihmë

Në takime me grupe grash apo të rinjsh në komunitet shanset janë më të mëdha që individët që kanë nevojë të afrohen tek lehtësuesi dhe të kërkojnë ndihmë.

b) Të studiojmë paraprakisht ambientin

Për performanca apo aktivitete në rrugë p.sh., studimi i ambientit ka të bëjë me frekuentimin e pjesës së rrugës, grupet që frekuentojnë etj.

c) Të mbledhim paraprakisht informacion se çfarë di komuniteti mbi temën

Në rastin e trafikimit për shembull, komuniteti mund të dijë për trafikimin me qëllim shfrytëzimin seksual, por nuk di për trafikimin me qëllim shfrytëzimin e punës.

ç) Të testojmë mesazhet që duhet të japim

Është e rëndësishme që nëse prodhojmë materiale informative, ta testojmë përmbajtjen në grupe të vogla përpara se ta shpërndajmë në një masë të gjerë.

d) Të identifikojmë “kanalin e transmetimit”

Përpara se të dizenjojmë aktivitetet duhet të identifikojmë se nëpërmjet kujt do ta japim mesazhin- kë dëgjon më shumë grupi ynë i synuar. Nëse fëmijët dëgjojnë më shumë nënat, atëherë janë nënat ato që duhet të influencojmë.

dh) Të përgatisim median që na përcjell

Me median lokale mund të zhvillohen marrëdhënie të mira bashkëpunimi që sigurojnë mbulimin korrekt të fushatave të ndërgjegjësimit apo të aktiviteteve. Këto marrëdhënie duhet të përfshijnë kontributin e ofruesve të shërbimit për të trejuar median, për të kontribuar në zhvillimin e kodeve etike të ndjeshme, për të dhënë opinion për reportazhet artikujt, për të dhënë çmime për mbulimet korrekte, për t’ju përgjigjur në kohë dhe në mënyrë korrekte kërkesave të medias për informacion të dorës së parë, intervista me autoritete.

7.4 - ÇFARË DUHET TË BËJMË**a) Të vemë në fokus mënyrën të menduarit dhe qëndrimin që ushqejnë dhunën**

Sensibilizimi duhet të fillojë me ata apo ato që influencojnë të rinjtë, nënat, baballarët, mësuesit. Një nga format e gjetura efektive është ndërgjegjësimi i tyre që të mos përdorin shprehje si “kush të rreh të do”, “kështu janë djemtë”, shprehje që zakonisht thuhet pa qëllim të keq por që janë të rëndësishme në formimin e qëndrimit të një të riu ndaj një gruaje.

b) Të ndërgjegjësojmë për të ndihmuar

Mesazhet sensibilizuese nuk duhet t’i drejtohen vetëm viktimave për të gjetur kurajon e mundësinë për të kërkuar ndihmë. Ato duhet t’i drejtohen komunitetit, personave që janë rreth e rrotull viktimës duke i mësuar ata se si duhet t’i vijin në ndihmë një viktime, pa e dëmtuar atë dhe veten.

c) Të sigurojmë një të kuptuar të mirë që dhuna në familje dhe trafikimi është krim dhe të adresojmë qëndrimet që fajësojnë viktimën

Trajtimi i dhunës në familje si diçka më pak është një riviktimizim- viktimizim edhe një herë i viktimave. Fushatat apo aktivitetet e ndërgjegjësimit duhet t’i kushtojnë vëmendje të vecantë adresimit të qëndrimeve sjelljeve dhe praktikave që fajësojnë viktimat. Për specialistët e mbrojtjes së viktimave dhënia e këshillave për gratë se si të mënjanojnë sulmet seksuale është një formë e fajësimit të viktimës.

ç) Të sensibilizojmë për efektet e “dëshmimit” të dhunës

Aktivitetet e informimit dhe të ndërgjegjësimit duhet të përfshijnë informimin e publikut për efektet e “dëshmimit të dhunës”. Fëmijët janë “viktimat e harruara” ata përveçse dëgjojnë shohin duhet të merren edhe me pasojat e dhunës, të kurojnë prindin të marrin policinë në telefon, të tregojnë historitë etj. Këto eksperiencat dhe efekte duhet të bëhen pjesë e ndërgjegjësimit.

d) Të vlerësojmë veprimet tona në raport me median nga perspektiva e të drejtave të viktimave sidomos nga perspektiva e së drejtës për siguri, konfidencialitetin, privatësinë dhe të evitojmë riviktimizimin

Ndërsa punonjësit e medias dhe ne vetë mund të bien dakord në parim që viktimat kanë të drejtë për privatësi, ka ndodhur që ky parim është shkelur. Në emër të sensibilizimit apo të së drejtës së publikut për tu informuar ky parim është shkelur dhe viktimat janë viktimizuar për herë të dytë. Është e rëndësishme që viktimat të njohin të drejtat e tyre dhe sidomos të drejtën: për t’i thënë jo një interviste; për të zgjedhur kohën dhe vendin e një interviste; për të zgjedhur një raportues/gazetar specifik, ose për t’i thënë jo një gazetari specifik kur ka pranuar t’i japë intervista gazetarëve të tjerë, të lëshojë një deklaratë për shtyp në vend të një interviste; të përhashtojë fëmijët nga intervistimi; të mos u përgjigjet pyetjeve që e bëjnë të mos ndihet rehat apo atyre që i quan të papërshtatshme; të kërkojë korrigjime kur ajo që është raportuar është e pasaktë; të zhvillojë një intervistë me siluetë; të japë në mënyrë të plotë versionin e saj/tij të historisë.

Për më shumë shih:

- UN Women, (2012) Handbook on the National Action Plans on Violence Against Women, <http://www.un.org/womenwatch/daw/vaw/handbook-for-nap-on-vaw.pdf>
- Dottridge, M. (2006), Action to prevent child trafficking in South Eastern Europe,
- <http://www.abc.net.au/news/2016-04-20/dv-campaign-to-focus-on-influencers/7340120>
- Council of Europe (2007), Protecting women against violence, Analytical study, https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolence-campaign/Source/EN_CDEG_2007_3_complete.pdf

MONITORIMI

i kompetencave dhe veprimet në luftën kundër dhunës dhe trafikimit

8.1 - INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE TË MATJES SË KAPACITETEVE DHE VEPRIMEVE NË MBROJTJE TË GRAVE DHE FËMIJËVE

a) Ndërkombëtare

- Komiteti për të Drejtat e Njeriut (CCPR)- monitoron zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 dhe të protokolleve të saj opsionalë
- Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)- monitoron zbatimin e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të 1979 dhe protokollit të saj opsional të 1999
- Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (CRC)- monitoron zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe protokolleve të saj
- Komiteti i Lanzarotes- Monitoron në mënyrë sistematike zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shëndrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual
- Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale- monitoron nëse ligji dhe praktika e vendeve anëtare është konform Kartës Sociale Evropiane në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Shumë prej të drejtave lidhen ekskluzivisht me fëmijët
- Grupi i Ekspertëve për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA)- monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
- Grupi i ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Gruas dhe dhunës në familje (GREVIO)- monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventës së Stambollit)

b) Kombëtare

- Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës- vlerëson dhe analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës
- Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës¹
- Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror²
- Komiteti drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje³ - vlerëson punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, mbështetur në informacionet dhe raportet periodike të paraqitur nga ekipi për cdo rast dhe merr vendime për përmirësimin e funksionimit të tij.

8.2 - DIMENSIONET E MATJES/MONITORIMIT

Sipas Udhëzimit të MPÇSSHB nr.1220, datë 27.5.2010⁴, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si edhe institucionet e tjera në varësi të saj mbledh treguesit e përpunuar, të listuar si më poshtë, si pjesë e detyrimeve që janë aktualisht në fuqi. Formulari i përdorur për këtë qëllim përfshin dimensionin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë të cilat sigurojnë barazinë gjinore, dimensionin e fuqizimit ekonomik të grave dhe mundësitë e tyre në rritje për punësim dhe trajnimet profesionale, si edhe dimensionin e eliminimit të dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje. Në lidhje me eliminimin e dhunës, treguesit përfshijnë: numrin e bashkive që kanë marrëveshje të nënshkruara me aktorët vendorë për t'iu përgjigjur, ndihmuar dhe monitoruar rastet e dhunës në familje në rajonet e tyre, numrin e bashkive me sistem të ngritur të monitorimit të përhapjes së dhunës në familje, numrin e strukturave/njësive në nivel vendor dhe kombëtar që merren me eliminimin e dhunës në familje, sipas llojit të organizmit (polici, gjyqësor, shëndetësi, arsim, mbrojtje sociale, etj.), numrin e gjyqtarëve të përfshirë në kurse të vazhdueshme trajnimi për ligjin kundër dhunës në familje dhe për barazinë gjinore në Shkollën e Magjistraturës, numrin e qendrave (private dhe publike) që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, sipas burimit të ndihmës, numrin e shtretërve/vendeve që ekzistojnë në qendrat që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës në familje sipas 12 qarqeve, numrin e qendrave

¹ Ligji për të drejta dhe Mbrojtjen e fëmijës

² Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror

³ VKM 334

⁴ Fletore Zyrtare Nr. 78, 2 korrik 2010,

që ofrojnë shërbime sociale dhe rehabilitime për viktimat e dhunës në familje, si edhe për ushtruesit e dhunës sipas 12 qarqeve dhe numrin e OJF-ve që punojnë për eliminimin e dhunës në familje sipas 12 qarqeve. Në mars 2016, Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje⁵ (GREVIO) nxori për përdorim “Pyetësonin për masa legjislative dhe masa të tjera në zbatim të Konventës së Këshilit të Evropës për parandalimin dhe Luftën kundër dhunës ndaj Gruas⁶ dhe dhunës në Familje⁷, e detyrueshme për tu përdorur si bazë nga shtete anëtare për përgatitjen e raporteve për zbatimin e Konventës⁸. Dimensionet e monitorimit/referencës janë nenet e Konventës lidhur me politikat e integruara dhe mbledhjen e të dhënave, parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen, hetimin dhe dënimin, migrimin dhe azilin.⁹

8.3 - MATJA E NJOHURIVE TË SHËRBIM OFRUESVE

Sipas Nenit 15 “Periodiciteti i Vlerësimit” i urdhërit të ministrit për vlerësimin, vlerësimi¹⁰ i njohurive dhe i aftësive praktike për të gjithë personelin e drejtpërdrejtë në shërbimin social, që ushtrojnë profesionin e tyre në institucionet e përkujdesit social publik, kryhet çdo 2 vjet.

⁵ Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence

⁶ Gratë, përfshirë vajzat nën 18 vjeç . Të gjitha format e dënueshmë të dhunës ndaj gruas : dhunën psikologjike, sharjen , dhunën fizike dhunën seksuale përfshirë përdhunimin, martesën e detyruar, gjymtimin gjenital femeror , abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar dhe ngacmimet

⁷ Dhunën fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike ë ndodh brenda familjes ose njësisë familjare ose midis ish bashkëshortëve, bashkëshortëve ose partnerëve pavarësisht nëse dhunuesi ndan ose jo banesën me viktimën

⁸ <https://rm.coe.int/16805c95b0>

⁹ <https://rm.coe.int/16805c95b0>

¹⁰ Urdhwr Nr. 238, datë 4.9.2015 “ Pwr miratimin e rregullorws pwr vlerwsimin e njohurive dhe aftwsive praktike tw personelit nw institucio net e pwrkujdesit social publik” , Fletore Zyrtare Nr. 162, Viti 2015, http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/162-2015.pdf

LEGJISLACIONIN

mbi decentralizimin, shërbimet sociale, mbrojtjen e të miturve,
dhuna në familje



Tirane - Janar 2018

PERMBLEDJE

Pg. 1 *LIGJ Nr. 139/2015*
“Per vetëqeverisjen vendore”

LIGJ Nr. 121/2016 **Pg.20**
“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë”

Pg.32 *LIGJ Nr. 9669/2006*
“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

VKM Nr. 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” **Pg.39**

Pg.42 Pjesë nga *LIGJ Nr. 23/2012*
“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895/1995, Kodi penali republikës së shqipërisë”

LIGJ Nr. 18/2017 **Pg.43**
“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

LIGJ
Nr. 139/2015
“PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrimi” është e drejta për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e një funksioni.
2. “Autonomi vendore” është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.
3. “Funksion” është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.
4. “Funksione të deleguara” janë ato funksione të qeverisë qendrore, ushtrimi i të cilave u delegohet njësive të vetëqeverisjes vendore.
5. “Kompetencë” është autoriteti i dhënë me ligj një organi të njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e një funksioni apo një pjese të tij.
6. “Konsultimi” është proces institucional këshillimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin e shkëmbimin e opinioneve për politikën, legjisllacionin e normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.
7. “Ndërmarrje për shërbime publike” është çdo ndërmarrje e krijuar për të ofruar shërbim/shërbime publik/e që janë kompetencë e bashkisë, për të cilën kapitali, vota ose e drejta për të emëruar organet drejtuese dhe financimi kontrollohen nga bashkia.
8. “Qeverisje qendrore” është Këshilli i Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të shtetit.
9. “Rregullimi” është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të

detyrueshme në përputhje me ligjin.

10. “Riorganizim administrativo-territorial” është ndryshimi në ndarjen administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. “Subjekt i kompetencave të përbashkëta” është një komitet, ent, institucion, ndërmarrje ose bord, shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përm-bushjen e një detyrimi të përbashkët.

12. “Subsidiaritet” është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomisë.

13. “Shërbime publike” janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Neni 3

Misioni i vetëqeverisjes vendore

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Neni 4

Parimet themelore të vetëqeverisjes vendore

1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore.
2. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë persona juridikë publikë.
4. Çdo bashki dhe qark është njësi vetëqeverisëse me vazhdimësi.

KREU II NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE DHE ORGANET

Neni 5

Njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.
2. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore.
3. Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh. Bashkitë, shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj përcaktohen me ligj.
4. Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore.
5. Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj.

Neni 6

Nënndarjet e bashkisë

1. Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj.
2. Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj. Shpallja e qyteteve të reja bëhet me ligj.
3. Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Një lagje, si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë. Ndarja e qyteteve në lagje dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

Neni 7

Organet e njërive të vetëqeverisjes vendore

1. Në çdo bashki dhe qark krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv.
2. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë.
3. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Funkcionet ekzekutive në qark kryhen nga kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut.
4. Organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë zgjidhen në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
5. Organi përfaqësues i qarkut krijohet me përfaqësues nga organet e zgjedhura të bashkive që e përbëjnë atë, sipas mënyrës së përcaktuar në Kushtetutë dhe në kreun XIII të këtij ligji. Kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshilli i qarkut, sipas mënyrës së përcaktuar në kreun XIII, të këtij ligji.

KREU III TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 8

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor

1. Organet e njërive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.
2. Organet e njërive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhërave dhe urdhrave.

Neni 9

Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - 1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës:
 - a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;
 - b) bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra;
 - c) krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi;
 - ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre.
 - d) krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.
 - 1.2. Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:
 - a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - b) e drejta e fitimit të pronës, nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.
 - 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
 - a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
 - b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
 - ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.
 - 1.4. Të drejtën dhe përgjegjësinë e kryerjes së veprimtarive ekonomike, sipas së cilës:
 - a) për përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqësojnë, në përputhje me legjislacionin

në fuqi, ushtrojnë veprimtari ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit;

b) të ardhurat, që përfitohen nga veprimtaria ekonomike, përdoren në pjesën më të madhe për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve publike;

c) veprimtaria ekonomike e njësive të vetëqeverisjes vendore rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.5. Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës:

a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë;

b) bashkëpunojnë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;

c) kanë të drejtë të organizohen në shoqata, në përputhje me legjislacionin përkatës.

1.6. Të drejtën e personit juridik:

Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë:

a) të drejtën e lidhjes së kontratës;

b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;

c) të drejtën e ngritjes së padisë civile; ç) të drejtën e mbajtjes së llogarive;

d) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore.

1.7. Të drejta të tjera, sipas të cilave:

a) japin tituj nderi dhe stimuj;

b) vendosin emërtimet e territoreve, objekteve dhe institucioneve nën juridiksionin e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj;

c) njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë vulën dhe simbolet e tyre.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e sipërpërmendura ushtrohen nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi.

KREU IV

MARRËDHËNIET MIDIS QEVERISJES QENDRORE DHE NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 10

Marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore

Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Neni 11

Komunikimi dhe informimi Organet e njësive të vetëqeveris-

jes vendore, për fushën e tyre të përgjegjësisë, informojnë me shkrim organet e qeverisjes qendrore për çdo çështje që u kërkohet informacion. Organet e qeverisjes qendrore, kur kërkohet nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, japin informacion, sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 12

Konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësive.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.

3. Struktura, procedura, forma, mënyra e organizimit dhe funksionimit dhe natyra e çështjeve për konsultim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare, të përcaktuara në legjislacionin përkatës, ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë, monitorojnë veprimtarinë e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për funksionet e deleguara kanë të drejtë t'i mbikëqyrin ato.

2. Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe inspektimit financiar për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen kontrollit të jashtëm financiar nga organet e qeverisjes qendrore për përdorimin e fondeve të kushtëzuara dhe/ose të deleguara që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe/ose fondet e ndihmës së huaj, të alokuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga qeverisja qendrore.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

BASHKËPUNIMI MES NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 14

Bashkëpunimi mes dy apo më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve specifike në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë një-

si të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë.

2. Në çdo marrëveshje të bashkëpunimit ndërvendor përcaktohen:

a) qëllimi i marrëveshjes;

b) funksionet që do të ushtrohen nga secila bashki apo në mënyrë të përbashkët;

c) mënyra me anë të së cilës do të plotësohet qëllimi;

ç) shkalla dhe kohëzgjatja e delegimit të kompetencave;

d) mënyra dhe masa e kontributit financiar përkatës dhe e ndarjes së të ardhurave e të përfitimeve të tjera.

3. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërvendor miratohet nga këshillat përkatës të secilës prej njësive të vetëqeverisjes vendore që janë palë në marrëveshje. Detyrimi financiar për secilën prej njësive të vetëqeverisjes vendore, palë të marrëveshjes, miratohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin vendor.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor me njësi të vetëqeverisjes vendore të shteteve huaja. Përpara lidhjes së këtyre marrëveshjeve, njësitë marrin mendimin e Ministrisë Punëve të Jashtme.

5. Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

6. Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, subjekti i kompetencave të përbashkëta njofton zyrtarisht prefektin.

7. Në njoftimin zyrtar përcaktohen:

a) emërtimi i njësive të vetëqeverisjes vendore, palë në marrëveshje;

b) data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;

c) qëllimi i marrëveshjes dhe funksioni që do të ushtrohet;

ç) vendimet e bashkive të përfshira në marrëveshje në lidhje me të; d) kontributi i palëve në këtë marrëveshje.

8. Marrëveshja bëhet e zbatueshme pas shprehjes së ligjshmërisë nga prefekti brenda afateve të përcaktuara me ligj.

KREU VI

TRANSPARENCA, KONSULTIMI DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Neni 15

Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 16

Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendim-marrjes.

2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 17

Mbledhjet e këshillit të bashkisë

1. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

Neni 18

Seancat e këshillimeve me bashkësinë

1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat "a", "dh", "e", "f" dhe "k", dhe 77, shkronjat "a", "dh", "e", "f" dhe "k", të këtij ligji.

2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Neni 19*E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes*

1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 20*E drejta e iniciativës qytetare*

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.
2. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

KREU VII**FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE****Neni 21***Llojet e funksioneve*

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara.
2. Funksionet u njihen njësisë të vetëqeverisjes vendore me këtë ligj. Funksione apo kompetenca të tjera mund t'u njihen një, disa apo të gjitha njësisë të vetëqeverisjes vendore vetëm në bazë të ligjit.
3. Funksionet e deleguara u transferohen njësisë të vetëqeverisjes vendore me ligj ose me marrëveshje. Në çdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferta e mjaftueshme e qeverisjes qendrore për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve.

Neni 22*Parimet për ushtrimin e funksioneve*

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde e norma specifike të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave kombëtarë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.
3. Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e

standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore administrojnë ushtrimin e funksioneve të deleguara, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e deleguara, qeverisja qendrore siguron mjete dhe burime financiare të mjaftueshme për të ushtruar këto funksione në mënyrën dhe në atë nivel ose standard, i cili është përcaktuar me ligj.

Neni 23*Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike*

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.
4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
5. Ndrichimin e mjediseve publike.
6. Transportin publik vendor.
7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
8. Shërbimin e dekorit publik.
9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 24*Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale*
Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunura, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 25

Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
3. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.
4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Neni 26

Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Neni 27

Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.
5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.
2. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.
3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.
4. Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
5. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.
6. Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Neni 29

Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike

Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.
4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Neni 30

Funksionet dhe kompetencat e deleguara

1. Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme.
2. Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë ato të përcaktuara me ligj.
3. Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë bashkinë ose qarkun të kryejnë funksione të caktuara, duke përcaktuar, kur është e nevojshme, procedurat e kryerjes e të kontrollit për zbatimin e tyre.
4. Institucionet qendrore mund të autorizojnë bashkinë dhe/ose qarkun të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar.
5. Bashkisë ose qarkut mund t'u delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për

këtë funksion ose kompetencë.

6. Në çdo rast qeverisja qendrore u garanton njësive të vetëqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

7. Bashkia ose qarku, me nismën e tyre, mund të përdorin burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të deleguara, me synim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të bashkësisë.

Neni 31

Funksionet e qarkut

1. Funksionet e qarkut janë ndërtimi e zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj.

2. Qarku ushtron të gjitha funksionet që i delegohen nga një ose më shumë bashki, brenda territorit të qarkut, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve.

3. Qarku kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror, sipas parimeve të parashikuara në nenin 22 të këtij ligji.

Neni 32

Administrimi i shërbimeve publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike, në përputhje me funksionet e caktuara me ligj, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballeshme nga të gjithë.

2. Mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimeve publike, kur nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 33

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

a) njësive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore; b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;

c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta; ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;

d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, njësia vendore do të jetë përgjegjëse për:

a) hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare;

b) hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës;

c) krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor.

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.

KREU VIII

FINANCAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 34

Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.

2. Funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.

4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

5. Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësi për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera.

6. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Neni 35

Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore

1. Bashkitë krijojnë të ardhura nga:

a) taksat vendore mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;

b) taksat vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;

c) taksat vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;

ç) taksat vendore mbi të ardhurat vetjake, të krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;

d) të ardhura nga donacionet dhe dhuratat;

dh) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; e) taksa të tjera të përcaktuara me ligj.

2. Bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen

e administrimit të tyre brenda kufijve të sipas kritereve të përcaktuara në ligjin përkatës.

3. Bashkitë kanë të drejtë të përjashtojnë nga pagimi i taksës kategori të caktuara apo grupe në nevojë, në përputhje me ligjin përkatës.

4. Baza e taksave vendore, si dhe kufijtë maksimalë dhe/ose minimalë të tyre vendosen me ligj të veçantë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të zbatojnë ose jo një taksë vendore. Kur këto njësi zbatojnë taksën vendore, ato ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të tyre, mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të tyre, sipas kritereve dhe kufijve të përcaktuar në legjislacionin përkatës.

5. Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për:

- a) shërbimet publike që ato ofrojnë;
- b) të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;
- c) dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;
- ç) çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara me ligj.

Neni 36

Të ardhurat nga burime të tjera të bashkive

1. Të ardhurat nga burime të tjera të bashkive janë:

- a) të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë;
- b) të ardhurat nga investimet mbi kapitalet;
- c) të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia; ç) të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi;
- d) të ardhurat nga partneritetet privat-publik.

2. Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet.

3. Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Neni 37

Të ardhurat që rrjedhin nga burimet kombëtare

1. Bashkitë krijojnë të ardhurat nga burimet kombëtare:

a) Taksat dhe tatimet e ndara, në të cilat përfshihen një pjesë e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin dhe taksave të tjera mbi pasuritë kombëtare. Të ardhurat nga këto taksa e tatime u jepen bashkive rregullisht në jo më pak se katër transfertat në vit. Pjesa e taksës dhe tatimit që shkon në favor të tyre, si dhe mbledhja e administrimit përcaktohen me ligj për çdo taksë ose tatim të ndarë.

b) Transferta e pakushtëzuar nga qeverisja qendrore të njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e funksioneve të veta, si dhe për arritjen e barazisë së shpërndarjes së burimeve financiare mes njësitë të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar caktohet si përqindje fikse kundrejt të ardhurave të qëndrueshme publike, sipas përcaktimit në ligjin që rregullon financat vendore, si dhe shpërndahet sipas formulës së përcaktuar me ligj.

c) Transferta e kushtëzuar nga qeverisja qendrore do

të bazohen në kritere objektive dhe renditjen prioritare të nevojave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, kushtet ekonomike, kërkesat e infrastrukturës, si dhe në strategjitë e zhvillimit në nivel kombëtar e rajonal.

2. Qeverisja qendrore, në periudhën e hartimit të projektbuxhetit të shtetit, është e detyruar të konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet instrumenteve të përcaktuara të konsultimit, duke analizuar mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e burimeve financiare të njësitë të vetëqeverisjes vendore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 38

Burimet e financimit të qarkut

1. Qarku krijon të ardhura nga burimet e veta vendore dhe të ardhura që rrjedhin nga burime kombëtare.

2. Të ardhurat nga burimet e veta vendore dhe kombëtare përbëhen nga:

- a) transfertat e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit;
- b) transfertat e kushtëzuar për kryerjen e funksioneve e të kompetencave të deleguara përkatëse nga bashkitë përbërëse;
- c) taksa të vendosura në nivel qarku, të përcaktuara në përputhje me ligjin;
- ç) tarifat për shërbimet publike të kryera nga qarku.

3. Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak.

4. Kriteret dhe normat për krijimin dhe administrimin e të ardhurave nga burimet e veta vendore janë të ngjashme me ato të përcaktuara për të ardhurat nga burimet vendore të bashkive.

5. Të ardhurat e qarkut nga ndarja e të ardhurave kombëtare krijohen dhe administrohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj dhe në ligje të tjera në fuqi.

Neni 39

Huamarrja vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin hua, në përputhje me legjislacionin që rregullon menaxhimin e sistemit buxhetor, huamarrjen vendore dhe financat vendore.

2. Në kufirin vjetor të huamarrjes, miratuar me ligjin vjetor të buxhetit, një përqindje e caktuar i rezervohet njësitë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me politikën dhe disiplinën fiskale të ndjekur nga qeverisja qendrore. Aksesi në tregun e borxhit të jashtëm rregullohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe entitete të tjera, të përcaktuara me ligj.

3. Çdo rregullim apo kufizim i vendosur nga qeverisja qendrore në huamarrjen e vetëqeverisjes vendore, që kufizon mundësinë e njësitë të vetëqeverisjes vendore për të marrë hua, duhet të jenë të përkohshëm dhe të mos shtrihen përtej vitit fiskal në të cilin janë vendosur, përveç rasteve kur këto masa miratohen nga Kuvendi.

Neni 40*Shpenzimet*

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare. Të ardhurat e veta të njësisë të vetëqeverisjes vendore, që nuk janë shpenzuar brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal.
2. Në kushtet e mungesës së buxhetit të miratuar nga këshilli, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr përkohësisht kompetencat e këshillit dhe autorizon kryerjen e shpenzimeve mujore deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës.
3. Kryetari i bashkisë ose personat e autorizuar prej tij nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve, të përcaktuar në zërin përkatës në buxhetin vjetor. Nuk lejohen shpenzime të fondeve nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla.
4. Pas miratimit zyrtar të buxhetit, kryetari i bashkisë mund të autorizojë ose të kërkojë autorizimin e këshillit për rishpërndarjen e fondeve nga një zë shpenzimesh në një tjetër, brenda dhe midis programeve të ndryshme buxhetore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë menaxhimin e sistemit buxhetor dhe financat vendore.
5. Pavarësisht nga dispozitat e këtij ligji, asnjë transfertë e kushtëzuar, e dhënë nga qeverisja qendrore, nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në grantin apo transfertën përkatëse.
6. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Neni 41*Buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm*

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore.
2. Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:
 - a) parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh, përfshirë shlyerjen e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
 - b) të gjitha transfertat e kushtëzuara, të parashikuara për t'u marrë nga qeverisja qendrore dhe të cilat hyjnë në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe që përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë, në përputhje me rregullat e caktuara nga qeverisja qendrore për përdorimin e tyre;
 - c) të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për t'u siguruar në mënyrë të drejtëpërdrejtë prej vetë bashkisë nga çfarëdolloj burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore,

tarifat, vlerësimet, gjobat, grantet nga burime të niveleve të tjera të qeverisjes;

ç) parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse; parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja me informacionin e mëposhtëm:

- i) qëllimin e investimit;
- ii) planin e financimit, përfshirë mënyrat dhe burimet e financimit;
- iii) shpenzimet vjetore që duhen për shlyerjen e kredisë, nëse përdoret, si dhe një preventiv të shpenzimeve operative që lindin si pasojë e kryerjes së investimit;
- d) objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Neni 42*Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare*

1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjëse për arkivimin, ruajtjen e administrimin e dokumenteve financiare dhe për dëmtimin ose humbjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat.

Neni 43*Kontrolli i jashtëm dhe auditimi*

1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohet kontrollit të jashtëm nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është subjekt i auditimit të brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo raport i kontrollit të jashtëm apo auditimit të brendshëm mbi funksionimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore duhet të vihet në dispozicion të publikut, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Me vendim të veçantë të këshillit bashkiak ose të këshillit të qarkut, organet ekzekutive të njësisë të vetëqeverisjes vendore mund t'i nënshtrohen auditimit të kryer nga shoqëri të specializuara në fushën e auditimit.

Neni 44*Raporti vjetor*

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

KREU IX**PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT BASHKIAK****Neni 45***Mënyra e zgjedhjes*

Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, si-

pas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 46

Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak

1. Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:

- Bashkitë deri në 20 000 banorë 15 anëtarë;
- Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë 21 anëtarë;
- Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë 31 anëtarë;
- Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë;
- Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë 51 anëtarë;
- Bashkitë mbi 400 000 banorë 61 anëtarë.

2. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet vendore.

Neni 47

Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit

1. Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:

- a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë;
- b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;
- c) funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
- ç) funksionin e deputetit;
- d) funksionin e ministrit.

2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak.

3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin.

Neni 48

Mbledhja e parë e këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga data e shpalljes së rezultetit nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

2. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti.

3. Në rast se asnjë nga subjektet e sipërpërmendura nuk e ushtron këtë të drejtë, brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë këshilli mblidhet vetë brenda 10 ditëve.

4. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, të shpallur nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Nëse nuk mblidhen më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të këshillit, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret çdo tri ditë, por jo më shumë se tri herë. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrjeje nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, këshilli konsiderohet i shpërndarë.

5. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë.

6. Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak:

- a) zgjidhet komisioni i mandateve;
- b) miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
- c) këshilltarët bëjnë betimin;
- ç) zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit;
- d) zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen me mandatin e përfaqësimit.

7. Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 49

Mandati i këshilltarit

1. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak.

2. Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

3. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.

4. Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:

- a) ndryshon vendbanimin jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur;
- b) jep dorëheqjen;
- c) krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji; ç) mandati, nga ana e tij, është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
- d) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjyqate;
- dh) vdes;

e) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;

ë) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqate të formës së prerë; f) këshilli shpërndahet nga organi kompetent.

5. Mbarimi i mandatit para kohe deklarohet me vendim të këshillit bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve.

Neni 50

Betimi

1. Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, këshilltarët bëjnë këtë betim para këshillit:

“Betohe me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë (emri i bashkisë përkatëse) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

2. Këshilltari që mungon me arsye në bërjen e betimit btohet në mbledhjen më të parë që merr pjesë. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.

Neni 51

Të drejtat e këshilltarit

1. Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të bashkisë përkatëse.

2. Punëdhënësi detyrohet të lejojë anëtarin e këshillit bashkiak të shkëputet nga puna për të marrë pjesë në

mbledhjet e këshillit bashkiak, komisioneve të tij apo aktivitete të organizuara prej këshillit bashkiak.

3. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga kryetari i bashkisë përkatëse, çdo dokumentacion i lidhur me bashkinë.

4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislationit në fuqi.

Neni 52

Kushtet e pengesës ligjore, vetëdeklarimi dhe përjashtimi

1. Anëtari i këshillit bashkiak nuk përfshihet në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse në rastet kur:

a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

c) ai ose edhe personat e parashikuar në shkronjën "b", të kësaj pike, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektive të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;

ç) ai ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;

d) personat e përmendur në shkronjën "b", të kësaj pike, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim;

dh) ai ose personat e përmendur në shkronjën "b", të kësaj pike, janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në çështjen në shqyrtim;

e) ai ose personat e përmendur në shkronjën "b", të kësaj pike, kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës së shqyrtimit;

ë) ai ose personat e përmendur në shkronjën "b", të kësaj pike, kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen, sipas rrethanave konkrete, se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën në shqyrtim;

f) në çdo rast parashikohet nga legjislationi në fuqi;

g) ai ose personat e përmendur në shkronjën "b", të kësaj pike, janë përfshirë në çdo lloj mënyre në negocime të mundshme për punësim në të ardhmen të tij apo të personave të përmendur në shkronjën "b", të kësaj pike, gjatë ushtrimit të funksionit apo në negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Nëse anëtari i këshillit bashkiak vëren një nga pengesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ai njofton menjëherë me shkrim kryetarin e këshillit bashkiak.

3. Persona të tretë mund të kërkojnë përjashtimin e pjesëmarrjes së një anëtari të këshillit bashkiak nga një procedurë, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga shqyrtimi dhe vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet kryetarit të këshillit bashkiak dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

4. Kryetari i këshillit bashkiak, i njoftuar sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, i propozon këshillit bashkiak përjashtimin ose konfirmimin e anëtarit të këshillit bashkiak nga/në procedura vendimmarrëse.

Neni 53

Funksionimi i këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, sipas nenit 48, të këtij ligji, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

2. Mbledhjet e radhës së këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.

3. Këshilli mbledhet në çdo rast:

a) me kërkesën e kryetarit të bashkisë;

b) me kërkesën me shkrim të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij;

c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

4. Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.

5. Rendi i ditës miratohet nga këshilli.

6. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm bashkiak ushtron kompetenca të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.

7. Mbledhja e këshillit bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 55 të këtij ligji.

8. Mbledhjet e këshillit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij përcaktohen sipas legjislationit në fuqi.

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;

b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;

c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;

ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislationin në fuqi;

d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;

dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;

f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislationit tjetër në fuqi;

g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;

- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;
- l) vendos për simbolet e bashkisë;
- ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
- m) jep tituj nderi dhe stimuj;
- n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.

Neni 55 *Votimi*

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.
3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "i" dhe "j", të nenit 54, të këtij ligji.
4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën "e", të nenit 54, të këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.
6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 56 *Kryetari i këshillit bashkiak*

1. Kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit bashkiak zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit.

2. Kryetari i këshillit kryen këto detyra:
 - a) thërret mbledhjen e këshillit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji;
 - b) drejton mbledhjet e këshillit, në përputhje me rregulloren e tij;
 - c) nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;
 - ç) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloren e këshillit.
3. Në mungesë të kryetarit të këshillit, detyrat e tij i kryen zëvendëskryetari, sipas përcaktimit në rregulloren e brendshme të këshillit.

Neni 57

Sekretari i këshillit bashkiak

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.
2. Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës për:
 - a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
 - b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës;
 - c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
 - ç) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak;
 - d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
 - dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.
3. Sekretari i këshillit bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

Neni 58

Shpërndarja e parakohshme e këshillit bashkiak

1. Kur këshilli bashkiak nuk mbledhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore nga mbledhja e fundit e tij, prefekti thërret mbledhjen e tij, jo më vonë se 20 ditë nga ky afat. Nëse edhe pas thirrjes së prefektit këshilli bashkiak nuk mbledhet, atëherë ai shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Këshilli bashkiak shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave edhe kur:
 - a) nuk miratohet buxheti brenda afatit të përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Në këtë rast prefekti i kërkon kryetarit të bashkisë të thërrasë mbledhjen e këshillit bashkiak, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 10 ditë nga data e mbarimit të këtij afati. Në rast se edhe në këtë rast këshilli bashkiak nuk arrin të miratojë buxhetin, vendoset shpërndarja e tij para kohe;
 - b) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.
3. Këshilli bashkiak shpërndahet edhe kur bëhet riorganizim me ndryshim kufijsh, sipas nenit 93 të këtij ligji.
4. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të shpërndarjes nga organi kompetent, në bashkinë përkatëse organizohen zgjedhjet për këshillin, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
5. Deri në konstituimin e këshillit të ri, funksionet dhe kompetencat e këshillit, për aq sa është e mundur, kryhen nga

kryetari i bashkisë.

KREU X KRYETARI I BASHKISË

Neni 59

Kryetari i bashkisë

1. Çdo bashki ka kryetarin e saj, të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.
2. Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkisë, me të drejtë rrizgjedhjeje.
3. Kryetari i bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga kryetari i bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga kryetari i bashkisë.
4. Zëvendëskryetari i bashkisë nuk mund të jetë anëtar i këshillit bashkiak.

Neni 60

Mandati i kryetarit të bashkisë

1. Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.
2. Deklarimi i pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit bëhet kur vërehet se nuk plotësohen kushtet, sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
3. Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të këshillit bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin, sipas formulës së përcaktuar në nenin 50, të këtij ligji, dhe e nënshkruan atë.
4. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës.
5. Në rast se këshilli bashkiak nuk mblidhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prefekti organizon ceremoninë e betimit të kryetarit të bashkisë në mjedisin e bashkisë dhe në praninë e banorëve të njësisë përkatëse.

Neni 61

Përfundimi para kohe i mandatit të kryetarit të bashkisë

1. Mandati i kryetarit të bashkisë përfundon përpara afatit në rastet kur kryetari:
 - a) nuk pranon të bëjë betimin;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) nuk është më banor i përhershëm i bashkisë ku është zgjedhur;
 - ç) shkarkohet, sipas nenit 62 të këtij ligji;
 - d) kandidon për deputet;
 - dh) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
 - e) vdes.
2. Kryetari i bashkisë në rastet e dorëheqjes e depoziton

atë pranë këshillit bashkiak përkatës. Sekretari i këshillit, për ndjekjen e procedurave të nevojshme, njofton prefektin për dorëheqjen e kryetarit.

3. Për rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit përpara afatit, këshilli bashkiak njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit.
4. Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, organizohen zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e bashkisë, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
5. Me përfundimin para kohe të mandatit të kryetarit të bashkisë, sipas këtij neni, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksionet e tij i kryen zëvendëskryetari i bashkisë. Në rastet kur ka më shumë se një zëvendëskryetar bashkie, këshilli përkatës, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, cakton një nga zëvendëskryetarët të kryejë funksionet e kryetarit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.
6. Në rastin kur vendi i kryetarit të bashkisë mbetet vakant gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të tij, këshilli përkatës zgjedh nga radhët e veta një kryetar të ri me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, i cili ushtron funksionet deri në përfundim të mandatit.

Neni 62

Shkarkimi i kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur:

- a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve;
- b) dënohet për kryerjen e një veprë penale, me vendim të formës së prerë, nga gjykata;
- c) propozohet për shkarkim nga këshilli bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë.

Neni 63

Simboli i kryetarit të bashkisë

1. Simboli dallues i kryetarit të bashkisë është një shirit me ngjyrat e flamurit kombëtar, me gjerësi 111 mm, i ndarë në tre sektorë me gjerësi të njëjtë, i kuq - i zi - i kuq.
2. Simboli dallues vendoset krahaqafë, nga supi i djalhtë në ljen e majtë.
3. Kryetari e mban detyrimisht këtë shirit në mbledhjet solemne, pritjet zyrtare, ceremonitë publike dhe në ceremonitë e lidhjes së martesave.

Neni 64

Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

- a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;
- b) zbaton aktet e këshillit;
- c) merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësisë administrative përbërëse të pak-

tën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;

d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;

dh) është anëtar i këshillit të qarkut;

e) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetar/in/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;

ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative/lagjeve dhe i shkarkon ata;

f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;

g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;

gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;

h) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;

i) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesa të bashkisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve;

j) miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;

l) kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendorë, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.

KREU XI

DREJTIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË

Neni 65

Administrata e njësive administrative

1. Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori.

2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës. Administratori duhet të ketë vendbanimin në njësinë administrative përkatëse.

3. Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Neni 66

Detyrat e administratës së njësive administrative

Administrata e njësive administrative kryen këto detyra:

a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;

b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;

c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;

ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;

d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike; dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;

e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;

ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;

f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;

g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënie të titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;

gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;

h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë.

Neni 67

Administrimi i lagjes

1. Në rastin e krijimit të lagjeve, sipas pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji, në secilën lagje krijohet dhe funksionon administrata e lagjes, që drejtohet nga administratori i lagjes. Administratori i lagjes emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij.

2. Administrata e lagjes kryen të gjitha detyrat administrative, të ngarkuara nga kryetari i bashkisë, si dhe kujdeset për zhvillimin ekonomik vendor, për përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në lagjen përkatëse. Detyrat më të hollësishme përcaktohen në aktet e nxjerra nga kryetari i bashkisë.

KREU XII

FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE KOMUNITARE NË BASHKI

Neni 68

Struktura komunitare në qytet

1. Në qytete, në bazë të iniciativës qytetare, ngrihen dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe organizohen mbi baza vullnetare.

2. Këshillat bashkiakë përcaktojnë rregullat e përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve dhe marrëdhëniet që ato kanë me bashkinë dhe strukturat e saj.

3. Nga radhët e anëtarëve të këshillave komunitarë zgjidhen ndërlidhësit komunitarë që drejtojnë dhe organizojnë punën e këshillave.

4. Si rregull, në çdo lagje krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve.

Neni 69

Detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar

1. Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të mbështesin funksionet qeverisëse të bashkisë në lagjen e tyre dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit.

2. Këshillat komunitarë, në bazë të vendimeve të këshillave bashkiakë, kanë të drejtë të kryejnë funksione dhe kompetenca të caktuara që mund t'u delegohen nga këshilli. Në këtë rast, këshilli bashkiak vendos edhe për masën e financimit apo bashkëfinancimit për kryerjen e funksionit apo kompetencës së deleguar, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e këshillit komunitar.

3. Ndërlidhësi komunitar mund të shpërblehet për punën që kryen, sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak.

Neni 70

Struktura komunitare në fshat

1. Fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. Kryesia është organ këshillimor i kryetarit. Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhje të fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote. Përbërja e kryesisë së fshatit duhet të respektojë ligjin për barazimin gjinor. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga këshilli bashkiak përkatës.

2. Numri i anëtarëve të kryesisë së fshatit përcaktohet nga këshilli bashkiak në bazë të numrit të banorëve të fshatit dhe lagjeve përbërëse të tij.

3. Kryetari i fshatit zgjidhet nga kryesia e fshatit nga radhët e anëtarëve të kryesisë së fshatit.

4. Zgjedhjet e kryesisë së fshatit bëhen një herë në katër vjet, pas zgjedhjeve për këshillin bashkiak dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, kryetari i bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit. Në rastet e krijimit të vendit vakant për anëtar të kryesisë zhvillohen procedurat e sipërpërmendura të zgjedhjes për vendin vakant. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të afatit katërvjeçar.

5. Procesi i zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikëqyren nga këshilli bashkiak përkatës.

Neni 71

Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit

1. Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.

2. Bazuar në vendimin e kryetarit të bashkisë, kryetari ose kryesia e fshatit mund të kryejë edhe detyrat si më poshtë:
a) kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit;

b) kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdolloj dëmtimi të rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike në fshat;

c) administrimin e varrezave të fshatit;

ç) kujdesjen për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave, si dhe të burimeve natyrore.

3. Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak.

4. Kryetari pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin.

5. Urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e organeve të zgjedhura të bashkisë përkatëse janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.

6. Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kryetari i fshatit mund të thirret në mbledhjet e këshillit bashkiak ose merr pjesë në to me nismën e tij pa të drejtë vote. Ai ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në mbledhje për çështje që janë të lidhura me fshatin përkatës.

KREU XIII

PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT TË QARKUT

Neni 72

Përbërja e këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut përbëhet nga përfaqësues të bashkive që bëjnë pjesë në qark.

2. Kryetarët e bashkive që bëjnë pjesë në qark janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut.

3. Numri i anëtarëve të këshillit të qarkut përcaktohet sipas nenit 73 të këtij ligji.

4. Funksioni i anëtarit të këshillit të qarkut është i papajtueshëm me çdo funksion në administratën e qarkut.

5. Anëtarët e këshillit të qarkut e kryejnë funksionin pa shpërblim, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur anëtarë të kryesisë së këshillit të qarkut.

Neni 73*Përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillit të qarkut*

1. Numri i përfaqësuesve të bashkive në këshillin e qarkut caktohet në përpjesëtim me numrin e popullsisë, si më poshtë:
 - Bashkitë me popullsi deri në 20 000 banorë, 2 përfaqësues.
 - Bashkitë me popullsi 20 001 deri në 50 000 banorë, 4 përfaqësues.
 - Bashkitë me popullsi 50 001 deri në 100 000 banorë, 5 përfaqësues.
 - Bashkitë me popullsi mbi 100 000 banorë, 5 + nga një përfaqësues shtesë për çdo 1 deri në 50 000 banorë mbi 100 000 banorë.
2. Brenda numrit të përfaqësuesve për çdo bashki, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshihet kryetari i bashkisë, si dhe përfaqësuesit e tjerë që zgjidhen nga këshilli i bashkisë.
3. Prefekti përcakton numrin e përfaqësuesve të çdo bashkie, që përfshihen në territorin e qarkut, duke u bazuar në të dhënat e numrit të popullsisë, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit të zgjedhjeve vendore.
4. Vendimet e këshillave bashkiakë për përfaqësuesit e tyre në këshillin e qarkut i dërgohen prefektit brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tyre.

Neni 74*Mbledhja e parë e këshillit të qarkut*

1. Këshilli i qarkut zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 50 ditë nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore.
2. Mbledhja e parë thirret nga kryetari i bashkisë, qendër e qarkut, ose nga një e treta e anëtarëve të këshillit të qarkut. Njoftimi për mbledhjen e këshillit të qarkut i dërgohet me shkrim të gjithë anëtarëve të këshillit të qarkut jo më vonë se 10 ditë para datës së mbledhjes.
3. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij.
4. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të këshillit të qarkut, drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.
5. Në mbledhjen e tij të parë këshilli i qarkut:
 - a) zgjedh komisionin e mandateve, i cili verifikon mandatet e anëtarëve të këshillit;
 - b) vërteton mandatet e anëtarëve të këshillit;
 - c) zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kryesinë e këshillit të qarkut, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.
6. Këshilli i qarkut konstituohet pas vërtetimit të mandateve të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.
7. Nëse nuk sigurohet pjesëmarrja e gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit të qarkut, mbledhja anulohet dhe thirret çdo dhjetë ditë, derisa të sigurohet shumica e nevojshme.
8. Në rast se këshilli i qarkut nuk konstituohet deri në 90 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore, prefekti ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e

këtij këshilli deri në çastin e konstituimit.

Neni 75*Mandati i këshilltarit të qarkut*

1. Mandatin e këshilltarit të qarkut e fitojnë të gjithë kryetarët e bashkive përbërëse të tij menjëherë me marrjen e mandatit përkatës.
2. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit të qarkut përfaqësues nga radhët e këshillit bashkiak, në përputhje me nenin 48, të këtij ligji, bëhet me votimin e listës shumëmemërore të kandidatëve dhe shpallet fitues kandidati ose kandidatët që kanë marrë më shumë vota.
3. Anëtarit të këshillit të qarkut i mbaron mandati kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) vdes;
 - c) humbet mandatin si kryetar apo këshilltar i bashkisë;
 - ç) vërtetohet se mandati është fituar në mënyrë të paligjshme.
4. Në rastin e krijimit të vendit vakant, që lidhet me humbjen e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një anëtar i këshillit të një bashkie, ai zëvendësohet nga këshilli bashkiak përkatës, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.
5. Në rast se vendi vakant krijohet nga humbja e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një kryetar bashkie në 6 muajt e fundit të mandatit, vendin e tij e zë kryetari i zgjedhur nga këshilli bashkiak përkatës.

Neni 76*Funksionimi i këshillit të qarkut*

1. Këshilli i qarkut ushtron kompetencat nga çasti i konstituimit të tij deri në konstituimin e këshillit pasardhës.
2. Mbledhja e radhës e këshillit të qarkut bëhet jo më pak se një herë në tre muaj.
3. Mbledhjet zhvillohen sipas programit të punës që bën këshilli.
4. Këshilli i qarkut mblidhet jashtë radhe me kërkesë:
 - a) të kryetarit të tij;
 - b) të kryesisë së këshillit;
 - c) të një të tretës së anëtarëve të këshillit;
 - ç) të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
5. Thirrja e mbledhjes së këshillit bëhet nga kryetari.
6. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet, si rregull, jo më pak se 10 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.
7. Mbledhja e këshillit të qarkut quhet e vlefshme, kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 77*Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut*

- Këshilli i qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra:
- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
 - b) zgjedh nga anëtarët e këshillit kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e kryesisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, dhe i shkarkon ata;
 - c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit të qarkut;

ç) miraton strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njëjseve e të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblyerjes të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislationin në fuqi;

d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;

dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij;

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm;

f) vendos për taksat e tarifatat në kompetencë të qarkut, si dhe për nivelin e tyre;

g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;

gj) vendos për krijimin e një personi juridik me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta, sipas nenit 14 të këtij ligji;

h) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve në varësi të tij;

i) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vetë;

j) vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut, sipas nenit 75 të këtij ligji;

k) miraton norma, standarde e kriteret për rregullimin e disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik në nivel qarku;

l) vendos për simbolet e qarkut;

ll) jep tituj nderi dhe stimuj;

m) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark;

n) miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së këshillit të qarkut.

Neni 78

Votimi

1. Vendimet e këshillit të qarkut merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në shkronjat "a", "b", "ë", "f", "g", "gj" e "ll", të nenit 77, të këtij ligji, që kërkojnë votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën "e", të nenit 77, të këtij ligji.

2. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rast se edhe pas këtij votimi kandidatët kanë numër të barabartë votash, fituesi caktohet me short.

3. Vendimet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data

e marrjes së tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 79

Mbledhjet e hapura, seancat e këshillimeve dhe e drejta e publikut për t'u informuar

Këshilli i qarkut zhvillon mbledhje të hapura për publikun, zhvillon seanca këshillimi me organet përfaqësuese e ekzekutive të bashkive dhe me bashkësitë përkatëse, si dhe respekton të drejtën e publikut për t'u informuar, sipas përcaktimeve në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji.

Neni 80

Pengesa ligjore për anëtarët e këshillit të qarkut

Anëtari i këshillit të qarkut është në kushtet e pengesës ligjore, në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 52, të këtij ligji, dhe për të zbatohet nga kryetari i këshillit të qarkut kompetenca dhe procedura e parashikuar në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 52, të këtij ligji.

Neni 81

Kryesia e këshillit të qarkut

1. Kryesia e këshillit të qarkut përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe nga 3 deri në 5 anëtarë të tjerë.

2. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen e shkarkohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur nuk arrihet shumica e kërkuar, kalohet në rivotim ndërmjet dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave në raundin e parë.

3. Anëtarët e tjerë të kryesisë së këshillit të qarkut zgjidhen dhe shkarkohen me votim, me listë shumëmemërore kandidatësh, dhe shpallen fitues kandidatët që kanë marrë më shumë vota.

4. Kryesia e këshillit të qarkut thirret në mbledhje nga kryetari, jo më pak se një herë në muaj.

5. Mbledhjet e kryesisë janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

6. Funksionet e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të këshillit të qarkut janë të papajtueshme me funksionin e kryetarit të bashkisë.

Neni 82

Kompetencat e kryesisë së këshillit të qarkut

1. Kryesia e këshillit të qarkut ka këto kompetenca dhe detyra:

a) ushtron të gjitha kompetencat, me përjashtim të atyre që i janë dhënë shprehimisht këshillit të qarkut;

b) miraton projektaktet dhe materialet e tjera për mbledhjen e këshillit të qarkut, në përputhje me rendin e ditës, të përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme të kërkuara nga ajo vetë;

c) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kërkohet nga këshilli;

ç) raporton në këshill sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e qarkut;

d) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar qarkut si person juridik.

2. Në ushtrimin e kompetencave të saj, kryesia e këshillit të qarkut nxjerr vendime, të cilat miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm. Vendimet marrin fuqi detyruese për t'u zbatuar nga të gjitha organet dhe personat e ngarkuar, pasi shpallen publikisht ose u bëhen të njohura subjekteve të interesuara.

3. Vendimet e kryesisë duhet të miratohen në mbledhjen më të afërt të këshillit të qarkut, në të kundërt e humbasin fuqinë e tyre që nga fillimi.

Neni 83

Kryetari i këshillit të qarkut

1. Kryetari i këshillit të qarkut përfaqëson këshillin e qarkut në marrëdhënie me organe shtetërore, me organet e njësisive të vetëqeverisjes vendore, me persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, si dhe ushtron këto kompetenca:

a) kryeson mbledhjet e këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;

b) nënshkruan të gjitha aktet dhe procesverbalet e mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së këshillit;

c) siguron zbatimin e vendimeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;

ç) në përputhje me tematikën e mbledhjeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë, përgatit raportet, projektvendimet dhe materialet e tjera të nevojshme;

d) drejton administratën e këshillit të qarkut dhe përgjigjet para këshillit për funksionimin e saj;

dh) emëron dhe shkarkon personelin e administratës së këshillit të qarkut, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;

e) garanton kryerjen e funksioneve që i janë dhënë me ligj këshillit të qarkut;

ë) merr masa dhe siguron funksionim normal të të gjitha strukturave të këshillit, të mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së tij;

f) ushtron kompetenca të tjera, që i ngarkohen me ligj, nga këshilli i qarkut ose nga kryesia e tij.

2. Në ushtrimin e kompetencave të tij, kryetari i këshillit të qarkut nxjerr urdhra me karakter individual.

3. Në mungesë të kryetarit, funksionet e tij kryhen nga zëvendëskryetari.

Neni 84

Sekretari i këshillit të qarkut

Sekretari i këshillit të qarkut kryen detyrat e tij njëjloj me ato të sekretarit të këshillit bashkiak, të përcaktuara në nenin 57 të këtij ligji.

Neni 85

Kufizimi i autoritetit të qarkut

Vendime e organeve të qarkut nuk mund të cenojnë autonominë e bashkive përbërëse.

KREU XIV

RIORGANIZIMI I ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL I VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 86

Riorganizimi administrativo-territorial

Ndarja administrativo-territoriale në fuqi mund të riorganizohet me ose pa ndryshim të kufijve ekzistues të njësisive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me interesat ekonomikë e socialë, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë.

Neni 87

Riorganizimi me ndryshim kufijsh

Riorganizimi me ndryshim të kufijve bëhet kur:

a) një njësi e vetëqeverisjes vendore ndahet në mënyrë të plotë në dy a më shumë njësi më vete të vetëqeverisjes vendore;

b) dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore shkrihen për të formuar së bashku në territorin tyre një njësi të vetme të vetëqeverisjes vendore;

c) një pjesë e territorit të një njësie të vetëqeverisjes vendore kalon në territorin dhe administrimin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore;

ç) kërkohet një kombinim i rasteve të sipërpërmendura.

Neni 88

Riorganizimi pa ndryshim kufijsh

Riorganizimi pa ndryshim kufijsh bëhet në rastet e ndryshimit të emërimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës të saj.

Neni 89

Mbështetja ligjore dhe propozuesi i riorganizimit

Riorganizimi i ndarjes administrativo-territoriale me ose pa ndryshim kufijsh bëhet me ligj të veçantë. Propozimi për riorganizimin e një ose më shumë njësisive të vetëqeverisjes vendore, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me këto fakte dhe argumente:

a) arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demografike, administrative për nevojën dhe avantazhet e riorganizimit;

b) mendimin e popullatës që banon në njësitë e vetëqeverisjes vendore që do të riorganizohet;

c) hartat administrativo-territoriale, në të cilat pasqyrohen edhe ndryshimet që rrjedhin nga riorganizimi;

ç) mënyrat e rregullimit të çështjeve financiare, të detyrimeve ndaj të tretëve ose ndaj njëra-tjetrës të njësisive të qeverisjes vendore, të përfshira në riorganizim.

Neni 90

Detyrimi për të shprehur mendimin

1. Këshillat bashkiakë dhe të qarqeve, që janë të përfshirë drejtpërdrejt në riorganizim, si dhe kryetarët e tyre japin mendimin e tyre zyrtar dhe, nëse ka, edhe mendimin "kundër" të një pjese të këshilltarëve të këshillit përkatës.

2. Këshilli i Ministrave, kur ky i fundit nuk është propozues, dhe institucione të tjera shtetërore qendrore, që nuk varen

nga Këshilli i Ministrave, të interesuara për riorganizimin përkatës, japin mendimin e tyre të argumentuar "pro" ose "kundër" ndaj këtij riorganizimi.

3. Organet e sipërpërmendura japin mendimin brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shprehje mendimi nga ana e propozuesit.

Neni 91

Rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve të njësive të riorganizuara

1. Në çdo rast, kur riorganizimi prek çështje të të drejtave financiare, pasurore, të detyrimeve ndaj të tretëve dhe të drejta të tjera civile të njësive të vetëqeverisjes vendore, ato rregullohen sipas legjislacionit në fuqi si të drejta dhe detyrime të personave juridikë, si rregull, nëpërmjet marrëveshjes mes palëve.

2. Në rast mosmarrëveshesh për problemet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, konfliktet zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 92

Garantimi i vazhdimet të funksioneve bazë qeverisëse

1. Në rastin e riorganizimit me ndryshim kufijsh, që krijon njësi të reja të vetëqeverisjes vendore, ose kur ky riorganizim shkakton papajtueshmëri të mandatit të shumicës së anëtarëve të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, së cilës i largohet një pjesë e territorit, në këto njësi kryhen zgjedhje vendore të pjesshme, sipas mënyrave dhe afatëve të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

2. Organet e reja të vetëqeverisjes vendore, si dhe organet e tjera shtetërore qendrore e vendore kompetente marrin menjëherë masat e nevojshme që njësitë e vetëqeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi, të funksionojnë normalisht, sipas këtij ligji, duke garantuar kryerjen e shërbimeve bazë publike për popullatën përkatëse për periudhën transitorë.

3. Procedurat dhe masat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër shtetëror në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 93

Përditësimi i kufijve administrativo-territorialë

1. Këshilli i Ministrave, bazuar në ligjin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale, miraton me vendim hartën e përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas standardeve të përcaktuara gjeohapësinore. Kjo hartë përditësohet çdo 10 vjet.

2. Këshillat bashkiakë, bazuar në ligjin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale, miratojnë me vendim hartën e përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorialë të njësive administrative dhe fshatrave në përbërje të tyre, sipas standardeve të përcaktuara gjeohapësinore.

KREU XV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 94

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 12, pika 3, dhe 93, pika 1, të këtij ligji.

Neni 95

Dispozitë kalimtare

1. Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësive administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësive administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në nenin 54, shkronja "i", të këtij ligji, përbërja ekzistuese e këshillave të qarqeve qëndron në fuqi deri në formimin e këshillave të qarqeve pas zgjedhjeve vendore në vitin 2019. Në rast të krijimit të vendeve vakante, deri në plotësimin e kërkesës së shkronjës "i", të nenit 54, të këtij ligji, ato plotësohen me kandidatë të gjinisë më pak të përfaqësuar.

3. Funksionet e reja, që u transferohen bashkive me këtë ligj, për një periudhë deri në tre vjet, do të financohen nga buxheti i shtetit me transferta specifike, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit.

Neni 96

Shfuqizime

Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, si dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 97

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
I I R M E T A

Miraturar në datën 17.12.2015

LIGJ
NR. 121/2016

“PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton:

- a) llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërkimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- b) rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Shërbime të kujdesit shoqëror” është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.
2. “Shërbime rezidenciale” janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.
3. “Shërbime komunitare” janë shërbime që ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera, si shërbimet e kujdesit ditor apo të zëvendësimit të përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
4. “Shërbime parashoqërore” janë shërbime që përfshijnë informimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ofruesit e shërbimeve, ndihmën për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre, vlerësimin fillestar, mbështetjen dhe ndihmën për zgjedhjen që u përshtatet nevojave të përfituesit në sistemin e shërbimeve shoqërore.

5. “Shërbime në familje” janë shërbime të kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për kategoritë në nevojë, që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale.

6. “Shërbime të specializuara” janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të profilizuar në specialitete të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonar dhe bashkie për fëmijët me çrregulime pervazive të zhvillimit, prapambetje mendore, çrregullime në komunikim, në nevojë për aftësim fizik, fëmijët e abuzuar seksualisht, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe gratë e vajzat e abuzuara, të dhunuara apo të trafikuar, si dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla.

7. “Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line” është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas protokollove të hartuara dhe të miratuara.

8. “Përfitues i shërbimeve të kujdesit shoqëror” është subjekti, individi ose familja që përmbush kushtet për të përfituar të drejtat nga shërbimi shoqëror.

9. “Fëmijë” është çdo individ deri në moshën 18 vjeç.

10. “Fëmijë në nevojë për mbrojtje të veçantë” është individ deri në moshën 18 vjeç, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, trafikimit, diskriminimit, dhunës, braktisjes apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën 18 vjeç, i cili ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale.

11. “Person me aftësi të kufizuar” është individ, fëmijë ose i rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

12. “Viktima të dhunës” janë të gjithë individët, grupet e individëve apo familjet, të cilat janë viktima dhe/ose viktima të mundshme të dhunës, përfshirë dhunën në familje ose abuzimet, sipas legjisllacionit në fuqi.

13. “Viktimë e trafikimit” është personi fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës “e”, të nenit 4, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””.

14. “Situatë emergjence” është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese.

15. “Procedurë administrative”, “Akt administrativ”, “Kompetenca administrative”, “Organ publik”, “Palë” kanë kuptimin e dhënë në Kodin e Procedurave Administrative.

16. “Kujdestar” është individ që ofron shërbime kujdestarie për të miturit sipas përcaktimeve në Kodin e Familjes.

17. “Familje kujdestare” është një familje alternative, e ven-

dosur nga gjykata për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

18. "Ndhmës personal" është individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

19. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjyhen, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

20. "Person i vetëm" është individ i cili nuk ka një familje ose që jeton i vetëm.

21. "Prind i vetëm" është prindi i/e cili/a nuk është martuar ose që kujdeset i/e vetëm/me për fëmijën/ët e tij/saj.

22. "Person mbi moshë pune" është individ që, në çastin e vlerësimit të kriteve për përfitimin e shërbimit shoqëror, është mbi moshën e përcaktuar të punës për atë vit, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

23. "Njësi të qeverisjes vendore" janë bashkitë dhe qarqet, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore.

24. "Punonjës social i njësive të qeverisjes vendore" është profesionisti, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jetë përgjegjës për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve.

25. "Menaxhim i rastit" është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre.

26. "Subjekt jopublik, ofruer i shërbimeve shoqërore" është çdo ofruer jopublik i licencuar për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, nga autoriteti përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin.

27. "Regjistri Elektronik Kombëtar" është baza elektronike e të dhënave të përfituesve, subjekteve ofruese, institucioneve përgjegjëse, llojit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror.

28. "Punonjës i shërbimeve sociale" është i punësuar në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

29. "Tarifat e shërbimeve të kujdesit shoqëror" janë tarifat që vendosen me vendim të këshillit bashkiak në përputhje me kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Minis-

trave, sipas llojit të shërbimit dhe mënyrës së përcaktimit të tyre.

KREU II PARIME TË VEÇANTA

Neni 4 Parimet

Shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) Parimi i universalitetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

b) Parimi i drejtësisë sociale. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

c) Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

ç) Parimi i mbështetjes shoqërore. Subjektet, të cilat përbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrë e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

d) Parimi i deinstitutionalizimit. Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

dh) Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

e) Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.

ë) Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

f) Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo per-

son tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt të këtij ligji, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

PJESA E DYTË

KATEGORITË E SUBJEKTEVE PËRFITUESE DHE LLOJET E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

KREU I

SUBJEKTET QË GËZOJNË TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Neni 5

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.
2. Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren nga shtetasit shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë.
3. Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren edhe nga shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët, por me banim në Republikën e Shqipërisë.
4. Personat, të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të drejtën e kujdesit shoqëror njësoj si shtetasit shqiptarë, bazuar në dokumentacionin përkatës, të përgatitur për këtë qëllim nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sipas legjislacionit në fuqi për azilin.

Neni 6

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore:
 - a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;
 - b) personat me aftësi të kufizuara;
 - c) të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
 - ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;
 - d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;
 - dh) të moshuarit në nevojë.
2. Individit, i cili nuk përfshihet te përfituesit e shërbimeve

të kujdesit shoqëror, sipas pikës 1, të këtij neni, ka të drejtë, kundrejt tarifave përkatëse, të kërkojë sistemim të përkohshëm në institucionet e ofrimit të shërbimit, qofshin këto rezidenciale apo komunitare, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, deri në mbarimin e rrethanave të veçanta për të cilat ka kërkuar shërbimin.

Neni 7

Kategoritë që nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror

Nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror kategoritë e mëposhtme:

- a) shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;
- b) azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit;
- c) shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave;
- ç) personat që vuajnë dënim me heqje lirie, me vendim të formës së prerë të gjykatës.

KREU II

SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR DHE MËNYRATË OFRIMIT TË TYRE

Neni 8

Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuar të përfituesve.
2. Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë:
 - a) shërbimet parashoqërore;
 - b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;
 - c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;
 - ç) shërbimet shoqërore në situatë emergjente;
 - d) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror;
 - dh) shërbimet e specializuara;
 - e) shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.
3. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm ofrimi i tyre në familje apo komunitet.
4. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përdorur shërbime të kujdesit shoqëror paraqiten te punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore, pjesë e strukturave të vlerësimit të nevojave dhe referimit në njësitë e qeverisjes vendore.
5. Kriteret dhe procedurat e pranimit në qendrat rezidenciale dhe për përdorimin e shërbimeve në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Klasifikimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.
2. Në shërbimet shoqërore publike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet

vendore të organeve të qeverisjes vendore.

3. Shërbimet jopublike klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror.

4. Shërbimet shoqërore të specializuara janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku.

5. Në shërbimet shoqërore jopublike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi nga subjekte jopublike.

Neni 10

Shërbimet parashoqërore

1. Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe përbëhen nga: a) informimi dhe këshillimi; b) shërbimi në familje; c) mbështetja psiko-sociale; ç) ndërhyrja e hershme.
2. Shërbimet parashoqërore sigurohen nga profesionistë të caktuar nga struktura të vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë njësive të qeverisjes vendore.

Neni 11

Informimi dhe këshillimi

Informimi dhe këshillimi janë shërbime që synojnë përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij, në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 12

Shërbimi në familje

1. Shërbimi në familje është shërbim ndaj individit, person i vetëm, që jepet në shtëpi ose në familjen kujdestare.
2. Shërbimi në familje u njihet fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari.
3. Shërbimi në familje është një kombinim shërbimesh të kujdesit ditor që përfshin:
 - a) furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;
 - b) furnizim të barnave apo furnizime të tjera;
 - c) mbajtjen e higjienës personale;
 - ç) përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti; d) mbështetjen psiko-sociale.

Neni 13

Mbështetja psiko-sociale

1. Mbështetja psiko-sociale ofrohet individualisht ose në grup dhe synon inkurajimin, rehabilitimin, zhvillimin e aftësive njohëse, funksionale, komunikuese apo shoqërore të përfituesve.

2. Kur vlerësohet e nevojshme nga strukturat e vlerësimit të nevojave dhe referimit, mbështetja psiko-sociale mund të jepet edhe si pjesë e shërbimeve të specializuara.

Neni 14

Ndërhyrja e hershme

1. Ndërhyrja e hershme është një shërbim shoqëror individual që ofrohet në familje, në qendra sociale për ofrimin e shërbimeve në komunitet ose institucionet e arsimit të detyrueshëm dhe konsiston në ndihmë profesionale dhe stimuluese për fëmijët deri në 8 vjeç, asistencë këshilluese për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes me lidhje gjaku ose për familjen kujdestare, me qëllim riintegrimin në shoqëri të fëmijës.

2. Ndërhyrja e hershme përfshin referimin e rastit të fëmijës te një qendër e shërbimeve shoqërore e specializuar, institucion i arsimit të detyrueshëm apo institucion mjekësor, sipas karakteristikave të veçanta të fëmijës.

Neni 15

Shërbimet komunitare

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara kryesisht në qendra komunitare, ofrohen si shërbime të plota ditore ose gjysmëditore.

2. Qëndrimi i plotë ditor zgjat nga gjashtë deri në tetë orë në ditë, ndërsa qëndrimi gjysmëditor nuk mund të jetë më shumë se gjashtë orë në ditë.

3. Gjatë kohës së qëndrimit në qendrën komunitare garantohet siguria fizike, jepen shërbime për higjienën personale, kujdesin shëndetësor, edukimin, rehabilitimin psiko-social, kalimin e kohës së lirë në komunitet, fuqizimin e individit/familjes, si dhe çdo shërbim tjetër i nevojshëm, sipas nevojave të identifikuara të përfituesit.

4. Shërbimet e plota ditore mund të përdoren një ose disa ditë në javë ose gjatë të gjitha ditëve të punës.

5. Kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Shërbimet në qendrat e zhvillimit

1. Shërbimet në qendrat e zhvillimit janë shërbime komunitare që synojnë sigurimin dhe përmirësimin e statusit dhe cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç.

2. Llojet e shërbimeve, që ofrohen në qendrat e zhvillimit janë si më poshtë:

- a) terapi intensive psiko-sociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;
- b) shërbim psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale;
- c) aftësim i parametrave fizikë;
- ç) shërbime të specializuara ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo aftësisë për të komunikuar;
- d) terapi riaftësimi për punë;
- dh) terapi zhvillimi.

Neni 17

Strehëzat

1. Shërbimi në strehëza është shërbim i kujdesit shoqëror rezidencial i ofruar në mënyrë të përkohshme, që përfshin shërbimin e specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psiko-social, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit.
2. Përfituesit e shërbimit në streha janë:
 - a) fëmija, i cili gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik, apo në situatë rruge;
 - b) fëmija në nevojë të mbrojtjes së veçantë;
 - c) i rrituri, ose i moshuari, i cili nuk ka vendbanim të përherëshëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;
 - ç) gratë dhe vajzat shtatzëna ose prindi i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç;
 - d) fëmijët dhe të rriturit, viktimat të dhunës në familje, abuzimit, viktimat të trafikimit apo viktimat të mundshme të trafikimit ose në rrezik potencial për jetën;
 - dh) fëmijët dhe të rriturit në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësive nga droga ose alkooli apo përjashtimi social.
3. Ky shërbim mund të ofrohet gjatë të gjitha ditëve të javës dhe përfshin edhe referimin në një shërbim tjetër shoqëror.

Neni 18

Strehimi i përkohshëm

1. Strehimi i përkohshëm është një shërbim i ofruar ndaj individëve që ndodhen në rrethana të vështira dhe emergjente, deri në referimin e tyre të një shërbim tjetër shoqëror.
2. Përfituesit e këtij shërbimi nuk kalojnë në procesin e zakonshëm të vlerësimit të rastit, por vetëm referohen nëpërmjet punonjësit social.
3. Pas kalimit të situatës së emergjencës, struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe referimin bën vlerësimin e mëtejshëm të rastit për personin në nevojë.
4. Ky shërbim strehimi mund të jepet edhe në familjen me lidhje gjaku ose familjen kujdestare.
5. Strehimi i përkohshëm zgjat deri në gjashtë muaj, por mund të zgjatë deri në një vit, rast pas rasti.

Neni 19

Trajtimi i fëmijës në situatat e emergjencës

1. Në rast se një punonjës social i njësisë së qeverisjes vendore informohet ose beson në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në situatë emergjence, ndërmerr veprimet e mëposhtme:
 - a) largon fëmijën nga vendndodhja aktuale dhe e strehon atë në strehën e përkohshme më të afërt;
 - b) ndihmon fëmijën duke e dërguar në spital ose informon menjëherë policinë në rast se situata e kërkon;
 - c) komunikon me fëmijën për të kuptuar situatën e tij;
 - ç) informon fëmijën mbi hapat që duhen ndjekur sipas këtij neni.
 - d) referon fëmijën në njësinë e mbrojtjes së fëmijës.
2. Menjëherë pas dërgimit të fëmijës në strehën e për-

kohshme, punonjësi social informon prindërit ose përfaqësuesin ligjor të fëmijës.

3. Streha e përkohshme ku është strehuar fëmija bën kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje në gjykatën kompetente, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e fëmijës, duke legjitimuar qëndrimin e tij në qendrat e kujdesit shoqëror.
4. Në rast se gjykata lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, fëmija qëndron në qendrat e kujdesit shoqëror, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë ligj.
5. Pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes, institucioni i kujdesit shoqëror, në rast se e diktojnë rrethanat, paraqet përpara gjykatës një kërkesë për vendosjen ose zëvendësimin e kujdestarisë.
6. Në rast se gjykata nuk e gjykon të arsyeshëm lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore monitoron mirëqenien e fëmijës pranë familjes.

Neni 20

Trajtimi i fëmijëve të shfrytëzuar ose të trafikuar

Institucionet, të cilat me ligj janë përgjegjëse për trajtimin e fëmijëve të shfrytëzuar ose të trafikuar, janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet specifike për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijët, viktimat të shfrytëzimit ose trafikimit, deri në shërimin e tyre fizik dhe psiko-social, pas një vlerësimi të veçantë të rrethanave të secilit fëmijë, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme, sipas ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".

Neni 21

Shërbimet në qendrat rezidenciale

1. Shërbime në qendrat rezidenciale konsiderohen shërbimet e strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohet kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur.
2. Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit.

Neni 22

Strehimi afatgjatë

1. Strehimi afatgjatë u sigurohet individëve që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore, kur ky kujdes nuk u sigurohet dot në familje apo familje kujdestare.
2. Personat që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm janë:
 - a) personat me aftësi të kufizuara, sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje, duke i dhënë format e duhura institucionale të kujdesit;
 - b) të moshuarit dhe të sëmurët rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore.

Neni 23*Strehimi i organizuar*

1. Strehimi i organizuar është një shërbim i kujdesit shoqëror në nivel vendor, i cili ofrohet për 24 orë në ditë në qendrat rezidenciale për të përmbushur nevojat themelore sociale, kulturore, arsimore, rekreative dhe përfituesve nga subjekte publike ose jopublike.
2. Strehimi i organizuar u ofrohet të moshuarve, jetimëve, fëmijëve pa kujdes prindëror ose pa kujdestari, personave me aftësi të kufizuara, duke u dhënë format e duhura rezidenciale të kujdesit, kur janë shteruar të gjitha mundësitë për të siguruar kujdesin në familje, familje kujdestare apo qendra komunitare.
3. Përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar u jepet një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Personat, që kanë dëshirë të përdorin shërbimin e strehimit të organizuar dhe kanë të ardhura personale, mund të pranohen në institucionet publike të strehimit të organizuar, kundrejt një tarife.
5. Në çdo rast, përparësi për t'u pranuar në shërbimin e strehimit të organizuar do të kenë kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 24*Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror*

1. Fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme/të përhershme nga mjedisi familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis i sigurohet një përkujdesje alternative.
2. Përkujdesja alternative mund të jetë:
 - a) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesjes për fëmijë;
 - b) vendosja në një familje birësuese.
3. Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror ofrohen në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të fëmijës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
4. Procedura e evidentimit të familjes kujdestare organizohet dhe mbikëqyret nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin e rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
5. Kriteret, dokumentacioni dhe procedura që do të ndiqet nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, për evidentimin e familjeve kujdestare, si dhe masa e financimit për shpenzimet e fëmijës të vendosur në familje kujdestare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve.

Neni 25*Shërbimet publike*

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfitojnë shërbimet publike, si arsimimi dhe shëndetësia. Shpen-

zimet e tyre mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

2. Përfituesit e shërbimeve shoqërore, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Kontributi në fondin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore për këto kategori paguhet nga Buxheti i Shtetit.

PJESA E TRETË**ADMINISTRIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR****KREU I****Neni 26***Kriteret e përgjithshme të funksionimit dhe bashkëndimit*

1. Sistemi i shërbimeve të kujdesit shoqëror ofron shërbime, falas ose kundrejt tarifave, sipas rasteve të përcaktuara në këtë ligj.
2. Në çdo rast, metodologjia e përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre do të bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave.
3. Koordinimi dhe mbështetja e përgjithshme e shërbimeve të kujdesit shoqëror bëhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Neni 27*Subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror*

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen nga personat juridikë publikë apo jopublikë, të licencuar për këtë qëllim. Licencimi i veprimtarive të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe subjekteve të ofrimit të tyre, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet nga autoriteti përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për licencat.
2. Shërbimet e kujdesit shoqëror të financuara privatisht ofrohen nga subjekte jopublike, por sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
3. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Neni 28*Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*

1. Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror fillon me kërkesë të individit në nevojë, përfaqësuesit të tij, psikologut, por mund të fillojë edhe kryesisht nga punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore kur konstatohet situata e nevojës për shërbime.
2. Kërkesa për të përfituar shërbime të kujdesit shoqëror paraqitet te punonjësi social i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit në strukturën e posaçme për shërbimet shoqërore të njësisë së qeverisjes vendore.
3. Këshilli bashkiak vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës për pranimin në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Vendimet e këshillit bashkiak mund të ankimo-

hen në rrugë gjyqësore.

4. Në rast se shërbimi i kujdesit shoqëror për individin nuk ofrohet nga ajo njësi e qeverisjes vendore, kryetari i bashkisë referon rastin te një njësi tjetër e qeverisjes vendore, vetë ose nëpërmjet drejtorisë rajone të Shërbimit Social Shtetëror. Vendimet e kryetarit të bashkisë mund të ankimohen në rrugë gjyqësore.

Neni 29

Regjistri Elektronik Kombëtar

1. Regjistri Elektronik Kombëtar administrohet në nivel qendror nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe aksesohet nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.
2. Çdo njësi e qeverisjes vendore ka detyrimin për të hedhur në regjistër të dhënat që disponon dhe për të raportuar periodikisht në Shërbimin Social Shtetëror.
3. Të dhënat e hedhura në regjistër grumbullohen nga Shërbimi Social Shtetëror dhe i raportohen në mënyrë periodike ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
4. Regjistri Elektronik Kombëtar ngrihet dhe administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazën e të dhënave shtetërore.
5. Rregullat specifike të funksionimit e të administrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Përgjegjësia për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Zbatimi i sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet e njësisive të qeverisjes vendore, është përgjegjësi e organeve publike të ngarkuara me këtë detyrë, në nivel qendror dhe vendor.
2. Institucionet kryesore përgjegjëse për administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë si më poshtë:
 - a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e saj të varësisë; b) qarku;
 - c) bashkia.

Neni 31

Roli i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale organizon dhe administron sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të tyre.
2. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka këto role dhe funksione kryesore:
 - a) harton dokumentet e politikave të reformimit e të modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me synim rritjen e efektivitetit dhe ofrimin e tyre;
 - b) harton dhe përditëson standardet minimale të ofrimit të shërbimeve;
 - c) harton dhe/ose propozon akte ligjore e nënligjore për plotësimin e kuadrit rregullator të funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - ç) përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin

- d) harton dhe ndërmer fushata ndërgjegjësimi që inkurajojnë ndihmën, punën vullnetare dhe format e tjera të mbështetjes në favor të individëve dhe familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
- dh) harton dokumente bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me qëllim koordinimin e bashkëpunimit në mënyrë efektive;
- e) programon, si zë më vete në buxhet, fondet për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që u delegohet bashkive si transfertë në fondin social;
- ë) harton dhe miraton manuale trajnimi e edukimi për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ana e subjekteve ofruese, me qëllim zbatimin me uniformitet të ligjit;
- f) këshillon dhe udhëzon njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me strukturat që duhet të ngrihen prej tyre për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mënyrat e planifikimit e të ofrimit të shërbimeve;
- g) harton dhe paraqet për miratim nevojat për financim nga Buxheti i Shtetit për aktivitetet e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 32

Shërbimi Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
2. Statuti i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Struktura dhe organika e Shërbimit Social Shtetëror miratohet me urdhër të Kryeministrit.

Neni 33

Roli i Shërbimit Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale.
2. Shërbimi Social Shtetëror ka këto role dhe funksione kryesore:
 - a) harton dokumentacionin tip për përfituesit e shërbimeve shoqërore;
 - b) kryen vlerësimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - c) mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale;
 - ç) harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror dhe kapaciteteve të shërbimeve publike e jopublike;
 - d) trajnon personelin e njësisive të qeverisjes vendore që mbulon aspektet e shërbimeve shoqërore;
 - dh) bashkërendon procesin e hartimit të planeve sociale, duke siguruar që këto plane të përputhen me strategjitë kombëtare;
 - e) përditëson dhe mirëmban Regjistrin Elektronik Kom-

bëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet kërkuese të kujdesit shoqëror; ë) i dërgon ministrisë statistikat sociale të lidhura me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pagesat sociale.

Neni 34

Roli i Inspektoratit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

1. Inspektorati, që mbulon fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në vijim Inspektorati, është personi juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
2. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
3. Inspektorati funksionon sipas këtij ligji dhe ligjit që rregullon inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
4. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së Inspektoratit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Struktura dhe organika e Inspektoratit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 35

Funksionet dhe kompetencat e Inspektoratit

1. Inspektorati, në zbatim të këtij ligji, kryen këto funksione:
 - a) kontrollojnë zbatimin e kritereve e të kushteve nga subjektet publike dhe jopublike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore, sipas këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;
 - b) inspekton standardet e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - c) bashkëpunon dhe u jep informacione të tjera shtetërore për rastet që janë në kompetencë të tyre, në lidhje me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - ç) ushtron kontroll në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat kanë detyrimin të lejojnë dhe të vënë në dispozicion të Inspektoratit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për inspektim;
 - d) vendos gjoha dhe masa të tjera administrative ndaj subjekteve publike dhe jopublike, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji;
 - dh) i propozon ministrit përgjegjës për çështjet sociale heqjen e licencës së ofruesit të shërbimit shoqëror, i cili, brenda dhjetë ditëve, merr vendimin përfundimtar mbi propozimin e marrë;
 - e) raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale mbi rezultatet e inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
2. Inspektorati shqyrton ankesat ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore, të marra drejtpërdrejt ose të përcjella nga çdo institucion tjetër apo individ.
3. Inspektorati merr vendim, pas shqyrtimit të ankesave, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe

në përputhje me kompetencat e dhëna me këtë ligj.

4. Rregullorja e shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 36

Roli i bashkisë

1. Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj:
 - a) duke identifikuar nevojat;
 - b) duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit;
 - c) duke hartuar planin social vendor;
 - ç) duke programuar buxhetet vendore;
 - d) duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;
 - dh) duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;
 - e) duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.
2. Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror.
3. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njëسيا e vlerësimit të nevojave dhe referimit.
4. Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë.
5. Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Neni 37

Roli i punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore

- Punonjës socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë:
- a) të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve;
 - b) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar;
 - c) të marrin pjesë në procesin e hartimit të planeve të kujdesit për personat që do të trajtohen apo të cilëve u refuzohen shërbimet e kujdesit shoqëror nëpërmjet vlerësimit, ndjekjes, monitorimit dhe mbylljes së rastit;
 - ç) të përgatitin dokumentacionin dhe propozimet për miratim nga këshilli bashkiak;
 - d) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
 - dh) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë.

Neni 38*Roli i qarkut*

1. Këshilli i qarkut harton planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të njëjstëve të qeverisjes vendore dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
2. Kryetari i qarkut vendos ofrimin e shërbimeve të specializuara në bashkërendim rajonal të rasteve për shërbimet e kujdesit shoqëror të vendosura në nivel rajonal.
3. Kryetari i qarkut krijon komitetin e planifikimit të nevojave "ad hoc", të përbërë nga përfaqësues të të gjitha strukturave vendore /rajonale dhe shoqërisë civile, me pjesëmarrje vullnetare.

KREU II**AKREDITIMI DHE EDUKIMI I VAZHUESHËM****Neni 39***Akreditimi*

1. Të gjitha subjektet publike/jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe vendase, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të licencuara për ofrimin e trajnimeve e të kualifikimeve, akreditohen nga ministria përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, në mënyrë periodike, për të vlerësuar shkallën e plotësisë nga ana e tyre të standardeve të paracaktuara për to nga Këshilli i Ministrave.
2. Rregullat dhe mënyra e realizimit të procesit të akreditimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 40*Profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror*

1. Regjistrimi i profesionistëve është një proces i detyrueshëm, i cili bëhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.
2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale miraton, me urdhër, rregulloren për procedurat e regjistrimit dhe reregjistrimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 41*Urdhrat e profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror*

1. Profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror regjistrohen pranë urdhrave profesionistë përkatës dhe janë subjekt i detyrës dhe përfitimeve korresponduese.
2. Funksonimi i urdhrave të profesionistëve rregullohet me ligje të veçanta.

Neni 42*Edukimi i vazhdueshëm profesional*

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale krijon një program të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, i quajtur "Programi i certifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror", program i cili është sistem i bazuar në cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit të vazhdueshëm profesional, bazuar në pro-

cedurat, kriteret dhe standardet e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Certifikimi është procesi që profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror përfundon me përbushjen e kriterëve të secilit cikël të programit të certifikimit dhe lidhet me ecjen në karrierë të profesionistit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.

2. Profesionistët e ndihmës e të shërbimeve shoqërore janë të detyruar që t'i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve.

3. Punësimi ose kontratat në institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, pezullohen nëse profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror nuk merr asnjë kredit të edukimit të vazhdueshëm. Rifitimi i së drejtës për punësim ose lidhja e kontratave të punës me institucionet bëhet pasi profesionisti t'i jetë nënshtuar provimit të certifikimit. Nëse profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror mbledh kredite të edukimit të vazhdueshëm, por më pak se limiti i kërkuar, ai duhet t'i nënshtrohet provimit të certifikimit brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit. Nëse dështon në provim, punësimi ose kontratat në institucionet e tjera pezullohen. Rifitimi i së drejtës për punësim ose kontrata me institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, bëhet pasi profesionisti të ketë kaluar me sukses provimin e certifikimit. Institucionet publike dhe jopublike të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë të detyruara të hartojnë dhe të zbatojnë programe të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre.

4. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, u nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë të cilët nuk përbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen.

5. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve të kujdesit shoqëror.

Neni 43*Sigurimi i cilësisë së aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, akreditimi*

1. Akreditimi është procesi i miratimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm ose/dhe i ofruesit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, bazuar në procedurat, standardet dhe kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ofrues të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të gjitha strukturat publike ose jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, sipas kriterëve të miratuara.

3. Ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të detyruar të sigurojnë cilësinë e aktiviteteve që zhvillojnë, përmes respektimit të kriterëve të cilësisë e akreditimit dhe standardeve të edukimit të vazhdueshëm profesional.

4. Kriteret, standardet dhe procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm miratohen me

vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore funksionon Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe ka në përbërje një përfaqësues nga:

- a) Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;
- b) Shërbimi Social Shtetëror;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- ç) Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve;
- d) Urdhri i Infermierëve; dh) Urdhri i Punonjësit Social;
- e) Urdhri i Psikologut.

2. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm është organi më i lartë vendimmarrës në sistemin e certifikimit dhe ricertifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe të akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm. Ky bord mbledhet jo më pak se katër herë në vit dhe, për raste të veçanta, kur është e nevojshme, kryetari mund ta mbledhë atë edhe më shpesh. Mbledhjet e bordit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimmarrja në Bordin e Edukimit të Vazhdueshëm bëhet me shumicë të thjeshtë.

3. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm kryen këto funksione kryesore:

- a) harton kriteret, standardet e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm e të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe kriteret e procedurat e procesit të certifikimit dhe/ose ricertifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- b) miraton tarifën e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm;
- c) miraton listën e ekspertëve të pavarur për secilën fushë ekspertize, të cilët do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve, si pjesë e procesit të akreditimit, dhe masën e pagesës së tyre, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) shqyrton ankesat e bëra nga profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror për procedurat e njohjes e të regjistrimit të krediteve përkatëse;
- d) shqyrton ankesat e bëra nga ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për procesin e vlerësimit të jashtëm, të cilat nuk janë zgjidhur nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;
- dh) ndërmerr masat e nevojshme për realizimin e provimit të ricertifikimit për të gjithë profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror që nuk përmbushin kërkesat e programit të certifikimit;
- e) monitoron zbatimin e programit të certifikimit për të siguruar përmbushjen e detyrave të institucioneve përgjegjëse.

4. Anëtarët e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të bordeve, këshillave ose komisioneve.

KREU III

FINANCIMI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Neni 45

Burimet e financimit

Burimet e financimit për shërbimet e kujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet publike dhe jopublike, përbëhen nga:

- a) fondet e deleguara nga Buxheti i Shtetit, përfshirë fondin social;
- b) fondet nga buxhetet e njëjësive të qeverisjes vendore;
- c) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë; ç) tarifën e shërbimit për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 46

Mekanizmat e financimit

1. Njësia e qeverisjes vendore planifikon, ndërton, administron dhe mirëmban rregullisht shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara brenda territorit të saj nëpërmjet buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore.

2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale udhëzon njësitet e qeverisjes vendore për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen kundrejt pagesës së tarifave zbatojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe bëhen pjesë e paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të bashkisë. Në parim, tarifën paguhen nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror dhe synojnë të mbulojnë një pjesë të shpenzimeve korrente për njësitet e shërbimit në fjalë.

3. Tarifën e shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave, si më poshtë:

- a) kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji; b) dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.

Neni 47

Fondi social

1. Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitet e qeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale. Ndalohej përdorimi i fondit social për financimin e qëllimeve të tjera nga ato të përcaktuara në këtë pikë.

2. Fondi social përbëhet nga:

- a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit;
- b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë;
- c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror;
- ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që

zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale;

d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.

3. Mjetet financiare në fondin social, të papërdorura në vitin fiskal ushtrimor, mbarten në buxhetin e vitit pasardhës si pjesë e fondit social.

4. Procedurat e krijimit e të funksionimit të fondit social rregullohen dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 48

Fondet e financimit

1. Në lidhje me financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nga Buxheti i Shtetit, ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e vet fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen njësisive të qeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime të kujdesit shoqëror. Në këtë rast, ministri përgjegjës për çështjet sociale shpërndan dhe transferon në fillim të vitit, në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore, fondin social dhe transferta të tjera për çdo shërbim të kujdesit shoqëror, duke marrë parasysh kriterin e nevojës më të madhe dhe prioritetet e çdo njësie të qeverisjes vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve.

2. Metodologjia e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohen në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe me mundësitë e Buxhetit të Shtetit.

KREU IV

Neni 49

Sanksionet

1. Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 25, 27, pika 2, 35, 37 e 38, të këtij ligji, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe:

a) dënohen me gjobë, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative; b) ndëshkohen me masë disiplinore.

2. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, me qëllim zbatimin e legjislacionit për shërbimet e kujdesit shoqëror, vendos këto sanksione:

a) kur konstaton kundërvajtje administrative për rastet e shkeljeve të detyrimeve të përcaktuara në nenin 25, të këtij ligji, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, vendos ndaj subjekteve ofruese të shërbimeve të kujdesit shoqëror gjoba nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë dhe pezullimin e licencës së subjekteve jopublike në rast të parregullsisë të rënda ose në rast përsëritjeje;

b) për shkeljet nga ana e punonjësve të institucioneve publike zbatuese të këtij ligji të detyrimeve të përcaktuara në nenet 27, pika 2, dhe 35, të tij, nis procedimin disiplinor dhe merr masa, në përputhje me rregullat e Kodit të Punës

ose ligjin e nëpunësit civil, sipas përkatësisë së punonjësit; c) për shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 37 dhe 38, të këtij ligji, zbaton dispozitat e kundërvajtjeve administrative të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; ç) shpërblimin e dëmit, nëse është shkaktuar një i tillë.

3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror kryen gjithashtu inspektime në bazë të shkeljeve të konstatuara nga monitorimet e kryera nga Shërbimi Social Shtetëror.

4. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, kur vlerëson se janë konsumuar elementet e veprës penale nga personat përgjegjës, bën kallëzimin penal pranë autoriteteve kompetente.

5. Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore, që programohen dhe përdoren për shërbimet e kujdesit shoqëror, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

6. Për çdo masë të marrë nga Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore.

7. Të gjitha të ardhurat nga gjobat e vendosura, sipas këtij neni, derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

Neni 50

Ankimi

1. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund të paraqesë ankesë me shkrim pranë njësisë së qeverisjes vendore/Shërbimit Social Shtetëror brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së ankesës.

2. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë Inspektoratit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së përgjigjes nga njësia e qeverisjes vendore/Shërbimi Social Shtetëror, pas ezaurimit të ankimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e qeverisjes vendore/Shërbimin Social Shtetëror brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së ankesës.

4. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 51

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, pika 29; 8, pika 5; 15, pika 5; 23, pika 3; 24, pika 5; 29, pika 5; 32, pika 2; 34, pika 4; 39, pikat 1 dhe 2; 42, pika 1; 43, pika 4; 46, pika 2; 47, pika 4; dhe 48, pika

2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32, pika 3; dhe 34, pika 5, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Neni 52

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.

2. Dispozitat apo pjesët e dispozitave të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, që trajtojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, shfuqizohen.

3. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Neni 53

Shfuqizime

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, bëhen këto shfuqizime:

1. Neni 4, pikat 5, 15 dhe 16, nenet 6, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, pika 4, 22, 23 dhe 24.

2. Në pikën 1, të nenit 26, fjalët "dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat".

3. Neni 27, pika 5, shkronjat "b" e "c", pikat 6 dhe 7.

4. Neni 29, pikat 3, 4, 5, 6, 8 dhe 12.

5. Neni 31, shkronja "a", fjalët "dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror", shkronja "c", fjalët "dhe personat që do të trajtohen me shërbime të përkujdesjes shoqërore", shkronjat "ë", "f", shkronja "g", fjalët "dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesjes shoqërore", dhe shkronja "gj", të këtij neni.

6. Neni 32, neni 33, fjalët "dhe shërbimeve shoqërore", dhe nenet 37, 38, 39, 42/4.

7. Kudo në ligj, fjalët "dhe shërbimet" dhe "shërbimet e përkujdesjes shoqërore" shfuqizohen.

Neni 54

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.11.2016

Shpallur me dekretin nr. 9886, datë 6.12.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
NR 9669/2006
“PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e 20.000 zgjedhësve,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, vendosi:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar.

Neni 2
Objekti

1. Ky ligj ka si objekt:
 - a) Krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjës për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
 - b) Orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
 - c) Fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
 - ç) Sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shër-bimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në për-puthje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kom-petente për zbatimin e ligjit;

Neni 3
Përkufizimet

Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
2. “Dhunë në familje” është cdo akt dhune sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare;
3. “Pjesëtarë të familjes” janë:
 - a. Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish-bashkëshorti/ ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;
 - b. Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
 - c. Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të pa-

ra-shikuar në shkronjën b;

- ç. Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmi-jët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
- d. Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit;
- e. Fëmijët e bashkëshorteve apo partnereve bashkëjetues.
4. “Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
5. “Dhunues/e” është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, përpara organeve kompetente.
6. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën;
7. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar për-kohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

Neni 4
Subjektet

Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjithë personat e cilësuar në nenin 3 pika 3 të këtij ligji.

KREU II
ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5
Autoritetet Përgjegjëse

1. Autoriteti Kryesor Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Min-istria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta (M.P.Ç.S.SH.B.)
2. Autoritete të tjera Përgjegjëse të Linjës janë:
 - a. Njësitë e Qeverisjes Vendorë;
 - b. Ministria e Brendshme ;
 - c. Ministria e Shëndetësisë;
 - ç. Ministria e Drejtësisë;
 - d. Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 6
Detyrat e Autoritetit Kryesor Përgjegjës

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

- a) Hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- b) Financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes si edhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- c) Mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, përfshi këtu asistencë financiare si dhe shërbime mjekësore dhe sociale, sipas legjisllacionit në fuqi.

- ç) Organizimin e kurseve të trajnimit rreth dhunës në familje, me punonjësit e shërbimeve sociale që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e OJF-ve të licënuara për ofrimin e shërbimeve sociale;
- d) Mbajtjen e të dhënave statistikore për nivelin e dhunës në familje;
- dh) Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të re-habilitimit për viktimat e dhunës në familje;
- e) Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- ë) Licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit;
- f) Marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- g) Marrjen e masave për krijimin e qendrave të rritjes së fëmi-jëve, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë, ose kur prindërit e tyre kryejnë vepra dhune ndaj njëri-tjetrit
- gj) Ngritjen e një qendre kombëtare të shërbimit të përkudjesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje.

Neni 7

Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës

1. Ministria e Brendshme ka këto detyra:
- a. Krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë Drejtorive të Policisë;
- b. Trajnimin e efektivave e policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.
2. Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të krijojë kapacitetet e duhura për të ofruar ndihmë mjekësore për dhunën në familje në shërbimet e urgjencës dhe në qendrat shënde-tësore në bashki dhe komuna për:
- a) Për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje;
- b) Për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
- c) Për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokume-nacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- ç) Për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;
- d) Për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.
3. Ministria e Drejtësisë ka këto detyra :
- a) të trajtojë ekspertët mjeko-ligjore në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
- b) të trajtojë përmbaruesit në detyrën e tyre për të ekzekutuar urdhrat e mbrojtjes në mënyrë të menjëhershme, të sigurojnë përmbushjen e tyre në përputhje me nenin 23, pika 6 si dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura;
- c) të financojë mbrojtje ligjore falas sipas parashikimeve në ligj dhe të sigurojë një numër të caktuar avokatësh të trajnuar, që mund të japin një asistencë të tillë.

3/1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka këto detyra:

- a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje;
- b) përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare
4. Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkitë, Komunat) kanë këto detyra:
- a) Angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;
- b) Instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore, dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre;
- c) Ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Neni 8

Përgjegjësitë e Autoriteteve Përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përmbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga M.P.Ç.S.SH.B.
2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë, apo dhe në rastet e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes, apo urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës apo shoqëruesit të saj.
3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:
- a. Informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;
- b. Informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimit në qendrat dhe institucionet përkatëse;
- c. Sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;
- d. Vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.
4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje ose ka thyer urdhrat e mbrojtjes të lëshuar me vendim gjykatë, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.
5. Personat të cilët marrin dijeni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale duke aplikuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të K.P.
6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar si dhe të fillojnë hetimet kryesisht (sua sponte). Viktima vihet në dijeni nga

policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

7. Punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimë dhe dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët epërfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruanë fshetësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktimat japin për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim ngaviktima.

8. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin erasteve të dhunës në marrëdhëni-et familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Subjektet që mund të venë në dijeni organet përgjegjëse

1. Në rast të dhunës në familje, viktimat mund t'i drejtohen me anë të një kërkesë, stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), Njesisë përkatëse Vendore (komunë, bashki), Qendrës Shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj apo të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme.

2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

KREU III MASAT MBROJTËSE

Neni 10

Masat Mbrojtëse ndaj Dhunës në Familje

1. Mbrojtja ndaj dhunës në familje në zbatim të këtij ligji do të sigurohet me këto mënyra:

a) Duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës siç përcaktohen në nenin 3 apo sic emërtohen në urdhër;

b) Duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt apo tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës siç përcaktohen në nenin 3 apo siç emërtohen në urdhër;

c) Duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;

ç) Duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës siç përcaktohen në nenin 3, pika 3 apo siç emërtohen në urdhër;

d) Duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm apo të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga

viktimat me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) Duke vendosur menjëherë viktimë/at dhe të miturit në strehime të përkohshme duke mbajtur parasysht në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

e) Duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të takohet me fëmijën e viktimës sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

f) Duke i ndaluar të paditurit/ët (dhunuesit/es) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

g) Duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjësi i rendit ose përmbarues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin/ën (dhunuesin/en) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

h) Duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të sekuestrojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij.

i) Duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku me viktimën dhe dhunuesin/ja ose ndonjë pjesë të saj;

j) Duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

k) Për sa kohë urdhri mbrojtës do të jetë në fuqi, trajtimi i pasurisë do të kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57-58 dhe 60.

l) Duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurin/ën (dhunuesin/en);

ll) Duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit apo pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;

m) Duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

n) Duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

nj) Duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të marrë pjesë në programe rehabilitimi; nëse i padituri/a (dhunuesi/ja) urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek, apo merr pjesë në të. Nëse i padituri/a (dhunuesi/ja) nuk merr pjesë, atëherë me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të Kodit penal, për pengimin e ekzekuti-

mit të vendimeve të gjykatës.

2. Në urdhrin e mbrojtjes të lëshuar me vendim gjykate mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar me vendimin e gjykatës, mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në pikat a-h të këtij neni

5. Në rastin e zbatimit të shkronjës (h) të këtij neni, vendimi i gjykatës parashikon:

a. pezullimin e lejes së armës deri në plotësimin e afatit të urdhrin të mbrojtjes, si dhe njoftimin e autoritetit përkatës administrativ, nëse arma është sekuestruar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje.

b. kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes.

Neni 11

Efektet e Urdhrit të Mbrojtjes

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucioni tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRIT TË MBROJTJES

Neni 12

Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar. Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, Gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje, dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës sipas rasteve, kon-form dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 13

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:

a. Vetë viktimia;

b. Përfaqësuesi ligjor ose Avokati i viktimës;

c. Policia / Prokuroria.

2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:

a. Prindi ose kujdestari i të miturit;

b. Përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;

c. Të afërmit;

ç. Përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë ose Komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimia, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

d. Qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/liçencuara nga M.P.C.S.SH.B.

dh. Policia/prokuroria;

e. Personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.

3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:

a. Vetë viktimia;

b. Përfaqësuesi ligjor ose Avokati i viktimës;

c. Policia/Prokuroria;

ç. Personi me të cilin viktimia ka marrëdhënie familjare:

d. Përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë ose Komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimia, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës.

dh) Qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/liçencuara nga M.P.C.S.SH.B.

4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga Policia/Prokuroria, tër-heqja e viktimës nga procesi, nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 14

Forma e Kërkesë-Padisë

1. Kërkesë-padia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:

a) Të dhëna personale, rreth familjes ose marrëdhënieve fafaisnore mes viktimës dhe dhunuesit;

b) Përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cënimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i padituri/a (dhunuesi/ja) të parashikuara në nenin 3, pika 1 dhe 2 të këtij ligji

c) Masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;

ç) Nënshkrimin e kërkuesit.

2. Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimo-hen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pra-në komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë do të veprojë në përputhje me ligjin "Për Policinë e Shtetit".

3. Për hartimin e kërkesë-padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat fa-las. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike u njoftojnë gjykatave listën e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike falas.

4. Kërkuesi shkarkohet nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbare shtetërore, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi. Me lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që kaushtruar dhunë në familje.

5. Kërkesë-padia regjistrohët në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj.

Neni 15

Provat në Procesin Gjyqësor

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-eksperimenti, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF) të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.

2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisaritetet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkrese lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.

3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 16

Gjykimi për Lëshimin e Urdhrin të Mbrojtjes

1. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes brenda 15 ditësh pas pranimit të kërkesës.

2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhrin mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:

- Viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
- Të Paditurin/en (Dhunuesin/en), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
- Prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
- Përfaqësuesit e policisë;
- Përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë njësive në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;
- Punonjësit e Qendrave Shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;
- Dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm,

3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga Policia/Prokuroria, tër-heqja e viktimës nga procesi, nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 17

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhrin mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:

a) Ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje (parashikuar në nenin 3 të këtij ligji);

b) Lëshimi i urdhrin të mbrojtjes me vendim gjyqësor është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave, urdhrin në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të K.Pr.C. përmban:

- Masën e caktuar nga gjykata;
- Kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;
- Njoftimin se shkelja e urdhrin të mbrojtjes të lëshuar me vendim gjyqësor përbën vepër penale në kuptim të Nenit 320 të K. P.;

ç) Njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrin të mbrojtjes të lëshuar me vendim gjyqësor brenda 15 ditësh nga shpallja apo marrja dijeni e tij;

4. Urdhri i mbrojtjes i lëshuar me vendim gjyqësor i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të K.Pr.C. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrin ta verë në dis-pozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orësh pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes me vendim gjyqësor u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

- Viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
- Prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;
- Zyrës së Shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
- Komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Neni 18

Gjykimi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:

- të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;

b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjojnë personat në vijim:

a. Viktima, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;

b. Dhunuesi/ja, përfaqësuesi apo avokati i tij/saj;

c. Prokurori nëse merr pjesë;

ç. Kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 15 të këtij ligji;

d. Dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 19

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:

a. Ekzistojnë bazat për të besuar se i/e padituri/a (dhunuesi/ ja) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje, ose

b. I/e padituri/a (dhunuesi/ja) paraqet kërcënim të drejt-përdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, ose

c. Lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës që mbrohen me anë të urdhrin të mbrojtjes.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të menjëher-shëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të K.Pr.Civ përmban:

a. Masën e caktuar nga gjykata;

b. Kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;

c. Njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën vepër penale, në kuptim të nenit 320 të K.P.;

ç. Njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditësh nga shpallja apo marrja dijani e tij;

d. Datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëher-shëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditësh prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i lëshuar me vendim gjykate i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të K.Pr.Civ. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vehte dhe tjetrën ta verë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orësh pas lëshimit të tij u dërgon nga një kopje të vendimit personave në vijim:

a. Viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b. Kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;

c. Zyrës së Shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç. Komisarariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

d. Zyrave përmbare të vendit të ekzekutimit.

6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga Zyra e Përmbaremit sipas dispozitave të Kodit të Proedurës Civile (neni 510/e, 516/c e vijues).

Neni 20

Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

1. NPas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes mbi bazën e kërkesës në zbatim të nenit 16 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata:

a. Vendos anulimin si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;

b. Refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i lëshuar më parë me vendim gjykate;

c. Lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykate.

Neni 21

Ankim

1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankim i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate mund të bëhet ankim brenda afat-eve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrin të mbrojtjes.

Neni 22

Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktima (përfaqësuesi i saj), dhunuesi, ose prokurori nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes.

2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a. Lënien në fuqi të urdhrin të mbrojtjes;

b. Ndryshimin e urdhrit të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht ose

c. Ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10, pika 1 të këtij ligji nuk vlejné më për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshim-in e urdhrit për mbrojtje.

4. Viktima ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, mund të parashtojë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrohet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.

5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit, gjykata vendos:

a. Vërtetimin e ndërprerjes së urdhrit të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij, ose,

b. Vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, nëse vlejné kriteret e përcaktuara në nenin 17 ,pika 1 të këtij ligji.

Neni 23

Ekzekutimi i Vendimit Gjyqësor

1. Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv, që në momentin që shpallet. (ose iu njoftohet palëve). Gjkata lëshon një urdhër ekzekutimi në të njëjtën kohë që lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

2. Vendimi gjyqësor që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekuto-het menjëherë nga Përmbauesit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Komisaritet e Policisë dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vull-netarisht. Gjkata lëshon urdhrin e ekzekutimit në të njëjtën kohë që lëshon dhe urdhrin e mbrojtjes.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e liçensuara për ofrim shërbimesh zbatojné masat e parashikura në vendimin gjyqësor dhe koordinojné punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe Drejtoritë e policisë si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

5. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga Zy-rat e Shërbimit Përmbaues, konform dispozitave të K.Pr.Civile (neni 510 e vijues).

6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga organet zbatuese të vendimit të gjykatës siç përshkruhet në pikën 2 dhe 4 të këtij neni, përfshirë dhe të paditurin, të cilëve iu komunikohet vendimi, ndiqet ekzekutimi i detyruar në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto raste, ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës ap-likohen sanksionet përkatëse të parashiku-

ra në nenin 320, 320/a të Kodit Penal, ashtu edhe sanksionet e parashikuara në nenin 606/3 të K Pr Civile.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Procedimi Penal

Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, përsa i përket veprimeve apo mosvepri-meve që përbëjnë figura të veprave penale.

Neni 25

Aktet Nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 26

Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

VENDIM**Nr.334, datë 17.2.2011****“PËR MEKANIZMIN E BASHKËRENDIMIT
TË PUNËS PËR REFERIMIN E RASTEVE TË
DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE
DHE MËNYRËN E PROCEDIMIT TË TIJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 8 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**I. Mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare**

1. Mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve

- a) Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;
- b) Ekipet teknike ndërdisiplinore;
- c) Koordinatorët vendorë për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

2. Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së in-stitucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, funksionojnë pranë çdo bashkie.

3. Komitetet drejtuese kryesohen nga kryetari i bashkisë dhe në përbërje kanë:

- a) Përfaqësuesin e strukturës së policisë;
- b) Përfaqësuesin e gjykatës së rrethit gjyqësor;
- c) Përfaqësuesin e prokurorisë së rrethit; ç) Përfaqësuesin e drejtorisë arsimore;
- d) Përfaqësuesin e Drejtorisë së Shëndetit Publik;
- dh) Drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale, pranë bashkisë;
- e) Përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale, në komunë;
- ë) Përfaqësuesin e zyrës së përmbarimit;
- f) Përfaqësuesin e prefekturës;
- g) Kryetarët e komunave që janë në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki;
- gj) Përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit;
- h) Drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtari-në e tyre merren me çështje të dhunës në familje;
- i) Drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë;
- j) Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- k) Drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit.

4. Përfaqësuesit në komitetet drejtuese janë në nivel dre-

jtue-sish, nëse pranë bashkive ku këtokomitete ngrihen, funksionojnë institucione të sistemit të drejtësisë, të strukturave arsimore, shëndetësore dhe të punësimit. Nëse pranë bashkive nuk funksionojnë institucionet esipërpërmendura, institucionet që funksionojnë në qendrën e prefekturës dër-gojnë përfaqësues të tyre në komitetet e këtyre bashkive.

5. Përzgjedhja e drejtuesve të organizatave jofitimprurëse bëhet nga kryetari i bashkisë në bashkëpunim me drejtuesin e strukturës së shërbimeve sociale të kësaj njësie të qeverisjes vendore, në përfundim të një procedure konkurrimi të hapur.

6. Komiteti drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së in-stitucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, është një komitet-koordinues ad-hoc, veprimtaria e të cilit konsiston në:

- a) identifikimin e problemeve për dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, në territorin e bashkisë dhe komunave, brenda të cilit ush-trajnë kompetencat anëtarët e tij, si dhe propozimin autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror/vendor për mënyrën e zgjidhjes së tyre;
- b) vlerësimin e punës së ekipit teknik ndërdisiplinor mbështetëtur në informacionet dhe raportet periodike të paraqitura nga ky ekip për çdo rast, si dhe marrjen e vendimeve përpërmirësimin e funksionimit të tij;
- c) miratimin në parim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore, për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar;
- ç) organizimin e trajnimeve të përbashkëta ndërdisiplinore të personelit në varësi të tyre, të cilët merren me çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe sigurimin për njohjen eqytetarëve me funksionet e komitetit drejtues dhe të strukturave të tjera teknike të rrethit, si dhe memënyrat e kontaktimit të tyre;
- d) miratimin e rregullave e të procedurave të funksionimit të ekipit teknik ndërdisiplinor.

7. Komiteti drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së in-stitucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, çdo tre muaj, i raporton Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për veprimtarinë e tij, të dhënat dhe problematikën e dhunës në familje, në territorin ku ai shtrin juridiksionin e tij, duke paraqitur në këtë raport edhe propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga institucionet qendrore. Përfaqësuesit e autoriteteve të tjera shtetërore në nivel vendor raportojnë, çdo tre muaj, në institucionet e tyre qendrore për veprimtarinë e tyre në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Në raportimet periodike që paraqiten, komiteti drejtues ku-jdeset që të

ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

8. Rregullat dhe procedura e funksionimit të komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, përcaktohen në rregulloren e miratuar për këtë qëllim nga këshilli i bashkisë.

9. Me vendim të komitetit drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, përcaktohet ekipi teknik ndërdisiplinor, me përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuara në këtë komitet, përfaqësues të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asajnjësie të qeverisjes vendore, si dhe nga profesionistë të lirë (avokatë, psikologë etj.), i cili ka këtodetyra:

- a) ndjekjen e rastit dhe plotësimin e nevojave të viktimave, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimet e përshatshme;
- b) koordinimin dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve;
- c) menaxhimin e rasteve;
- ç) përcjelljen e të dhënave për rastet konkrete të drejtuesit të ekipit teknik ndërdisiplinor;
- d) monitorimin dhe raportimin në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

10. Pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asajnjësie të qeverisjes vendore, i cili:

- a) drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet ekëtij ekipi, si dhe informon për ecurinë e punës së tij komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;
- b) koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor sipas përcaktimeve në pjesën I, pika 2, për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, dhe siguron burime ose shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme;
- c) shërben si ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/organizata referimi, për të dhënë informacion për t'i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;
- ç) asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhri shkelet;
- d) shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe pranë shërbimeve të tjera;
- dh) harton një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore,

ju-ridike falas, strehim etj.) dhe e rifreskon atë vazhdimisht; e) sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni rreth klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar;

ë) përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor, në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave, si dhe ndan një herë në muaj një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e këtij ekipi. Për këtë qëllim, secili anëtar i ekipit ndërdisiplinor ka përgjegjësi që

të përcjellë te koordinatori një herë në dy javë informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij/saj, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore, apo është trajtuar vetëm brenda për Brenda institucionit të vet;

f) organizon dhe monitoron takime për menaxhimin e rasteve;

g) sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuara ngagjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, si dhe sigurohet që të kryhen të gjitha llojet e ndërhyrjeve të nevojshme në përputhje me ligjin;

gj) koordinon organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga struktura përgjegjëse për dhunë në familje e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin;

h) mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuuese për dhunë;

i) harton marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip, bashkëngjitur këtij vendimi, dhe ia propozon ato komitetit drejtues për miratim në parim;

j) paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhjen nga komiteti drejtues;

k) identifikon protokolle ekzistuese në komunitet ose marrëdhënie informale bashkëpunimi që janë të suksesshme;

l) propozon në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së qeverisjes vendore, pranë secilës funksionon, krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

11. Administratori shoqëror i zyrës së shërbimeve sociale pranë komunës, do të bëjë referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të cilat kanë ndodhur në ko-

munë, në ekipinteknik ndërdisiplinor të ngritur në bashki, në juridiksionin e së cilës është komuna.

II. Procedura për ndërhyrjen në ndihmë të viktimave të dhunës në familje

1. Viktima e dhunës në familje ose çdo person që konsiston një rast të ushtrimit të dhunës nëfamilje, mund të drejtohet për ndihmë të:

- a) çdo strukturë vendore e autoriteteve përgjegjëse shtetërore, të përcaktuara në pikën 2 tënenit 5 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, tëndryshuar, që ushtrojnë vep-primtarinë e tyre në territorin ku shtrin juridiksionin e saj bashkia;
- b) prokuroria;
- c) gjykata;
- ç) një avokat;
- d) një OJF e specializuar në këtë drejtim;
- dh) koordinatori i dhunës në familje pranë njësisë së qever-isjes vendore;
- e) specialist i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë bashkisë;
- ë) psikologu i shkollës.

2.Për rastet që kërkojnë ndërhyrje emergjente, pavarësisht se në cilin prej institucioneve, tëpërcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, drejtohet viktima e dhunës, secili prej tyre ka detyrimin tënjoftojë koordinatorin vendor të dhunës, me qëllim mbër-ritjen e tij së bashku me policinë nëvendngjarje dhe trajtimin e menjëhershëm të rastit të dhunuar, sipas detyrave që për-cakton ligjinr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, përsecilin autoritet përgjegjës.

3.Koordinatori vendor i dhunës për rastet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu, së bashkume përfaqësuesin e policisë, bëjnë analizën paraprake të ngjarjes që përfshin: një intervistë kokë mëkokë me viktimën, me abuzuesin, si dhe me anëtarë të tjerë të familjes, vlerësim të nivelit të dhunës,dokumentim të fakteve, plotësimin e formularit standard, shoqërimin në institucionet e shëndetitparësor (nëse është e nevojshme), transportimin e viktimës së dhunës në një vend të sigurt. Dypërfaqësuesit e sipërcituar të ekipit ndërinstitutional do të përcaktojnë se cilët anëtarë shtesë dhecilat burime nevojiten për ndërhyrjen e parë dhe/ose të menjëhershme.

4. Pas dhënies së ndihmës së parë viktimës së dhunës, sipas pikave 2 e 3 të këtij kreu,koordinatori i dhunës sht-ron rastin për shqyrtim në mbledhjen e ekipit teknik ndërdisiplinor.

5. Për rastet që nuk kërkojnë ndërhyrje emergjente, institucionet/ organizatat e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, duke res-pektuar vullnetin e viktimës së dhunës (së rritur), njoftojnëkoor-dinatorin vendor të dhunës, i cili sht-ron rastin për shqyrtim në mbledhjen e ekipit teknikndërd-isiplinor.

6. Në mbledhjet e thirrura sipas pikave 4 e 5 të këtij kreu, anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor, hartojnë një plan të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar.

III. Dispozita të përgjithshme

1.Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për mbikëqyrjene zbatimit të këtij vendimi.

Pjesë nga ligji**Nr. 23/2012, datë 1.3.2012****“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 7895, DATË 27.1.1995 “KODI PENALI
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 6

Në nenin 30 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje: “10. Humbja e përgjegjësisë prindërore.”.

Neni 7

Pas nenit 43 shtohet neni 43/a me këtë përmbajtje:

*Neni 43/a**Humbja e përgjegjësisë prindërore*

Humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës ose sibashkëpu-nëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale.”.

Neni 12

Në nenin 113 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje: “Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”.

Neni 15

Pas nenit 121 shtohet neni 121/a me këtë përmbajtje:

*Neni 121/a**Përndjekja*

Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmiose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.”.

Neni 16

Në nenin 124/b paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja,”

Neni 17

Pas nenit 130 shtohet neni 130/a me këtë përmbajtje:

*Neni 130/a**Dhuna në familje*

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojëcenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërtose krushqi e afërtautorine veprës penale, me pasojëcenimineintegritetitpsikikëtij, dënohet-me burgimgjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetuesapo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësitë përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po këto vepra të kryera në mënyrë të përsëritur dënohen me burgim nga një vit gjer në pesë vjet.”.

Neni 44

Në nenin 321, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet.”.

LIGJ
Nr. 18/2017
“PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimin të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;
- b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;
- c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;
- ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;
- e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia” nënkupton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
2. “Autoritet përgjegjës” është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat,

brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, kryen/jnë dhe mbulon/jnë shërbime të specializuara e profesionale për fëmijën.

3. “Dhunë ndaj fëmijës” është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. “Fëmijë i pashoqëruar” është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.

6. “Fëmijë në nevojë për mbrojtje” është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individit nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

7. “Këshilli” nënkupton Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

8. “Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

9. “Ndëshkimi trupor” është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim të fëmija, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të.

10. “Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

11. “Përmbajtje të dëmshme për fëmijën” janë çdo pamje, imazh dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.

12. “Përfaqësues procedural” është personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës

dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.

13. "Pjesëmarrja e fëmijës" është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes aktive të fëmijës dhe i respektimit të së drejtës së tij për t'u shprehur e për t'u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.

14. "Prind" është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

15. "Sistemi i integruar i mbrojtjes" është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësisë dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

16. "Shërbimi psiko-social shkollor" është shërbimi që u ofron mbështetje nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore për identifikimin dhe trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të komunitetit shkollor, i cili sigurohet nga njësitë arsimore vendore.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- fëmijën me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- fëmijën me shtetësi shqiptare, i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Neni 5

Parime të përgjithshme

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

- Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.
- Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
- Barazia dhe mosdiskriminimi.
- Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
- Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
- Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
- Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektorale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.

8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.

9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.

10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Neni 6

Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

- nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
- mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

KREU II

TË DREJTAT E FËMIJËS

Neni 7

E drejta e jetës

1. Mbrojtja e jetës së fëmijës është e garantuar me ligj. Fëmija gëzon standardet më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit.

2. E drejta e aksesit të fëmijës tek institucionet e kujdesit shëndetësor garantohet pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, racës, etnisë dhe aftësisë ose situatës ekonomike, sociale e ligjore të prindërve apo kujdestarit.

3. Çdo fëmijë që ka nevojë për shërbim shëndetësor ose trajtim mjekësor apo rehabilitues në situata emergjence, vetë ose nëpërmjet prindërve apo kujdestarit, ka të drejtë t'u drejtohet institucioneve të kujdesit shëndetësor ose social për këtë qëllim. Personi ose autoriteti përgjegjës, brenda fushës së kompetencave që ka, i ofron fëmijës ndi-

hmën e menjëhershme dhe e referon atë në institucionin e kujdesit shëndetësor ose rehabilitues më të përshtatshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prindit ose kujdestarit.

4. Në raste përjashtimore, kur jeta e fëmijës rrezikohet ose ka një rrezik për pasoja serioze në jetën dhe shëndetin e fëmijës, mjeku ka të drejtë të kryejë ekzaminimin dhe të japë ndihmën mjekësore, si nevojë imediate për të shpëtuar jetën e fëmijës, edhe nëse prindërit ose kujdestari nuk japin pëlqimin.

Neni 8

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajturi identitetin

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:

a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

b) të ketë një emër;

c) të fitojë shtetësinë;

ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.

2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.

3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihi mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:

a) gjetjen e prindërve;

b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkuar, me qëllim bashkimin familjar;

c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, punonjësi i strukturës së mbrojtjes së fëmijës, kryesisht ose pas marrjes së mendimit të strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale, cakton menjëherë një ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas këtij ligji.

6. Kur fëmija braktiset nga nëna në maternitetet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, personeli social dhe mjekësor i tyre, brenda 24 orëve nga zhdukja e nënës, njofton me telefon dhe me shkrim njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor dhe policinë, në të njëjtën kohë e mënyrë. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë

pushtetit vendor, në bashkëpunim me punonjësin e policisë, përgatisin raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët. Nëse gjendja shëndetësore e fëmijës është e mirë, bazuar në raportin e hartuar, njësia e brojtjes së fëmijës, pranë pushtetit vendor, merr masa për vendosjen e fëmijës, përkujdesje alternative, sipas nenit 57 të këtij ligji.

7. Në rast se identifikohet njëri nga prindërit, njësia e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor ofron këshillim, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes. Nëse nëna nuk identifikohet pas hetimit të policisë, punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas pikës 6, të këtij neni, vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.

8. Institucionet e kujdesit shëndetësor, të shërbimit social, shërbimet rezidenciale, si dhe të gjithë personat juridikë e fizikë që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, njoftojnë me shkrim punonjësin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ushtrojnë aktivitetin, i cili, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të pushtetit vendor, ndërmerr veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës.

9. Rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor, parashikohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 9

E drejta për të qëndruar me prindërit

1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore.

2. Fëmija, në çdo rast, ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi ose pëlqimi nga gjykata, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

5. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet prindërve, lidhur me mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre për të

mbajtur kontakte me fëmijën, gjykata vendos një ditë të përcaktuar me orare, sipas moshës së fëmijës, intensitetit të lidhjes emocionale që fëmija ka me prindin, me të cilin nuk bashkëjeton, sjelljen e këtij të fundit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme për vendimmarrjen e gjykatës në secilin rast. Ky kriter ndiqet nga gjykata edhe në përcaktimin e kontakteve të fëmijës me persona të tjerë të afërt me të.

6. Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:

a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;

b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;

c) banimit të përkohshëm të fëmijës te një i afërm ose person, i cili nuk jeton rregullisht me fëmijën;

ç) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;

d) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;

dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.

7. Për të siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve personale të fëmijës me prindërit ose me

persona të tjerë, me të cilët ai gëzon një jetë familjare, si dhe me qëllim kthimin e fëmijës në banesën e tij pas përfundimit të vizitës ose lejjimit të fëmijës për t'u takuar me prindin tjetër, sipas vendimit të gjykatës, kjo e fundit, me kërkesë të prindit të interesuar ose të personit të ngarkuar me mirërritjen e fëmijës, mund të vendosë marrjen e këtyre masave ose garancive:

a) gjobë për vonesë ndaj personit që refuzon të zbatojë orarin e caktuar për mbajtjen e kontakteve me fëmijën;

b) garanci pasurore ndaj prindit që nuk respekton vendimin e gjykatës, kur është e mundur, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

8. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtar i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, arrestuar, burgosur, internuar, dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij.

9. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendqëndrimin e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur një gjë e tillë dëmton mirëqenien e fëmijës. Në rast të mosdhënies së informacionit, prindi ose anëtarë të tjerë të familjes kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos nëse mosdhënia e informacionit është e bazuar.

10. Në rast se prindërit nuk bien dakord për vendbanimin e

fëmijës, gjykata vendos për vendbanimin e tij, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, si dhe mban në konsideratë:

a) vullnetin e secilit prind për të përfshirë prindin tjetër në vendime që lidhen me fëmijën dhe të mbikëqyrë të drejtat prindërore të tjetrit;

b) historikun e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës dhe secilit prind, duke përfshirë masën dhe mënyrën se si i kanë plotësuar detyrimet prindërore secili prej tyre kundrejt fëmijës;

c) vullnetin e secilit prind për të lejuar tjetrin të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

ç) statusin e banesës të secilit prind në 3 vitet e fundit;

d) historikun e veprimeve të dhunshme ndaj fëmijës ose ndaj personave të tjerë;

dh) distancën ndërmjet banesës së secilit prind dhe institucioneve të edukimit që ndjek fëmija;

e) mendimin e fëmijës;

ë) vendbanimin e motrave dhe vëllezërve të fëmijës.

11. Këto aspekte mbahen parasysh edhe në rastet kur vendbanimi i fëmijës caktohet pranë institucioneve të tjera të rritjes dhe edukimit ose në rast të mbrojtjes që i ofrohet fëmijës në nevojë për mbrojtje.

Neni 10

E drejta për ribashkim familjar

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Në rast se prindërit janë migrantë të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija ka fituar shtetësinë shqiptare, prindërit lejohen të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë e të mos largohen nga vendi.

Neni 11

E drejta për t'u zhvendosur nga vendbanimi ose për të siguruar kthimin në vendin e origjinës

1. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjykate, pasi të jetë marrë mendimi ose pëlqimi i fëmijës.

2. Mendimi ose pëlqimi i fëmijës merret në konsideratë për çështje që lidhen me kthimin e tij në vendin e origjinës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Me qëllim që fëmija të shprehë mendimin e tij, atij i ofrohet informacion i plotë lidhur me situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që mund t'i ofrohen në vendin e origjinës.

3. Fëmija i pashoqëruar nga prindi ose kujdestari ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë pranë tyre. Kthimi në vendin e origjinës bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të fëmijës, parim, i cili mbahet parasysh gjatë të gjithë procesit. Në këto raste vlerësohen aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritimin e tij në vendin ku do të kthehet, si dhe mundësitë e tij për të

ruajtur identitetin, kombësinë, emrin dhe lidhjet familjare, duke marrë parasysh mendimin ose pëlqimin fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

4. Prindi, kujdestari i fëmijës, ose çdo person që merr dijeni për humbjen e tij, duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës.

5. Për rastet që përfshijnë fëmijët e pashoqëruar, shërbimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ndërsa, për rastet që përfshijnë fëmijët e shoqëruar vetëm nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër, njoftohet Ministria e Drejtësisë. Këto organe marrin masa të menjëhershme për kthimin e fëmijës në Shqipëri, sipas rregullave të ligjit nr. 9446, datë 24.11.2005, "Për ratifikimin e Konventës mbi Aspekte Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës".

6. Procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 12

Liria e shprehjes

1. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti ose me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

2. Fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik, siguria kombëtare ose nderi e dinjiteti apo të drejtat e të tjerëve.

Neni 13

E drejta për t'u dëgjuar

1. Fëmijës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit.

2. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse që lidhen me hartimin e zbatimit e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

3. Fëmija, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, ka të drejtë të ankohet vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit të tij kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kur fëmija e ushtron vetë këtë të drejtë, punonjësit e administratës së shërbimit civil ose të administratës gjyqësore kanë detyrimin t'i japin këshillimin e nevojshëm.

Neni 14

E drejta e informimit

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj infor-

macioni në lidhje me mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik e psikologjik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Fëmija ka akses në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për të.

Neni 15

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.

2. Prindi ose kujdestari i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në zgjedhjen e një besimi fetar, pasi ka marrë në konsideratë mendimin e tij dhe pa ushtruar forcë në zgjedhjen e fëmijës, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.

3. Nëse fëmija ndodhet në kushtet e mbrojtjes, personat që janë ligjërisht përgjegjës për të ndalohen të marrin masa të tilla, që ndikojnë në besimin fetar të fëmijës.

Neni 16

Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore

1. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore. Ndalohet detyrimi i fëmijës për tubim në kundërshtim me vullnetin e tij.

2. Ushtrimi i kësaj lirie bëhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

3. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat mbikëqyrin nëse kjo e drejtë garantohet nga institucionet përgjegjëse, sipas këtij ligji dhe, në rast mosrespektimi, njoftojnë organet e policisë për marrjen e masave konkrete, sipas legjislacionit në fuqi, duke mbajtur në vëmendje sigurinë e fëmijës gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.

4. Mosrespektimi i detyrimit të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

Neni 17

Liria e jetës private

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.

2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

3. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.

4. Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike, si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës.

5. Fëmijët nuk mund të përdoren apo të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike apo private për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e

autoriteteve publike.

6. Mosrespektimi i këtij ndalimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

7. Transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të lirive dhe të drejtave të fëmijës gjatë transmetimit të programeve të tyre, në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

8. Rastet përjashtimore nga mbrojtja e privatësisë bëhen vetëm nëse i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 18

E drejta për arsimim

1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimimit të detyrueshëm.

2. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:

a) të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm

falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;

b) të zhvillojnë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, programe edukimi për prindërit, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;

c) të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrin nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;

ç) të organizojnë plane mësimore të veçanta edukimi për fëmijët që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, ose pranë institucioneve joshkolllore, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;

d) të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;

dh) të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;

ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;

f) të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimimit të fëmijës që i përket grupeve ose rajon-

eve me mangësi të konsiderueshme edukimi ose që është në situata të vështira sociale, ekonomike ose gjendje fizike apo mendore të veçantë, ose që lidhen me aspekte të gjinisë, besimit fetar ose praktikave kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor etnik ose vijnë nga një situatë migratore;

g) të ngrenë mekanizma efikasë për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);

gj) të parashikojnë dhe zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.

h) të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë.

4. Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mosregjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, pranë pushtetit vendor merr masa të menjëhershme për regjistrimin të fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara.

6. Fëmija ka të drejtë të ankohet ndaj vlerësimeve të dijeve të tij, sipas kritereve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar.

Neni 19

E drejta për pushim dhe argëtime kulturore e sportive

1. Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën e tij.

2. Autoritetet publike qendrore e vendore, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët. Ato krijojnë hapësira të nevojshme, brenda mundësive, për lojërat e fëmijës. Këto masa përfshijnë:

a) miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, si dhe të akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe aksesin e sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike;

b) vendosjen e standardeve të sigurisë dhe aksesimit për të gjitha mjediset çlodhëse e këndet e lojërave, me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit;

c) krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive

sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare;
 ç) hartimin e kurrikulave shkollore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.

Neni 20

E drejta për nivel jetese të përshtatshëm

1. Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
2. Prindi ose kujdestari kanë detyrimin dhe përgjegjësinë parësore për t'i siguruar, brenda aftësive dhe mundësive financiare që ata kanë, kushtet më të mira të jetesës, të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.
3. Çdo fëmijë gëzon të drejtën e aksesit në programe për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, duke përfshirë aksesin në çerdhe, kopshte ose programe të tjera zhvillimi, si dhe të drejtën e ushqimit gjatë ndjekjes së këtyre programeve, sipas standardeve të parashikuara në akte nënligjore.
4. Organet e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet përgjegjëse në varësi të tyre marrin masat e nevojshme për të ndihmuar prindin ose kujdestarin të ushtrojë këtë të drejtë, në rast se ka nevojë për asistencë materiale ose programe mbështetëse.

Neni 21

E drejta për kujdes shëndetësor

1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor falas dhe e standardit më të lartë, si dhe përfitimi nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet, pavarësisht nëse fëmija është i regjistruar ose jo në regjistrin e gjendjes civile ose nëse prindërit e fëmijës kanë paguar ose jo taksat.
2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, e cila merr masa:
 - a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;
 - b) për t'u siguruar të gjithë fëmijëve kujdesin shëndetësor falas e cilësor, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;
 - c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;
 - ç) për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;
 - d) për të mundësuar, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, që të gjitha grupet shoqërore dhe, në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe përmirësimin e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;
 - dh) për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues dhe për të nxitur jetesën e shëndetshme të fëmijët, këshillimin e prindërve dhe fëmijës, edukimin dhe shërbimet në fushën e shëndetit riprodhues për prindërit dhe fëmijët, në

- varësi të moshës dhe aftësisë së tyre për të kuptuar;
- e) për verifikimin periodik të trajtimit që i bëhet fëmijës së vendosur në institucione të kujdesit shëndetësor ose në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme, me vendim të gjykatës;
 - ë) për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë dhe pas ekzaminimit mjekësor të fëmijës, ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur rrezikohet shëndeti ose jeta e fëmijës, sipas nenit 67 të këtij ligji;
 - f) për ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor për fëmijët me aftësi të kufizuar, me qëllim riaftësimin dhe përfshirjen sociale të tyre, si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë si të gjithë fëmijët.
3. E drejta e fëmijës për të pasur akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe të rehabilitimit, si dhe marrja e mjekimit të përshtatshëm për sëmundjen që ka garantohet nga shteti dhe shpenzimet mbulohen nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.
 4. Prindërit kanë detyrimin të kërkojnë kujdes mjekësor, me qëllim që fëmija të gëzojë standardin më të lartë shëndetësor, si dhe për të parandaluar situata që mund të jenë të rrezikshme për jetën, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.
 5. Vizitat periodike të punonjësve të konsultores së nënës dhe fëmijës në banesën e gruas shtatzënë dhe fëmijës deri në moshën 1 vjeç janë të detyrueshme. Ato kryhen sipas paketës bazë të shërbimeve të kujdesit parësor e protokolleve standarde për këto shërbime dhe bëhen me qëllim mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës, duke përfshirë këshillimin për mirërritjen e fëmijës, parandalimin dhe shmangien e braktisjes së fëmijës, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhimin ose çdo lloj tjetër dhune ndaj fëmijës.

Neni 22

E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror

1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë nga shërbimi i kujdesit shoqëror, drejtpërdrejt apo nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.
2. Në rast se prindi/prindërit ose personi/personat që kujdesen për fëmijën nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për shkaqe që nuk varen prej vullnetit të tyre, nevojat minimale të fëmijës për strehim, ushqim, veshmbathje dhe edukim, ofrohen nga shteti, kur kjo kërkohet prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.
3. Çdo institucion publik ose jopublik që ushtron aktivitet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës ka detyrimin t'u japë prindërve të gjithë informacionin e nevojshëm për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

1. Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht ven-

dit ku kryhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Fëmija mbrohet edhe nga të gjitha format e migracionit të paligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

2. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me institucionet e kujdesit shëndetësor, të edukimit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës viktimë e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Subjektet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin e vetëvendosjen e fëmijës, në përputhje me moshën e tij.

4. Ndalohet ndëshkimi trupor ose i ndonjë forme tjetër, që sjell pasoja në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Neni 24

Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik

1. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që:

- paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor;
- cenon edukimin;
- është e detyruar.

2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës.

3. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune të detyruar brenda familjes së tij, në shkollë, institucione të rehabilitimit dhe dënimit, ose në aktivitete kulturore, artistike, sportive, modelimi ose për qëllime reklamuese, që paraqet rrezik, cenon edukimin, dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

4. Ndalohet çdo praktikë, nëpërmjet së cilës fëmija detyrohet të kryejë veprime të përmendura në pikat 2 e 3, të këtij neni, pavarësisht dijenisë ose jo të prindit ose kujdestarit, si dhe pavarësisht faktit nëse është apo jo kundrejt shpërblimit.

5. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.

Neni 25

Mbrojtja nga përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotikedhe i lëndëve psikotrope

1. Fëmija mbrohet nga:

- përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope;
- prodhimi dhe trafiku i paligjshëm i këtyre substancave.

2. Ndalohet shitja e përzierësve ose tretësve për prodhimin

ose përdorimin e substancave narkotike e psikotrope, duhanit, si dhe pijeve alkoolike të fëmijët.

3. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, brenda kompetencave, marrin masa, me qëllim:

- parandalimin e përfshirjes së fëmijës në prodhimin, shpërndarjen dhe trafikimin e substancave narkotike;
- rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe të fëmijës për këtë çështje, përfshirë edhe hartimin e kurrikulave të nevojshme për këtë qëllim;
- përkrahjen e fëmijës dhe familjeve të tyre nëpërmjet këshillimit;
- hartimin e politikave, strategjive dhe shërbimeve që garantojnë rehabilitimin fizik, mendor dhe social të fëmijës që përdor alkool, duhan ose substanca narkotike e psikotrope.

4. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e qeverisjes vendore mbështesin fëmijën dhe familjen nëpërmjet referimit të çështjes të shërbimet e specializuara për këtë qëllim.

Neni 26

Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual

Fëmija mbrohet nga trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë vepërimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi.

Neni 27

Mbrojtja e fëmijës nga aksesi në materiale me përmbajtje të dëmshmeose të paligjshme në internet

1. Prindi, kujdestari ose çdo person tjetër, i cili është në kontakt me fëmijën është përgjegjës për të mbrojtur fëmijën nga aksesi në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet.

2. Qendrat e ofrimit të internetit, institucionet e edukimit, si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, i cili ofron akses në internet, aplikojnë instrumente teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesi në përmbajtje të paligjshme dhe ose të dëmshme, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, kur konstaton se në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit, në faqet e internetit apo në mjedise ku ka fëmijë, qarkullojnë materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, sipas këtij ligji dhe ligjit për sigurinë kibernetike, i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masat për bllokimin e aksesit në këto rrjete ose faqe.

4. Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesi në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28**Mbrojtja nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe në situatatë emergjencave civile**

1. Fëmija nuk lejohet të përfshihet drejtpërdrejt dhe tërthorazi në një konflikt të armatosur.
2. Në rast konflikti të armatosur ose në situata emergjence civile, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër.
3. Nëse fëmija arrestohet ose ndalohet për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur, ai mbahet në mjedise të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij.
4. Njësia e mbrojtjes së fëmijës në çdo njësi të qeverisjes vendore, brenda 24 orëve nga nisja e një konflikti të armatosur ose emergjence civile, harton një listë me të gjithë fëmijët që ndodhen në territorin e njësisë përkatëse administrative dhe ia dërgon atë Drejtorisë për Emergjencat Civile, me qëllim mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e posaçme të tyre gjatë konfliktit.
5. Në raste të evakuimit të popullsisë gjatë një konflikti të armatosur ose emergjence civile, fëmijës i jepet prioritet. Drejtorja për Emergjencat Civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës marrin masat e nevojshme për evakuimin e sigurt të fëmijës. Në çdo rast, fëmija nuk ndahet nga prindërit ose familja e tij.

Neni 29**E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor**

1. Fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.
2. Ndhima juridike dhe psikologjike i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.
3. Ndhima juridike ndaj fëmijës përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor.
4. Ndhima psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.
5. Fëmija, vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij, bën kërkesë për ndihmë juridike tek institucionet përgjegjëse, të cilat informojnë fëmijën, kujdestarin ose përfaqësuesin e tij për procedurat sipas legjislacionit në fuqi.
6. Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

Neni 30**Ushtrimi i kujdesit prindëror**

1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke

u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.

2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezultojnë se qëndrimi i mëtejshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj.

3. Prindërit e fëmijës, pavarësisht faktit se cili prej tyre ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë të drejtë të marrin informacion dhe asistencën e nevojshme për mirëritjen, kujdesin dhe edukimin e fëmijës, të marrin informacion për fëmijën nga shkolla, njësitë e shërbimit shëndetësor ose çdo institucion tjetër në kontakt me fëmijën.

4. Në rast se të dy prindërit ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, por nuk bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, vendimet lidhur me zgjedhjen e edukimit ose trajnimit profesional, trajtimet mjekësore komplekse ose ndërhyrjet kirurgjikale, vendbanimin e fëmijës ose administrimin e pasurisë së tij, merren me pëlqimin e të dy prindërve.

5. Në rast se njëri nga prindërit nuk jep pëlqimin e tij për të marrë vendim, lidhur me çështjet e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, ose kur ai nuk mund të kontaktohet për shkak të vendndodhjes së panjohur ose për shkak të nevojës urgjente për të marrë vendim lidhur me fëmijën, vendimet merren nga prindi që jeton me fëmijën, përveç rasteve kur vendimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

6. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet prindërve lidhur me ushtrimin e të drejtave prindërore dhe realizimin e detyrimeve të tyre ndaj fëmijës, cilido prej tyre mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente. Pasi të jenë dëgjuar të dy prindërit, si dhe të jetë marrë mendimi i fëmijës, gjykata vendos në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 31**Përkujdesja alternative**

1. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. Në zbatimin e kësaj mase i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar, sipas interesit më të lartë të fëmijës.

2. Përkujdesja alternative mund të jetë:

a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës;

b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën;

c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe.

3. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje, sipas nenit 55 të këtij ligji.

4. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara në pikën

2, të këtij neni, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

Neni 32

Fëmija me aftësi të kufizuar

1. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.

2. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfutuar nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.

3. Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t'i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojës.

4. Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim. Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga buxheti i të dyja njësive të qeverisjes vendore. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

5. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive, që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

6. Autoritetet përgjegjëse garantojnë përshtatjen e arsyeshme rast pas rasti.

7. Autoritetet përgjegjëse garantojnë pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe legjislacionit përmes informacionit të përshtatur, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijët për të kuptuar.

Neni 33

Fëmija që i përket pakicave kombëtare

1. Fëmija që i përket një pakice etnike, fetare ose gjuhësore ka të drejtë të ushtrojë jetën e

tij kulturore, të deklarojë përkatësinë e tij etnike e fetare, të

ushtrojë besimin e tij fetar, si dhe të përdorë gjuhën e tij me anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilit i përket.

2. Fëmija që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë të shprehet në gjuhën e tij amtare gjatë procedurave që lidhen me çështjet e tij.

3. Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të parashikuara në këtë nen garantoohen duke mbajtur parasysh respektimin edhe të të drejtave të fëmijëve të tjerë.

KREU III

MEKANIZMAT INSTITUCIONALE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Neni 34

Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

1. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

2. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:

a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror;

b) grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.

3. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë:

a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

c) çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

4. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:

a) bashkia;

b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative;

d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

5. Mekanizmat dhe strukturat në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit e të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këta mekanizma dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar.

Neni 35

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

2. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës.

3. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.

4. Përfaqësuesit nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës duhet të jenë shtetas shqiptarë, të cilët të kenë njohuri dhe të kenë marrë pjesë në veprimtari të shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Përfaqësuesit nga shoqëria civile zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile.

5. Mandati i anëtarëve të Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë ndalohe.

6. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka të drejtë të ngrejë komitete teknike këshilluese për çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe të përcaktojë përbërjen e rregulloret e tyre.

7. Zgjedhja e përfaqësuesve të fëmijës dhe të shoqërisë civile realizohet sipas udhëzimeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

8. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me të drejtat e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson gjendjen konkrete të respektimit të të drejtave të fëmijës në Shqipëri, duke marrë në konsideratë an-

gazhimet shtetërore, në kuadër të Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe traktateve të tjera në fushën e të drejtave të njeriut;

b) vlerëson planifikimin e buxhetit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve;

c) jep rekomandime të posaçme për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

ç) bën propozime dhe jep rekomandime për Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e legjislacionit në fushat përkatëse të zbatimit të të drejtave të fëmijës.

Neni 37

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me mbrojtjen e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson dhe analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës;

b) i propozon ministrit përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës programet kryesore shtetërore për mbrojtjen e fëmijës dhe drejtimin e politikave shtetërore për përmirësimin e gjendjes së trajtimit të tyre;

c) rekomandon shërbime dhe programe të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre;

ç) rekomandon shërbime dhe programe parandaluese ndërsektorale për mbrojtjen e fëmijës;

d) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 38

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse realizon këto detyra:

1. Në lidhje me orientimin e monitorimin e politikave shtetërore dhe situatës së të drejtave të fëmijës:

a) koordinon dhe monitoron zhvillimin e zbatimit e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përgatit raportet përkatëse;

b) kontrollon veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe miraton raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës;

c) orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët;

ç) ofron mbështetje për organizatat jofitimprurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e

Shoqërisë Civile;

d) bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

dh) analizon të dhënat e raporteve statistikore e të raporteve të tjera dhe koordinon me ministrat e tjerë, me qëllim që të përshtatë në mënyrë dinamike politikat e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

2. Në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, realizon këto detyra:

a) merr masa, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, për ngritjen dhe mirëfunksionimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase për mbrojtjen e tyre, nëpërmjet shërbimeve shumëdisiplinore, ndërsektoriale, të koordinuara, me në qendër fëmijën.

b) harton politika, programe shtetërore dhe strategji në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe shërbimeve për fëmijët, si dhe planifikon shpërndarjen e buxhetit për arritjen e tyre;

c) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre, kryesisht dhe në bazë të rekomandimeve të propozuara nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

ç) nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore;

d) bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

dh) siguron ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, sipas këtij ligji dhe standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

e) siguron ngritjen e një sistemi për akreditimin, kontrollin e cilësisë dhe ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës;

ë) është përgjegjës për ngritjen e një regjistri elektronik kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe merr masa për miratimin e akteve nënligjore për ta bërë të detyrueshëm përdorimin e këtij regjistri.

3. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

4. Mënyra e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Detyrat e ministrave

Ministrat, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, nëpërmjet strukturave të tyre politikëbërëse, kanë për detyrë:

a) të sigurojnë zbatimin e plotë të këtij ligji dhe realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, të njohura nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

b) të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore

të nevojshme për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të fëmijës;

c) të shoqërojnë çdo projektligj apo projektakt normativ që hartojnë me një analizë të ndikimit të tij te fëmijët, djem dhe vajza;

ç) të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen e fëmijës;

d) të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar që punonjësit dhe strukturat në varësi të tyre, që merren me mbrojtjen e fëmijës, të përgatiten me njohuri të duhura dhe të specializohen në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 40

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është person juridik në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, financuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera, sipas ligjit.

2. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil.

3. Struktura dhe organika e agjencisë miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

4. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e agjencisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 41

Detyra e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

2. Agjencia ka për detyrë t'u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me:

a) koordinimin me agjenci të tjera shtetërore dhe private;

b) zhvillimin e aktiviteteve profesionale, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës;

c) asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe supervizionin, në raste të caktuara; bashkërendim të punës për raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës;

ç) këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik apo në

nevojë për mbrojtje, për të cilën agjencia nxjerr një urdhër të brendshëm për mënyrën e funksionimit.

3. Agjencia ka për detyrë gjithashtu:

a) të mbledhë të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje;

b) të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimi;

c) të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes;

ç) të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje;

d) të zbatim të nenit 11, pika 6, e këtij ligji, të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për realizimin e procesit të mbrojtjes dhe marrjes së masave për menaxhimin e rasteve të fëmijës në situatë migrimi, në situatë ndërkuftare dhe në nevojë për mbrojtje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të fëmijës së pashoqëruar.

Neni 42

Detyrat e agjencisë në lidhje me bashkërendimin e punës me ministrin përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.

2. Përgatit dhe i propozon ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës udhëzime metodologjike për strukturat e mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore dhe koordinimin ndërsektorial në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

3. Bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

4. I paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Neni 43

Detyrat e agjencisë në lidhje me politikën dhe veprimtarinë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

2. Ndërton dhe realizon vetë apo në bashkëpunim me institucione të tjera veprimtari për edukimin, trajnimin,

ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit të drejtësisë.

3. Koordinon ose realizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijës në të gjitha fushat.

4. Inicion dhe zbaton projekte pilot, në bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe u jep mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

5. Organizon dhe bashkërendon kërkime shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

6. Realizon mbledhjen, analizën e të dhënave dhe raportimin e zbatimit të dokumenteve strategjike me fokus fëmijët, si dhe të situatës së të drejtave të fëmijës.

7. Zhvillon dhe mirëmban një sistem informacioni me fokus institucionet e specializuara për fëmijët, organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të dhëna të tjera, që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.

8. Bashkërendon veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera.

Neni 44

Mbështetja e agjencisë nga autoritetet shtetërore

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me agjencinë, për realizimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ngritjes dhe zbatimit të standardeve për një sistem funksional të integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

2. Llojet, mënyra e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga agjencia pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45

Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe ata që punojnë me fëmijët

1. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, nuk mund të punësohen dhe, kur janë të punësuar, përfundojnë marrëdhënien e punës në rast se:

a) janë dënuar me dënim të formës së prerë për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje;

b) ndaj tyre është marrë, me vendim gjykate, një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje.

2. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit që punojnë me fëmijët pezullohen nga detyra kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj të miturve ose kur ata akuzohen për kryerjen e një vepre penale në bashkëpunim me të mitur.

3. Kriteret për punësimin e punonjësit të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46*Roli i bashkisë*

Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të standardeve dhe, nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, duke siguruar, ndërmjet të tjerash:

- a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në planet e zhvillimit vendor, në programet dhe projektet, në përputhje me politikat kombëtare;
- b) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës;
- c) zhvillimin e programeve dhe projekteve për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës;
- ç) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera vendore, për situatën e të drejtave të fëmijës dhe familjeve, me qëllim hartimin e programeve që krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin optimal të fëmijës;
- d) zbatimin e politikave kombëtare të mbrojtjes së fëmijës dhe masave të mbrojtjes, siç parashikohen në këtë ligj;
- dh) ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, sipas këtij ligji, duke krijuar kushtet për funksionimin e tyre, në përbushje të funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë edhe shpërndarjen e fondeve përkatëse, në mënyrë që strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor të funksionojnë në mënyrë efektive;
- e) zbatimin e procedurës për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si dhe për ngritjen e koordinimin e sistemit të referimit, raportimit, të marrjes në mbrojtje dhe të ndjekjes së rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje nëpërmjet strukturave të saj;
- ë) organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve me bazë komunitare për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe shërbimeve mbështetëse për familjet e shërbime të përkujdesjes alternative për fëmijët;
- f) ngritjen e programeve dhe të shërbimeve rehabilituese e riintegruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, me një fokus të veçantë për fëmijët viktime të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit dhe fëmijët që dyshohen apo kanë kryer vepra penale, të cilët janë nën moshën për përgjegjësi penale;
- g) kontributin për ngritjen dhe menaxhimin e sistemit kombëtar të informacionit për mbrojtjen e fëmijës, brenda kompetencave të tyre;
- gj) financimin e shpenzimeve për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe të Planit për Aftësim Prindëror.

Neni 47*Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki*

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo, nëpërmjet strukturave

në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore i raporton kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak për ecurinë e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore ngre grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie dhe, kur është e nevojshme, në nivel njësie administrative, si dhe koordinon e mbikëqyr punën dhe aktivitetin e tij, sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 48*Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore*

1. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore është përgjegjës për:

- a) marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në propozimin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe të grupit teknik ndërsektorial;
 - b) miratimin dhe koordinimin e veprimeve ndërsektoriale me institucionet shtetërore për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes;
 - c) marrjen e masave për koordinimin me njësitë përkatëse brenda bashkisë për realizimin e prokurimit të shërbimeve të nevojshme për realizimin e Planit Individual të Mbrojtjes, kur ato nuk mbulohen dot nga strukturat shtetërore;
 - ç) marrjen e masave për organizimin dhe planifikimin e një shërbimi mbrojtjeje emergjente 24-orësh, i cili i njoftohet edhe strukturave të Policisë së Shtetit;
 - d) monitorimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve për mbrojtjen e garantimin e aksesit në të drejtat e fëmijës në territorin e bashkisë;
 - dh) raportimin për ecurinë e veprimtarisë së njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe për situatën e fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.
2. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës miraton, me udhëzim, mënyrën e vendosjes, në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën, ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje.

Neni 49*Njësia për mbrojtjen e fëmijës*

1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

2. Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përveç detyrave të parashikuara në nenin 51, të këtij ligji, është përgjegjës dhe ka për detyrë:

- a) të mbështesë punonjësën për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, masat e mbrojtjes dhe planet individuale të mbrojtjes në bazën e të dhënave përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie dhe njësie administrative;
- c) të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;
- ç) t'i raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësite administrative përkatëse;
- d) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;
- dh) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;
- e) të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;
- ë) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.
4. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve proceduralë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrit të Drejtësisë.
5. Njësia për mbrojtjen e fëmijës ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkisë

1. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkive janë pjesë e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.
2. Çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka, minimalisht, një punonjës për mbrojt-

jen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësia administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përkrahimin e punës funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 51

Detyrat e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.
2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë:
 - a) të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;
 - b) të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
 - c) të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;
 - ç) të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;
 - d) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;
 - dh) të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes. Profesionistët e tjerë, të përfshirë në zbatimin e masës së mbrojtjes apo të Planit Individual të Mbrojtjes, janë të detyruar ta mbajnë të informuar punonjësën e mbrojtjes së fëmijës në lidhje me progresin, sfidat dhe problematikën e hasura gjatë zbatimit të tyre;
 - e) të propozojë ndryshimin apo heqjen e masës së mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes nëse nuk ekzistojnë më kushtet, për shkak të të cilave është vendosur masa dhe plani, apo kur një gjë e tillë i shërben fëmijës dhe/ose është në interesin më të lartë të tij;
 - ë) të lehtësojë dhe të mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në përmbushjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes;
 - f) të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxher rasti;
 - g) t'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë

prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

gj) të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.

Neni 52

Grupi teknik ndërsektorial

1. Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiae, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet ad-hoc, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

2. Grupi teknik ndërsektorial thirret nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në nivel bashkie, ose nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në nivel njësie administrative.

3. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial.

4. Në takimet e grupit teknik ndërsektorial thirren të marrin pjesë:

a) anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik;

b) prindërit apo anëtarët e familjes ose kujdestarët e fëmijës;

c) fëmija, bazuar në moshën dhe në aftësinë e tij për të kuptuar dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

5. Grupi teknik ndërsektorial mbështet punonjësin e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

6. Funkcionimi i grupit teknik ndërsektorial rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

MASAT E MBROJTJES SË FËMIJËS

Neni 53

Mbrojtja e fëmijës

Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja e mbrojtja e prindërve ose kur, për shkak të interesit të tijmë të

lartë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.

Neni 54

Plani Individual i Mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësitë e vlerësimit dhe të Referimit të Rasteve dhe grupin teknik ndërsektorial, që funksionon në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë, duhet të hartojë një Plan Individual Mbrojtjeje, i cili përmban edhe propozimin për masën e mbrojtjes, kur është e nevojshme.

2. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, përveç masave të mbrojtjes, edhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme, që realizojnë respektimin dhe lehtësojnë aksesin e fëmijës në të drejtat e tij, si dhe shërbimet shoqërore apo shërbime të tjera të nevojshme, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit.

3. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, sipas rastit, masat për hetimin dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rastet kur fëmija është në rrezik për abuzim, dhunë, neglizhim e shfrytëzim dhe ndihmën mjekësore, shërbimin psikologjik, ligjor, shoqëror apo çdo shërbim tjetër të nevojshëm rehabilitues apo riintegruer, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit, si edhe aktivitete edukative, mësimore e argëtuese për fëmijën, masat për riaftësim prindëror, programet e mbështetjes dhe ndihmës për prindërit, kujdestarin dhe anëtarët e familjes së gjerë.

4. Të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet e parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes ofrohen falas.

5. Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimi e përmbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 55

Masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes janë:

a) masa emergjente e mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative;

b) masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative;

c) masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

2. Masat e mbrojtjes vendosen për fëmijën:

a) prindërit e të cilit kanë vdekur ose janë shpallur të vdekur nga gjykata, janë të panjohur, u është hequr përgjegjësia prindërore dhe janë në kushte nevojë për mbrojtje;

b) prindi ose kujdestari ligjor i të cilit është shoqëruar, ndaluar, arrestuar ose dënuar me heqje lirie dhe fëmija është në nevojë emergjente mbrojtjeje;

c) kur, në interesin e tij më të lartë, nuk mund të lihet në kujdesin prindëror, për shkak se rrezikohet integriteti i tij fizik, moral, psikologjik e emocional;

ç) i cili është abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar ose neglizhuar;

d) i cili është braktisur nga prindërit që në lindje ose është nën moshën 16 vjeç dhe askush nuk është duke u kujdesur për të;

dh) i cili ka kryer një vepër penale dhe, për shkak të

moshës, nuk ka përgjegjësi penale;

e) i cili ka, dyshohet ose akuzohet ose është dënuar se ka kryer një vepër penale, është në gjendje të lirë dhe ka nevojë për mbrojtje.

Neni 56

Masa emergjente e mbrojtjes

1. Masa emergjente e mbrojtjes për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje, e cila vendoset për fëmijën që ndodhet në situatat e më poshtme:

a) kur fëmija vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo formë dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku fëmija qëndron nuk është e sigurt për fëmijën;

b) është braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) është pa përkujdesje prindërore, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situatë të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

2. Gjatë kohës së vlefshmërisë së një mase emergjente mbrojtjeje, dhënë nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, apo të vendimit të gjykatës për konfirmimin e saj, prindërit nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

3. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Neni 57

Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative

1. Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje për fëmijën pa përkujdesje prindërore dhe kur për mbrojtjen e tij është e nevojshme strehimi apo vendosja e tij në përkujdesje alternative, duke ndjekur këtë radhë:

a) pranë një të afërmi të fëmijës;

b) pranë një familjeje kujdestare;

c) në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme.

2. Marrja e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative merr parasysh mosndarjen e motrave dhe vëllezërve.

3. Vendimi për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata për konfirmimin ose jo të saj dhe ka të njëjtat efekte si vendimi i gjyqësor për kujdestarinë.

4. Personat apo institucioni, pranë të cilit vendoset fëmija në përkujdesje alternative, ka të njëjtat detyra, përgjegjësi

dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes, ndërsa prindërit e fëmijës, gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

5. Gjatë zbatimit të kësaj mase mbrojtëse, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek me përparësi këto çështje:

a) trajtimin dhe gjendjen psiko-emocionale të fëmijës së vendosur në përkujdesje alternative;

b) ndihmën dhe krijimin e mundësive për prindërit për të mbajtur kontakte e marrëdhënie personale me fëmijët e tyre;

c) përgatitjen e dokumenteve përkatëse, të kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor, të konfirmimit ose jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari;

ç) nevojën për ndryshimin apo heqjen e masës mbrojtëse, në varësi të progresit, kushteve dhe rrethanave të rastit.

6. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Neni 58

Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar

1. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

2. Kjo masë vendoset edhe në rastet kur fëmija mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësitë dhe mundësitë për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, i cili dyshohet ose provohet se ka abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën dhe i cili nuk banon apo i cili, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo një urdhri mbrojtjeje nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje.

3. Plani Individual i Mbrojtjes, i cili përmban edhe masën e mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar, hartohet në bashkëpunim me prindërit ose njërin nga prindërit. Në rast se prindërit nuk bashkëpunojnë apo nuk japin miratimin e tyre për ndjekjen e fëmijës me këtë masë mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes së fëmijës vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes.

Neni 59

Vendimmarrja për masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes, ndërhyrjet për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe shërbimet e nevojshme për fëmijën vendosen dhe zbatohen bazuar në Planin Individual të Mbrojtjes.

2. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie apo njësie administrative ose drejtori i njësisë së mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie i dërgon Planin Individual të

Mbrojtjes, së bashku me propozimin për masën e mbrojtjes, drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, i cili merr vendimin e masës së mbrojtjes brenda 24 orëve. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij. Në rastin e masave emergjente të mbrojtjes apo masave të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative vendimi ka fuqi deri në marrjen e vendimit gjyqësor përkatës. Vendimi për dhënien e masës së mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar ka fuqi deri në shfuqizimin e masës nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, bazuar në propozimin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës, dhe nuk dërgohet për shqyrtim gjyqësor.

3. Masat e mbrojtjes për fëmijët mbi moshën 14 vjeç vendosen vetëm pasi është marrë pëlqimi i fëmijës. Në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë marrja e masës së mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, vendim, i cili është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi gjyqësor nga gjykata për lënien në fuqi, kur për këtë masë përkatëse parashikohet shqyrtimi gjyqësor, sipas këtij ligji.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Vendimi i gjykatës për dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata vlerëson si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës dhe vendosjen e tyre në kujdestari.

6. Gjykata vendos për heqjen e masës së mbrojtjes mbi bazën e kërkesës së punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor verifikohet se kanë pushuar shkaqet që kanë çuar në vendosjen e saj.

7. Gjykata kompetente në lidhje me masat e mbrojtjes dhe vendosjen në kujdestari për shkak të këtij ligji është gjykata e rrethit gjyqësor.

8. Veprimtaria e punonjësve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, në lidhje me marrjen dhe zbatimin e masave të mbrojtjes dhe planeve individuale të mbrojtjes është objekt kontrolli nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore.

Neni 60

Monitorimi i masave të mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për

monitorimin e masave të mbrojtjes së fëmijës. Ai duhet të raportojë te drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, të paktën një herë në muaj, për mbarëvajtjen, progresin e masës dhe/ose për nevojën e ndryshimit apo heqjen e saj.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës i dërgon propozimin për heqjen e masës së mbrojtjes dhe kthimin e fëmijës në familjen e tij drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, duke e shoqëruar atë edhe me dokumentacionin përkatës, që vërteton se prindërit janë në gjendje të kujdesen për fëmijën dhe kthimi i fëmijës në familje nuk do ta ekspozojë atë në ndonjë rrezik të mundshëm për jetën dhe integritetin e tij fizik, psikologjik moral apo emocional.

3. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nëse e miraton propozimin për heqjen e masës mbrojtëse, autorizon punonjësën për mbrojtjen e fëmijës për të paraqitur kërkesën për heqjen e masës mbrojtëse, nëse ajo është konfirmuar nga gjykata kompetente.

4. Në rast se, në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, prindërit kanë qenë të detyruar të ndjekin kurse prindërimi apo të kryejnë ndonjë veprim tjetër, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës verifikon përfundimin me sukses të këtyre detyrimeve për prindërit dhe përfshin informacionin përkatës në propozimin për heqjen e masës mbrojtëse.

Neni 61

Masat për aftësim prindëror

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë ose me njësinë për vlerësimin dhe referimin e rastit në nivel njësie administrative, ka për detyrë të vlerësojë situatën familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe të synojnë në çdo rast, me përparësi, realizimin e mbrojtjes së tij pranë familjes.

2. Në rastet kur për fëmijën merren masa mbrojtëse të vendosjes në përkujdesje alternative, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, kur është e mundur, harton një plan për aftësim prindëror, i cili është pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijës dhe synon të përgatisë prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse.

3. Plani për aftësim prindëror mund të përmbajë masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror, këshillim psikologjik, për menaxhimin e zemërimit, trajtim mjekësor kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope, trajtim të shëndetit mendor, si dhe ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile, në skemën e ndihmës ekonomike, në shërbimet e punësimit, pranë shërbimit shëndetësor, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

4. Zbatimi i planit për aftësimin prindëror ndiqet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me punonjësit e njësisë së vlerësimit dhe referimit të rasteve.

KREU V

MBROJTJA E POSAÇME PËR KATEGORI TË ÇAKTUARA FËMIJËSH

Neni 62**Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar**

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës janë përgjegjëse për të verifikuar dhe trajtuar, duke ofruar mbrojtjen e nevojshme për çdo rast të identifikuar apo raportuar të fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe dhunuar. Këto struktura, në bashkëpunim me strukturat dhe autoritetet e tjera përgjegjëse vendore, duhet të realizojnë zbatimin e masave të mbrojtjes, ndërhyrjeve dhe shërbimeve të nevojshme të specializuara për të përmbushur të gjitha nevojat e fëmijës viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të tij, kanë të drejtë të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik, si dhe në rezidencën e personit juridik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Kur, në bazë të rrethanave dhe fakteve është e nevojshme, strukturat e mbrojtjes së fëmijës kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit.

3. Prindi, personi ligjërisht përgjegjës, qoftë person fizik apo juridik, ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe t'u ofrojë atyre informacionin e nevojshëm për adresimin e situatës apo të rastit. Në rast se personat e mësipërm refuzojnë të bashkëpunojnë apo ndalojnë strukturat e mbrojtjes të bëjnë verifikimet e nevojshme, atëherë verifikimi bëhet forcërisht, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit. Mosbashkëpunimi ose ndalimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijës për verifikim, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

4. Në rast se strukturat e mbrojtjes së fëmijës, pas vlerësimeve të bëra, arrijnë në konkluzionin se ka arsye të qenësishme, të cilat mbështesin ekzistencën e një situatë të rrezikut të lartë/të menjëhershëm për fëmijën, atëherë ato kanë të drejtë të marrin masën emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

5. Në rast se nga vlerësimi i rastit të fëmijës rezulton se abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi apo dhunimi është kryer nga persona ligjërisht përgjegjës për përkujdesjen e fëmijës, si punonjës të institucioneve publike apo private të përkujdesjes, kujdestare, familje kujdestare, të afërm, tek të cilët është vendosur fëmija për shkak të një mase mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes marrin masa të menjëhershme për veçimin e fëmijës nga këta persona dhe njoftojnë menjëherë organet e policisë dhe të prokurorisë.

6. Në rastet e dhunës në familje, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, i cili shërben edhe si menaxher rasti, përveç kërkesës për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes, sipas nenit 59, të këtij ligji, mund të iniciojë procesin për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin të mbrojtjes pranë gjykatës kompetente. Në këtë rast, të dyja kërkimet gjykoohen nga i njëjti gjyqtar.

7. Në çdo rast, pas vlerësimeve të mësipërmeve, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton Planin Individual të

Mbrojtjes së Fëmijës, i cili përmban masën e mbrojtjes përkatëse, ndërhyrjet e nevojshme dhe shërbimet për të cilat ka nevojë fëmija, me qëllim trajtimin e tij në aspektin shëndetësor e psiko-emocional, si dhe rehabilitimin e riintegrimin e tij. Po kështu, kur është i mundur qëndrimi i fëmijës pranë familjes apo kur fëmija presupozohet se do të kthehet pranë familjes, pavarësisht marrjes së masës së mbrojtjes për vendosje në përkujdesje alternative, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton dhe merr masa për zbatimin e një plani për aftësim prindëror.

8. Të dhënat në lidhje me vlerësimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës së abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar, dhunuar mbahen konfidenciale, përveç rastit kur ato përdoren përpara organeve të drejtësisë.

9. Fëmija shoqërohet, në çdo rast, nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ose një psikolog i caktuar nga ky i fundit, sipas Planit Individual të Mbrojtjes, në çdo procedurë përpara organeve të policisë, të prokurorisë apo gjykatës.

10. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr masa për monitorimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 63**Deklarata e fëmijës**

1. Gjatë procesit të verifikimit të situatës së fëmijës nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, deklarata e dhënë nga fëmija mund të administrohet ex-officio si një provë. Deklarata e fëmijës do të konsiderohet e vlefshme pavarësisht mënyrës së regjistrimit të saj, me shkrim apo me mjete audio-vizive, gjithmonë në prani të një psikologu dhe me pëlqimin e fëmijës mbi 10 vjeç.

2. Gjyqtari konsideron si provë deklaratën e dhënë nga fëmija gjatë procesit gjyqësor për vlefshmërinë dhe dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosje të fëmijës në përkujdesje alternative. Në rast se fëmija kërkon të dëgjohet, gjykata merr parasysh kërkesën e tij, e cila mund të rrëzohet veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim të motivuar.

Neni 64**Mbrojtja e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik**

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës kanë për të detyrë të identifikojnë në mënyrë aktive dhe të trajtojnë me përparësi çdo rast të raportuar të fëmijës së shfrytëzuar, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Këto struktura janë përgjegjëse dhe kanë të drejtë të ndërmarrin veprime konkrete, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit, për largimin e fëmijës nga situata e shfrytëzimit ekonomik apo situata e rrugës. Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pas vlerësimit të secilit rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin teknik ndërsektorial përfshin në Planin Individual të Mbrojtjes, por pa u kufizuar në to:

a) marrjen e njëres nga masat e mbrojtjes së parashikuara në këtë ligj;

b) regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe/ose ndjekjen e

rregullt të programit mësimor;

c) mbështetje mësimore, nëpërmjet mësuesve të posaçëm apo klasave të integruara;

ç) mosfrekuentimin e vendeve të caktuara;

d) këshillim psikologjik;

dh) trajtim shëndetësor, nëse është i nevojshëm.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në situatën familjare të fëmijës, mund të raportojë prindërit tek organet e policisë dhe të prokurorisë ose të përcaktojë një plan për aftësimin prindëror të prindërve të fëmijës, i cili përmban, por nuk kufizohet në:

a) ndjekjen e kurseve për aftësim prindëror;

b) ndjekjen e kurseve kundër alkoolizmit apo programeve kundër lëndëve narkotike e psikotrope;

c) mbështetjen për t'u regjistruar në njësinë vendore përkatëse dhe regjistrimin e gjithë anëtarëve të familjes në gjendjen civile;

ç) ndihmën për t'u integruar në skemën e ndihmës ekonomike;

d) ndihmën për aksesimin e tregut të punës;

dh) çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme, e cila ndihmon në përmirësimin e situatës familjare, duke krijuar premisa për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e mbarëvajtjes së Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe për ndryshimin e tij, duke përshtatur ose hequr çdo masë apo ndërhyrje nëse situata që ka çuar në vendosjen e tyre ka ndryshuar. Në çdo rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës vë në dijeni drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në lidhje me zbatimin apo nevojën për ndryshimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 65

Mbrojtja e fëmijës nën moshën për përgjegjësi penale

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rastit të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin shumëdisiplinor për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, i cili përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrjet e shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij, duke marrë në konsideratë:

a) kushtet, të cilat lehtësuan përfshirjen e fëmijës në krim;

b) nivelin e rrezikshmërisë shoqërore dhe veprën e kryer;

c) mjedisin, në të cilin është rritur dhe ka jetuar fëmija;

ç) rrezikun apo mundësinë që fëmija të kryejë një veprë tjetër penale;

d) çdo faktor tjetër, i cili mund të ndihmojë për të kuptuar situatën e fëmijës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të përshijnë në Planin Individual të Mbrojtjes edhe seanca këshillimi për prindërit e fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, të cilët nuk janë subjekt i një procedimi penal apo nuk janë dënuar penalisht për këtë gjë.

3. Veprimtaria e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale, rreg-

ullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 66

Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale

1. Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijën që dyshohet ose ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, zbatohet duke lejuar qëndrimin e fëmijës pranë familjes, me kusht që të mbikëqyren aktivitetet e mëposhtme:

a) shkuarja në shkollë në mënyrë të rregullt;

b) pjesëmarrja në aktivitete të shërbimeve parashoqërore;

c) ndjekja e një trajtimi mjekësor apo këshillimi psikologjik;

ç) ndalimet për të shkuar apo frekuentuar vende të caktuara.

2. Në rast se është e pamundur që fëmija të lihet pranë familjes ose kur fëmija nuk përmbush kushtet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes, strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të propozojnë dhe të vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes, përfshirë edhe vendosjen e fëmijës te një nga të afërmit dhe duke i kërkuar fëmijës, në çdo rast, të respektojë kushtet e vendosura në Planin Individual të Mbrojtjes.

KREU VI

RAPORTIMI I RASTEVE TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

Neni 67

Detyrimi për raportim

1. Çdo person fizik ose juridik që ka informacion, ose vetë fëmija, duhet të njoftojë për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës institucionet qendrore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës ose Policinë e Shtetit.

2. Çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

3. Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin te strukturat për mbrojtjen e fëmijës.

4. Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë për detyrë të raportojnë menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës te fëmijët.

5. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha institucionet publike apo private të përkujdesjes së fëmijës, të arsimit e të shëndetësisë, për të lehtësuar

raportimin.

6. Të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim, sipas këtij ligji, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës.

Neni 68

Linja e telefonit për fëmijë

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse, vendos në dispozicion një linjë telefoni pa pagesë, me numër të publikuar gjerësisht, e cila është e detyruar të verifikojë dhe të referojë pranë njësive për mbrojtjen e fëmijës apo strukturave të tjera kompetente çdo rast të raportuar.

KREU VII

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 69

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 32 e 33, të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

- a) personi fizik, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- b) personi juridik, nga 60 000 deri në 100 000 lekë;
- c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 60 000 deri në 80 000 lekë.

2. Çdo mospërmbushje e detyrimeve ligjore nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës konsiderohet kundërvajtje administrative, sipas neneve 38, 39, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 57, 59, 60, 62, 64, 65, 66 e 67 të këtij ligji.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organi, i cili konstaton kundërvajtjen administrative, vendos dhe ekzekuton sanksionet administrative.

4. Vendimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është titull ekzekutiv. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 70

Ankimi

Kundër vendimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas nenit 69, të këtij ligji, mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 6; 27, pika 4; 34, pikat 5 e 6; 35, pika 8; 38, pika 4; 40, pika 4; 44, pika 2; 45, pika 3; 52, pika 6; 54, pika 5; 64, pika 1; 65, pika 3; dhe 69, pika 5, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 40, pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministrat përgjegjës që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim neneve 8, pika 9; 32, pika 4; 48, pika 2; 49, pika 4; dhe 67, pika 7, të këtij ligji.

Neni 72

Shfuqizime

Ligji nr. 10 347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 73

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Valentina LESKAJ

Miratuar në datën 23.2.2017

FORMATET

që mund të përdoren nga punonjësit e bashkisë



Tirane - Janar 2018

SOMMARIO

Pg. 1 *ANEXS 1* Përmbledhje e detyrave që duhet të kryejë një punonjës i bashkisë që punon në role të trefishta

ANEXS 2 **Pg. 2**
Formatet që mund të përdoren nga punonjësit e bashkisë - FORMAT Z.2 (draft)

Pg. 3 *ANEXS 3* Formatet që mund të përdoren nga punonjësit e bashkisë - FORMAT A.5 (draft)

ANEXS 4 **Pg. 5**
Formatet që mund të përdoren nga punonjësit e bashkisë - FORMAT P.1 (draft)

Pg. 7 *ANEXS 5* Formular për mbajtjen e të dhënave në lidhje me referimin e rasteve të personave që deklarojnë se kanë pësuar dhunë në familje

ANEXS 1

PËRMBLEDHJE E DETYRAVE QË DUHET TË KRYEJË NJË PUNONJËS I BASHKISË QË PUNON NË ROLE TË TREFISHTA

Si punonjës i barazisë gjinore	Si koordinator	Si punonjës i mbrojtjes së fëmijëve
<p>Lehtëson dhe mbështet bashkëpunimin e organeve të qeverisjes vendore me institucionet lokale për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje.</p> <p>Siguron ekspertizë teknike për bashkinë për çështje të barazisë gjinore dhe marrjen e masave për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje.</p> <p>Mbështet organet e qeverisjes vendore dhe lehtëson bashkëpunimin e ngushtë të tyre me organizatat jofitimprurëse lokale dhe organizma akademike për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme si dhe për programe në mbrojtje të viktimave të dhunës në territorin që ato mbulojnë.</p> <p>Bashkëpunon me strukturat përkatëse në MMSR për çështjet e barazisë gjinore dhe mbështet organet e qeverisjes vendore për:</p> <p>mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinisë duke respektuar formatin e miratuar nga MMSR si autoriteti përgjegjës.</p> <p>Përgatitjen dhe dhënien e informacionit periodik për aktivitetet e kryera nga Bashkia në kuadrin e promovimit të barazisë gjinore dhe statusit të gruas shqiptare si dhe luftën kundër dhunës në familje; Të dhëna statistikore për nivelin e dhunës në familje, në bashki/komunë.</p> <p>Inicion dhe merr pjesë aktive në aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuese për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje, të organizuar nga bashkia ose që organizohen në bashkëpunim me MMSR dhe shoqërinë civile (takime, ëorkshope, biseda në media).</p> <p>Përgatit informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për pasqyrimin e çështjeve gjinore në ëebsite, buletinet apo mjete të tjera të informimit të bashkisë.</p>	<p>Drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet e këtij ekipi, si dhe informon për ecurinë e punës së tij “Komitetin Drejtues”.</p> <p>Koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe siguron burime ose shërbime reference.</p> <p>Shërben si ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shendetesore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/organizata për të dhënë informacion, për t’i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;</p> <p>Asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave që duhet të ndiqen për marrjen e një Urdhri Mbrojtjeje/Urdhëri të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe për hapat që duhen ndjekur nëse Urdhëri shkelet;</p> <p>Shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe pranë shërbimeve të tjera;</p> <p>Sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni rreth klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar.</p> <p>Përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor.</p> <p>Organizon dhe monitoron takime për menaxhimin e rasteve;</p> <p>Sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuara nga gjykata, që ato të ndjekin hapat e duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës.</p> <p>Koordinon organizimin e trajnimeve nga struktura përgjegjëse për dhunën në familje, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin;</p> <p>Mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje.</p> <p>Paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara “Komitetit Drejtues”.</p> <p>Propozon në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së qeverisjes vendore, krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës.</p>	<p>Bën identifikimin, vlerësimin dhe koordinon veprimet dhe shërbimet me synim mbrojtjen e fëmijëve në rrezik brenda territorit të Bashkisë.</p> <p>Mbrojtja e fëmijëve nga neglizhimi, abuzimi, dhuna, shfrytëzimi, përjashtimi social, trafikimi, si dhe nga fenomene të tjerë që çenojnë mirëqenien e tyre, në bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ngushtë me personelin e Bashkisë, partnerët lokal që veprojnë në zonë.</p> <p>Kryen vlerësimin fillestar të fëmijëve të referuar si në rrezik apo në nevojë, të hartojë planin e ndërhyrjes, të menaxhojë rastin.</p> <p>Bashkëpunon dhe koordinon me të gjithë strukturat brenda zyrës së Shërbimit Social në Bashki dhe aktorë të tjerë publikë apo dhe jo publikë, me qëllim përmirësimin e situatës të fëmijëve dhe të familjeve të tyre.</p> <p>Thërret rregullisht, i mbështetur nga Supervizori (Drejtori), ekipin Multidisiplinor për të adresuar dhe koordinuar ndërhyrjen për rastet e fëmijëve në nevojë.</p> <p>Konsultohet dhe këshillohet rregullisht me supervizorin për të përcaktuar nivelin e rrezikut për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, konsultimin për planin e ndërhyrjes, si dhe, zbatimin e plotë të këtij plani ndërhyrjeje.</p> <p>Bashkëpunon me Shërbimin Social Rajonal, si dhe me shërbimet sociale në territorin e Bashkisë, për të siguruar referimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë.</p> <p>Siguron dokumentimin e të dhënave të sakta e faktike dhe dosje personale për të gjithë fëmijët e identifikuar dhe referuar pranë NJMF.</p> <p>Raporton rregullisht pranë Agjencisë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.</p> <p>Organizon në bashkëpunim me aktorë të tjerë, aktivitete ndërgjegjësuese në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.</p> <p>Merr pjesë në programet e trajnimeve të ofruara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe të zhvillojë kompetencat psikosociale dhe metodologjike në punën me fëmijët.</p> <p>Adreson, advokon dhe lobon në nivel institucional lokal dhe rajonal për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.</p>

ANEXS 2**FORMATET QË MUND TË PËRDOREN NGA PUNONJËSIT E BASHKISË - Format Z.2 (draft)****Format Z.2 (draft)****VËRTETIM I STATUSIT VIKTIMË E MUNDSHME E TRAFIKIMIT**

Për tu lëshuar nga A/IPIF, ose G/SPIF pas identifikimit fillestar ose formal nëse personi rezulton viktimë e mundshme ose viktimë trafikimi

Datë

Nga A/IPIF (emri), adresa

Nga G/SPIF emrat (adresat)

Vërtetohet se në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vecanërisht:

VKM datë (VKM e procedurave)

VKM/ Udhëzim, Urdhër

më datë/ datat nga punonjësit e institucionit tonë janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme

dhe na rezulton se (emri i personit) është:

1. Viktimë e mundshme e trafikimit
2. Viktimë e trafikimit

Të dhëna të hollësishme për procedurën e ndjekur janë përcjellë në (AP)

Ky vërtetim mund të përdoret vetëm nga personi të cilit i lëshohet

Firma, vula,
Titullari i Institucionit

ANEXS 3**FORMATET QË MUND TË PËRDOREN NGA PUNONJËSIT E BASHKISË - Format A.5 (draft)****Format A.5 (draft)****NJOFTIM ELEKTRONIK**

për zbatimin e detyrimit të identifikimit fillestar dhe reagimit të menjëhershëm

A/IPIF emri

A. Të dhëna të përgjithshme për personin të cilin/cilën është zbatuar procedura

Emri, mbiemri i personit

Mosha :

Gjinia

Vendlindja

Vendbanimi

Vendi i identifikimit:

B. Elementët e procedurës të përdorura

Treguesit	Intervista fillestare	Diferenciali	Njoftimi i Seksionit të trafikeve për ndërhyrje të menjëhershme

C. Komunikime verbale me APAP lidhur me personin para hartimit të njoftimit.....**D. Informacion mbi gjendjen ose ardhjen e personit para A/IPIF****E. Veprimet e ndërmarra për identifikimin me hollësi**

Format A.5 (draft)- **Shembull policia e kufirit**

Ora 9.30: Fëmija u paraqit në sportel i vetëm në kthim nga Roja kufitare vuri re elementët nga lista e treguesve:

I/e fëmijë		I/e rritur		
Tregues të rekrutimit zhvendosjes	Tregues të shfrytëzimit/ qëllimit për shfrytëzim	Tregues të rekrutimit zhvendosjes	Tregues të mënyrave	Tregues të shfrytëzimit/ qëllimit për shfrytëzim

Ora 9.50: roja kufitare con fëmijën në vijën e dytë dhe njoftoi përgjegjësin e turnit

Ora 10.00: përgjegjësi i turnit e vendosi fëmijën në dhomën e intervistimit dhe mori të dhënat për familjen e fëmijës, adresën etj. Dhe u lidh me komisariatit e vendbanimit të fëmijës

Ora 10.30: përgjegjësit të turnit iu komunikua se familja nuk ndodhej, ishte larguar

Ora 10.45: përgjegjësi i turnit u lidh me shërbimet sociale të bashkisë dhe këkoi punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve

Ora 12.30: u paraqit në pkk PMF

Ora 12.45 përgjegjësi i turnit dhe PMF zhvilluan intervistën . Nga informacioni i mbledhur rezultoi se:

Statusi i fëmijës:

- Fëmija është trafikuar / është viktimë e mundshme e trafikimit ose
- Fëmija është në nevojë për mbrojtje sipas nenit të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

Niveli i rrezikut dhe burimi i rrezikut

Rreziku ndaj fëmijës është i lartë.

Ora 14.00: Përgjegjësi i turnit dhe PMF zhvilluan një takim lidhur me shqyrtimin e interesit më të mirë të fëmijës

Ora 15.00: PMF komunikoi me Drejtorin e shërbimeve sociale të bashkisë

Ora 16.00: Fëmija i shoqëruar nga PMF-ja u transportua për në

F. Dokumentimi i veprimeve

Shembull

Shënime në intervistën fillestare për fëmijën (formati A2)- ruhet në PKK

Dokumentimi i shqyrtimit dhe vendimit në interesin më të lartë të fëmijës- një kopje në PKK një kopje dhënë PMF-së

G.Menaxhimi i informacionit të vlefshëm për hetim

Informacioni i vlefshëm për hetim u përcoll tek (shefi i stacionit, drejtori i institucionit)

ANEXS 4

FORMATET QË MUND TË PËRDOREN NGA PUNONJËSIT E BASHKISË - **Format P.1 (draft)**

P.1 (draft)

RAPORT PËR VLERËSIMIN E SITUATËS FAMILJARE DHE RREZIKUT PARA KTHIMIT VULLNETAR TË ASISTUAR

Drejtuar: Autoritetit Përgjegjës/Anëtarit të AP që ka bërë kërkesën

Për dijeni: Drejtorit të Shërbimit Social Shtetëror

Data:

Vendi :

Nr. Protokolli:

Emri dhe Mbiemri i punonjësit që bëri vlerësimin:

Struktura në të cilën punon:

Kontaktet (tel, faks, e-mail):

Adresa zyrtare:

Data e kërkesës nga AP për vlerësim:

Emri dhe Mbiemri i personit për të cilin është bërë vlerësimi:

Datëlindja:

Adresa ku dëshiron të kthehet personi:

Personat e kontaktuar për vlerësimin, datat dhe vendet e kontaktit:

1. Nga familja:
2. Nga policia (SLKTP, inspektori i zonës):
3. Nga organizatat e ndihmës:
4. Të tjerë:

Përbërja e familjes:

Të ardhurat dhe burimi i të ardhurave të familjes:

Kushtet e jetesës së familjes:

Kushtet e banimit të familjes:

Rrethanat e largimit nga familja/ versioni i familjarëve:

Kontaktet e familjes dhe marrëdhëniet me personin pas largimit:

Probleme gjatë mungesës së rasti:

A është dakord familja që rasti të kthehet në familje:

Çfarë mund t'i ofrojë familja personit nëse do të kthehet:

Nevojat për ndihmë të familjes në mënyrë që të mbështesë rastin në familje:

Mundësitë e komunitetit për mbështetje të personit kur të kthehet:

Rreziqet e mundshme ndaj sigurisë së personit dhe familjes në rast se personi kthehet/ç'mendojnë në komunitet (familja, agjencitë e zbatimit të ligjit) për vendndodhjen dhe rrezikshmërinë e trafikantit/trafikantëve:

Në ç'masë do të plotësohen nevojat e dëshirat e personit kur të kthehet në familje:

Cilat janë burimet e ndihmës ku mund të drejtohet dhe të marrë ndihmë personi kur të kthehet:

Konkluzione të vlerësuesit mbi sigurinë dhe përshtatshmërinë e kthimit:

1. Ambienti ku kërkon të kthehet personi është i sigurt dhe i përshtatshëm/ mund të plotësojë nevojat e personit për siguri dhe mbrojtje
2. Ambienti ku kërkon të kthehet personi është i pasigurt dhe ose i papërshtatshëm/ mund të plotësojë nevojat e personit për siguri dhe mbrojtje

Sugjerime të vlerësuesit për organizimin e kthimit, rehabilitimit dhe riintegrimin e personit.

Dokumente bashkëngjitur: Autorizim i prindit/kujdestarit për kthim të asistuar të fëmijës

Emri mbiemri, dhe firma e vlerësuesit

Emri, mbiemri dhe firma e Drejtorit

ANEXS 5

FORMULAR PËR MBAJTJEN E TË DHËNAVE NË LIDHJE ME REFERIMIN E RASTEVE TË PERSONAVE QË DEKLAROJNË SE KANË PËSUAR DHUNË NË FAMILJE - Skedë Klienti e vënë në dispozicion nga shoqata Gruaja te Gruaja

Formular për mbajtjen e të dhënave në lidhje me referimin e rasteve të personave që deklarojnë se kanë pësuar dhunë në familje

A. Informacion i përgjithshëm mbi rastin e dhunuar

1. Emri Mbiemri i personit të dhunuar

2. Adresa _____ **Rrethi** _____ **Qyteti** _____ **Komuna/Fshati** _____

3. Datëlindja (data/muaji/viti): _____

4. Seksi: M F

5. Zona ku jeton: _____

6. Statusi i Punësimit (përzgjidh një alternativë):

- a) I/E Punësuar b) I/E papunë c) I/E vetëpunësuar
 d) Nxënës/e e) Student/e f) Pensionist/e
 g) Ne shërbim ushtarak

Kliko ne se rasti është i papunë dhe përfiton ndihme ekonomike

7. Gjendja Civile

7/1 Statusi familjar _____

8. Përkatesia etnike (rretho një të njërit alternativë):

- a) Shqiptar/e b) Egjyptjan/e c) Rom/e d) Grek/e e) Maqedonas/e
 f) Malazez/e g) Tjetër _____

Ne se etniciteti është "Tjetër" ju lutem specifikoni: _____

9. Shtetësia (rretho një të njërit alternativë): Shqiptar/e I/E Huaj

10. Emigrant/e: Po Jo

11. Niveli Arsimor(përzgjidh një alternativë):

- a) Pa arsim b) Arsim fillor c) Arsim 9_vjecar
 d) Arsim i Mesëm e) Arsim i Lartë f) Pasuniversitar
 g) Arsim Profesional

12. Me Aftësi të Kufizuara (AK): Po Jo

Nëse Po, specifikoj llojin e kufizimit :

- a) Me AK Fizike b) Me probleme të shëndetit mendor
 c) Me probleme shqisore d) Tjetër (specifiko) _____

12/a Kliko ne se rasti është invalide pune

12/b Ne se rasti është invalide pune përkrah me shumë: _____

12/c Kliko ne se rasti trajtohet me pagese paaftesie

12/d Kliko ne se rasti ka kujdestare

12/e Kliko ne se dhunuesi është kujdestar

13. Lidhja e personit të dhunuar me dhunuesin

14. Data e paraqitjes në institucion/organizatë (data/muaji/viti): _____

15. Arësyeja që shkaktoi iniciativën për denoncim.

Cila është arësyeja kryesore që nxiti personin e dhunuar të denoncojë incidentin e dhunës, ju lutem shpjegoni (kjo pyetje plotësohet nga personeli i organizatës/institucionit pas intervistimit të personit të dhunuar)

Përshkruani shkurtimisht historinë e dhunimit të rastit deri në momentin e paraqitjes në institucion/organizatë, duke mos harruar të cilësoni llojet/format e dhunës së ushtruar: 1.

16. Lloji i dhunës së shkaktuar (përzgjidh një ose me shumë alternativa):

dhune emocionale dhune psikologjike dhune ekonomike dhune fizike dhune seksuale

17. Përbërja familjare e rastit të dhunuar:

17/1. Numri i antëtarëve të familjes

17/2. Lidhja e personit të dhunuar me femrat:

17/3. Lidhja e personit të dhunuar me meshkujt:

B. Informacion i përgjithshëm mbi Dhunuesin/en**1. Emri Mbiemri i personit të dhunuar**

2. Adresa _____ **Rrethi** _____ **Qyteti** _____ **Komuna/Fshati**

3. Datëlindja (data/muaji/viti):

4. Seksi: M F

5. Zona ku jeton:

6. Statusi i Punësimit (përzgjidh një alternativë):

a) I/E Punësuar b) I/E papunë c) I/E vetëpunësuar

d) Nxënës/e e) Student/e f) Pensionist/e

g) Ne shërbim ushtarak

Kliko ne se rasti është i papunë dhe përfiton ndihme ekonomike

7. Gjendja Civile

7/1 Statusi familjar

8. Përkatesia etnike (rretho një të njërit alternativë):

a) Shqiptar/e b) Egjyptjan/e c) Rom/e d) Grek/e e) Maqedonas/e

f) Malazez/e g) Tjetër

Ne se etniciteti është "Tjetër" ju lutem specifikoni:

9. Shtetësia (rretho një të njërit alternativë): Shqiptar/e I/E Huaj

10. Emigrant/e: Po Jo

11. Niveli Arsimor (përzgjidh një alternativë):

a) Pa arsim b) Arsim fillor c) Arsim 9_vjecar

d) Arsim i Mesëm e) Arsim i Lartë f) Pasuniversitar

A. Institucioni/Organizata e dyte ku referohet rasti

Emri i Institucionit/organizatës pritëse:

Adresa _____ Qyteti _____

B1. Ju lutem specifikoni (klikoni) nëse rasti është:

Vetëm Rregjistruar nga ju

Rregjistruar dhe referuar diku tjetër

Rregjistruar dhe asistuar nga ju

Rregjistruar, asistuar nga ju dhe referuar diku tjetër

B2. Nëse rasti është asistuar nga ju, specifikoni shërbimin e ofruar (ju lutem klikoni një ose më shumë shërbime të ofruara):

- Asistencë Psikologjike _____
- Asistencë Ligjore (specifikoni) _____
- Asistencë Shëndetësore (specifikoni) _____
- Strehim(specifikoni) _____
- Informacion (specifiko) _____
- Trainime profesionale _____
- Shërbim Punësimi (specifiko) _____
- Ndihme ekonomike (specifiko) _____
- Ndihmë për fëmijët (specifikoni) _____
- Tjetër (specifiko) _____

Gjate kohës që rasti asistohet nga org/inst u ndermoren keto hapa per zgjidhjen ligjerisht te ceshtjes:

Kerkese per UMM:	Refuzuar	Në proces	Akorduar
Kërkesë për UM:	Refuzuar	Në proces	Akorduar
Proces penal:	Refuzuar	Në proces	Akorduar
Divorc:	Refuzuar	Në proces	Akorduar
Proces Civil:	Refuzuar	Në proces	Akorduar
Heqje/kufizim i përgjegjësisë prindërore:	Refuzuar	Në proces	Akorduar
Ka shkelje te UMM/UM?	Po	Jo	

B3. Rasti është asistuar nga

data _____ deri në datën _____

Largohet rasti Po Jo Në se po data e largimit është _____

Plotësoni detaje të mëtejshme në lidhje me çështjen:

B.4. A referohet rasti i dhunuar? Po Jo

Nëse PO, atëherë për arsye të një asistence më të kualifikuar në fushën _____ rasti referohet në Organizatën/Institucionin _____ me adresë _____

Emri i Inst/Org _____

Adresa _____

Data e referimit _____

C. Institucioni/Organizata e dyte në të cilën rasti referohet

Emri i Institucionit/organizatës pritëse

C1. Ju lutem specifikoni (klikoni) nëse rasti është:

Vetëm Rregjistruar nga ju	Rregjistruar dhe referuar diku tjetër
Rregjistruar dhe asistuar nga ju	Rregjistruar, asistuar nga ju dhe referuar diku tjetër

C2. Nëse rasti është asistuar nga ju, specifikoni shërbimin e ofruar (ju lutem klikoni një ose më shumë shërbime të ofruara):

Asistencë Psikologjike keshillim psikologjik, terapi individuale, mbeshtetje emocionale

Asistencë Ligjore (specifikoni) keshillim ligjor ,konsulence legale, divorc,noterizime

Asistencë Shëndetësore (specifikoni) ilace

Strehim

Informacion (specifiko) _____

Trainime profesionale _____

Shërbim Punësimi (specifiko) _____

Ndihme ekonomike (specifiko) ushqime

Tjetër (specifiko) shërbim telefoni,

Gjate kohës që rasti asistohet nga org/inst u ndermoren keto hapa per zgjidhjen ligjerisht te ceshtjes:

Kerkese per UMM: Refuzuar Në proces Akorduar

Kërkesë për UM: Refuzuar Në proces Akorduar

Proces penal: Refuzuar Në proces Akorduar

Divorc: Refuzuar Në proces Akorduar

Proces Civil: Refuzuar Në proces Akorduar

Heqje/kufizim i përgjegjësisë prindërore:

Refuzuar Në proces Akorduar

Ka shkelje te UMM/UM? Po Jo

C3. Rasti është asistuar nga

data _____ deri në datën _____

Largohet rasti Po Jo Në se po data e largimit është _____

Plotësoni detaje të mëtejshme në lidhje me çështjen:

C.4. A referohet rasti i dhunuar? Po Jo

Nëse PO, atëherë për arsye të një asistence më të kualifikuar në fushën _____ rasti referohet në Organizatën/Institucionin _____ me adresë _____

Emri i Inst/Org _____

Adresa _____

Data e referimit _____

